BANKA E SHQIPËRISË

Revista Ekonomike

6M1-2021

Nëse përdorni të dhëna të këtij publikimi, jeni të lutur të citoni burimin.
Botuar nga: Banka e Shqipërisë,
Sheshi "Skënderbej", nr. 1, Tiranë, Shqipëri
Tel.: + 355 4 2419301/2/3; + 355 4 2419409/10/11
Faks: + 355 4 2419408
E-mail: public@bankofalbania.org

www.bankofalbania.org

** Pikëpamjet e shprehura në këto artikuj janë të autorëve, punonjës të Bankës së Shqipërisë, dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të institucionit.*

C O N T E N T

STRUKTURA E EKSPORTEVE DHE RRITJA EKONOMIKE *5*
Olsi Pajo, Departamenti i Politikës Monetare, Banka e Shqipërisë

FINTEK 2020: POLITIKAT RREGULLATORE, MONEDHAT ELEKTRONIKE DHE 'STABLECOINS' *23*
Bledar Hoda, Departamenti i Kërkimeve, Banka e Shqipërisë

REMITANCAT DHE NDIKIMI I TYRE NË VARFËRI: RASTI I SHQIPËRISË *37*
Elona Dushku, Departamenti i Kërkimeve, Banka e Shqipërisë
Argita Frashëri, Departamenti i Statistikave, Banka e Shqipërisë

"KANALI I KREDISË DHE TRANSMETIMI MONETAR NË VENDET E EVROPËS QENDRORE, LINDORE E JUGLINDORE" *45*
Meri Papavangjeli, Departamenti i Kërkimeve, Banka e Shqipërisë

NDIKIMI NË PAPUNËSI I NJË GODITJEJE TË ARDHUR NGA KRIZA EKONOMIKE *61*
Orion Garo, Departamenti i Kërkimeve, Banka e Shqipërisë

STRUKTURA E EKSPORTEVE DHE RRITJA EKONOMIKE

Olsi Pajo, Departamenti i Politikës Monetare, Banka e Shqipërisë

1. HYRJE

Çështja e rritjes ekonomike dhe faktorëve që e përcaktojnë atë është një nga temat më themelore dhe më të diskutuara në literaturën ekonomike. Roli i tregtisë së jashtme është një nga dimensionet që ka marrë një vëmendje të rëndësishme në këtë diskutim, i ndikuar edhe nga zhvillimet në proceset globalizuese përgjatë dekadave të fundit. Shkalla e hapjes dhe struktura përkatëse e tregtisë së jashtme janë dy nga elementet kryesore që e kanë udhëhequr diskutimin mbi këtë rol. Nëse diskutimin për hapjen tregtare do ta emërtonim "liberalizim vs. autarki", përgjithësisht ekziston një konsensus në favor të liberalizimit tregtar, ndonëse forma të ndryshme të zërave dhe politikave proteksioniste nuk mungojnë as në vendet e zhvilluara. Nga ana tjetër, nëse etiketa paralele për diskutimin mbi strukturën tregtare do të ishte "specializim vs. diversifikim", polariteti që ekziston në këtë pjesë të literaturës është ndjeshëm më i pranishëm sesa në rastin e hapjes tregtare. Pikërisht ky diskutim i dytë përbën motivimin kryesor për këtë punim.

Koncepti i strukturës tregtare në këtë punim do të limitohet vetëm në dimensionin e eksporteve, duke lënë kështu mënjanë - për arsye të fokusit dhe jo të rëndësisë - dimensionin e importeve. Ky fokus, në mënyrë implicite e orienton diskutimin edhe drejt rolit që ka struktura e prodhimit në tërësi në rritjen ekonomike, përsa kohë ajo çka një vend eksporton është një pasqyrë përfaqësuese e asaj çka vendi prodhon. Në këtë logjikë dhe rrjedhë janë përzgjedhur edhe treguesit e strukturës së eksporteve dhe prodhimit që do të shqyrtohen në funksion të shpjegimit të rritjes ekonomike, duke filluar nga *diversifikimi i eksporteve* dhe duke u zgjeruar më pas në treguesin e *kompleksitetit ekonomik* dhe atë të *kapaciteteve prodhuese*.

Korniza metodologjike e përdorur për analizimin e impaktit të këtyre treguesve në rritjen ekonomike është ajo e regresioneve me efekte të fiksuara, bazuar në të dhëna panel për një grup prej rreth 134 vendesh në një periudhë kohore prej dy dekadash, 1999-2008 dhe 2009-2018. Në krahasimin ndërmjet treguesve, rezulton se marrja në konsideratë e kompleksitetit ekonomik dhe kapaciteteve prodhuese në tërësi është më e vlefshme për shpjegimin e rritjes ekonomike sesa diversifikimi i eksporteve më vete. Gjithashtu, rezultatet sugjerojnë se është më e vlefshme të fokusohemi në kuptimin e ndërveprimit ndërmjet specializimit dhe diversifikimit, më shumë sesa në përcaktimin se cili prej tyre është më i rëndësishëm.

Struktura e punimit është si vijon. Në kapitullin e dytë rishikojmë literaturën që studion lidhjen midis diversifikimit të eksporteve dhe rritjes ekonomike dhe në kapitullin e tretë përkufizojmë indekset që përdoren për matjen e diversifikimit të eksporteve, kompleksitetit ekonomik dhe kapaciteteve prodhuese. Në kapitullin e katërt paraqesim rezultatet e vlerësime tona empirike, ndërsa në kapitullin e pestë e fokusojmë diskutimin në performancën e indekseve për Shqipërinë dhe vendet e rajonit, për ta përmbyllur me konkluzionet në kapitullin e fundit.

2. RISHIKIMI I LITERATURËS

Modelet dhe vlerësimet që sugjerojnë një lidhje të mundshme negative midis përqëndrimit të eksporteve dhe rritjes ekonomike janë shfaqur në literaturën ekonomike të paktën që në mes të shekullit XX, me artikuj si ai i Singer (1950) apo i Prebisch (1962). Punime të mëvonshme, si ato të Neary and van Wijnbergen (1985), Gelb (1988) apo Sachs and Warner (1995), treguan një korrelacion negativ ndërmjet varësisë nga produktet primare dhe rritjes ekonomike, e cila njihet ndryshe edhe si "mallkimi i burimeve natyrore". Syrquin (1988) është një ndër punimet që, nëpërmjet modeleve strukturore, argumenton se vendet duhet të diversifikojnë eksportet nga produktet primare drejt produkteve të prodhimit për të arritur rritje të qëndrueshme ekonomike. Në linjën e rritjes së udhëhequr nga diversifikimi janë edhe një sërë punimesh të kohëve më të vona, si Al-Marhubi (2000), Lederman and Maloney (2003) apo Dutt et al. (2008). Në rastin e vendeve të vogla, McIntyre et al. (2018) argumentojnë se përfitimet nga diversifikimi i eksporteve lidhen së pari me mbrojtjen nga goditjet negative në tregtinë ndërkombtare dhe së dyti, diversifikimi i jep mundësinë këtyre vendeve për të mësuar procese të reja prodhuese, duke rritur kështu kapacitetet në kapitalin njerëzor, çka në afatgjatë mund të shoqërohet edhe me rritje të produktivitetit. Ide të ngjashme përçojnë edhe punime teorike si ato të Krugman (1979) dhe Grossman and Helpman (1991).

Nga ana tjetër, qëndron literatura, e cila në një mënyrë ose një tjetër, e vë në pikëpytje lidhjen e drejtë monotone të sugjeruar nga punimet e mësipërme ndërmjet diversifikimit dhe rritjes. Michaely (1977) është ndër punimet e para që gjen se lidhja pozitive ndërmjet tyre është e rëndësishme vetëm për vendet e zhvilluara dhe jo për vendet më së paku të zhvilluara. Brunnschweiler (2008) dhe Brunnschweiler and Bulte (2008) gjithashtu sjellin evidenca për problemet e endogjenitetit në matjen e lidhjeve negative ndërmjet varësisë nga burimet natyrore dhe rritjes ekonomike, duke vënë në pikëpyetje "mallkimin e burimeve natyrore" dhe duke risjellë në vëmendje tezën se menaxhimi i duhur i burimeve natyrore mund të jetë një pikë kyçe për zhvillimin e qëndrueshëm të vendeve. Imbs and Wacziarg (2003) është një nga punimet më të cituara që hulumton lidhjen midis diversifikimit të prodhimit dhe rritjes ekonomike të një vendi. Ata tregojnë se përqëndrimi sektorial në ekonomi ndjek një trajektore në formë U-je përgjatë fazave të zhvillimit ekonomik. Në fillim vendet diversifikohen - aktiviteti ekonomik i tyre shpërndahet në mënyre më uniforme ndërmjet sektorëve

- dhe më pas ekziston një pikë përgjatë shkallës së zhvillimit kur vendi fillon të

specializohet sërish në sektorë të caktuar dhe për pasojë ripërqëndrohet. Cadot et al. (2011) tregojnë se lidhja në formë U-je ekziston edhe për strukturën e eksporteve. Rrjedhimisht, ata sugjerojnë se diversifikimi i eksporteve nuk duhet marrë nga vendet si objektiv në vetvete. Për të mbështetur këtë tezë ata sjellin në vëmendje edhe dy arsye të mbështetura në teorinë klasike të tregtisë. Së pari, sipas modelit të Rikardos, vendet duhet të specializohen, jo të diversifikohen. Së dyti, sipas modelit Heckscher-Ohlin, struktura e eksporteve do të jetë ngushtësisht e lidhur me zotërimet e vendit. Kjo implikon se vendet duhet të shqetësohen më shumë për akumulimin e faktorëve të prodhimit në lidhje me ato zotërime që disponojnë, sesa për diversifikimin në vetvete. Literatura që i shoqëron këto punime ka nxitur mjaft diskutime, si nga këndvështrimi akademik dhe metodologjik, ashtu edhe nga ai i politikëbërjes. Së fundi, duhet përmendur se ekziston një literaturë e gjerë edhe për ato të cilave në këtë punim do t'i referohemi si *kompleksiteti ekonomik* dhe *kapacitetet prodhuese*, por rishikimi i hollësishëm i saj shkon përtej synimit të këtij punimi.

3. INDEKSET E DIVERSIFIKIMIT, KOMPLEKSITETIT EKONOMIK DHE KAPACITETEVE PRODHUESE

Literatura nuk ofron një matës të unifikuar të diversifikimit dhe përqëndrimit të eksporteve. Disa prej indekseve më të përdorura janë *indeksi Herfindahl-Hirschmann (HHI)*, *indeksi i Theil* dhe *indeksi i Ginit*. Këto indekse kanë gjetur përdorim të gjerë edhe në disiplina të tjera të ekonomiksit, sidomos në matjen e pabarazisë së të ardhurave në ekonomiksin e zhvillimit dhe në matjen e shkallës së përqëndrimit të industrive në ekonomiksin industrial. Duhet theksuar se në vetvete këto tre indekse masin përqëndrimin e eksporteve, duke bërë që diversifikimi në këto raste të ketë një kuptim interpretativ - sa më pak të përqëndruara, aq më të diversifikuara - dhe jo një përkufizim formal. Në këtë seksion do të ndalemi tek indekset HHI dhe Theil dhe do t'i referohemi përkufizimeve dhe simboleve të përdorur nga Cadot et al. (2011).

Edhe në rastin e kompleksitetit ekonomik dhe kapaciteteve prodhuese të një vendi, literatura ofron një sërë konceptesh, përkufizimesh dhe indeksesh. Andreoni (2011) ofron një përmbledhje mjaft gjithëpërfshirëse të këtyre treguesve. Në këtë punim, ne kemi marrë në konsideratë dy prej tyre, Indeksin e Kompleksitetit Ekonomik (ECI) dhe Indeksin e Kapacitetit Ekonomik (PCI), kryesisht për shkak të disponueshmërisë të së dhënave të tyre për periudhën dhe vendet e analizuara. ECI hartohet dhe publikohet nga Growth Lab i Universitetit të Harvardit. Ideja kryesore pas këtij indeksi është se duke vështruar shportën e eksporteve të një vendi në perspektivën e *diversitetit* dhe *kudondodhjes* së produkteve përkatëse, mund të përftosh një tregues për kompleksitetin ekonomik të atij vendi. Nga ana tjetër, PCI hartohet dhe publikohet në statistikat e Konferencës së OKB-së për Tregtinë dhe Zhvillimin (UNCTAD) dhe ndërtohet duke marrë në konsideratë një sërë faktorësh ekonomikë dhe më gjerë për të përcaktuar aftësitë prodhuese të vendeve. Për pasojë, ai është një *indeks i kompozuar* nga një shumllojshmëri të dhënash.

3.1 INDEKSET E DIVERSIFIKIMIT TË EKSPORTEVE

Indeksi Herfindahl-Hirschmann (HHI) mat shkallën e përqëndrimit të eksporteve sipas produktit. Duke e normalizuar për t'i marrë vlerat nga 0 në 1, HHI përkufizohet si:

$$HHI = \frac{\sum_k (s_k)^2 - 1/n}{1 - 1/n},$$

ku $s_k = x_k / \sum_{k=1}^{n} x_k$ është pjesa e linjës[1] së eksporteve k ndaj totalit, pra sasia e eksporteve është shprehur si x_k, ndërkohë që n përfaqëson numrin e linjave të eksporteve. Sa më afër vlerës 1 të jetë vlera e indeksit, aq më të përqëndruara janë eksportet e vendit në pak produkte. Nga ana tjetër, vlerat e indeksit afër zeros reflektojnë shpërndarjen e eksporteve në një gamë të gjerë produktesh.

Duke përdorur të njëjtat simbole si për HHI, indeksi i Theil përkufizohet si:

$$Theil = \frac{1}{n}\sum_{k=1}^{n} \frac{x_k}{\mu} ln\left(\frac{x_k}{\mu}\right), \text{ ku } \mu = \frac{1}{n}\sum_{k=1}^{n} x_k.$$

Një nga avantazhet kryesore të këtij indeksi është dekompozueshmëria e tij. Siç tregohet edhe nga Cadot et al. (2011), ai mund të dekompozohet në *normën ekstensive dhe normën intensive*. Diversifikimi në normën ekstensive ndodh kur numri i linjave aktive të eksportit rritet. Diversifikimi në normën intensive ndodh kur shpërndarja e vlerave ndërmjet linjave të eksporteve ekzistuese bëhet më uniforme. Ky dekompozim përbën edhe rezultatin kryesor të Cadot et al. (2011). Ata tregojnë se vendet diversifikohen dhe më pas ripërqëndrohen dhe kjo ndodh më së shumti për shkak të variacionit në normën ekstensive përgjatë zhvillimit të vendit.

3.2 INDEKSI I KOMPLEKSITETIT EKONOMIK

Sipas përkufizimeve dhe simboleve të përdorura nga Hausmann et al. (2014), le të jetë M_{cp} një matricë në të cilën rreshtat përfaqësojnë vendet e ndryshme dhe shtyllat përfaqësojnë produktet e ndryshme. Një element i kësaj matrice merr vlerën 1 nëse vendi c eksporton produktin p, ose vlerën 0 nëse vendi nuk e eksporton produktin përkatës. Shuma sipas rreshtave tregon se sa produkte eksporton vendi i rreshtit përkatës, duke ofruar një matës të diversitetit. Shuma sipas shtyllave tregon se sa i kudondodhur është një produkt i caktuar në terma gjeografikë, duke ofruar një matës të kudondodhjes së produktit. Formalisht,

$$\text{Diversiteti} = k_{c,0} = \sum_p M_{cp} \tag{1}$$

$$\text{Kudondodhja} = k_{p,0} = \sum_c M_{cp} \tag{2}$$

[1] *Me linja të eksporteve i referohemi kategorive të eksportit të mallrave sipas Standard International Trade Classification (SITC) Revision 3 në nivel tre shifror.*

Për të përftuar një matje më të saktë të numrit të aftësive që një vend disponon, ose të aftësive që duhen për një produkt, informacioni "bruto" që mbartin diversiteti dhe kudondodhja korrigjohet duke e përdorur secilën prej tyre për të korrigjuar tjetrën. Për vendet, do të duhet të llogaritet mesatarja e kudondodhjes të produkteve që vendi eksporton, mesatarja e diversitetit të vendeve që i bëjnë këto produkte dhe kështu me rradhë. Për produktet, do duhet të llogaritet mesatarja e diversitetit të vendeve që i ofrojnë këto produkte dhe mesatarja e kudondodhjes të produkteve të tjera që këto vende bëjnë. Kjo mund të shprehet nga rekursioni:

$$k_{c,N} = \frac{1}{k_{c,0}} \sum_{p} M_{cp} \cdot k_{p,N-1} \tag{3}$$

$$k_{p,N} = \frac{1}{k_{p,0}} \sum_{c} M_{cp} \cdot k_{c,N-1} \tag{4}$$

Më pas, duke zëvendësuar (4) tek (3), mund të përftojmë:

$$k_{c,N} = \frac{1}{k_{c,0}} \sum_{p} M_{cp} \frac{1}{k_{p,0}} \sum_{c'} M_{c'p} \cdot k_{c',N-2} \tag{5}$$

$$k_{c,N} = \sum_{c'} k_{c',N-2} \sum \frac{M_{cp} M_{c'p}}{k_{c,0} k_{p,0}} \tag{6}$$

dhe ta rishkruajmë këtë ekuacion si:

$$k_{c,N} = \sum_{c'} \widetilde{M}_{cc'} \cdot k_{c',N-2} \tag{7}$$

ku

$$\widetilde{M}_{cc'} = \sum_{p} \frac{M_{cp} M_{c'p}}{k_{c,0} k_{p,0}} \tag{8}$$

Vëmë re se ekuacioni (7) kënaqet kur $k_{c,N} = k_{c,N-2} = 1$. Kjo i korrespondon vektorit të vet të $\widetilde{M}_{CC'}$ i cili është i lidhur me vlerën e vet më të madhe. Përsa kohë ky vektor i vet është një vektor me njësha, ai nuk është informativ. Për pasojë, shohim vektorin e vet të lidhur me vlerën e vet të dytë më të madhe. Ky është vektori i vet që kap vlerën më të madhe të variancës në sistem dhe matësi i ofruar për kompleksitetin ekonomik. Prandaj, ECI përkufizohet si:

$$ECI = \frac{\vec{K} - avg(\vec{K})}{stdev(\vec{K})} \tag{9}$$

ku $\vec{K}$ përfaqëson vektorin e vet të $\widetilde{M}_{CC'}$ të lidhur me vlerën e vet të dytë më të madhe dhe ***avg, stdev*** i referohen mesatares dhe variancës përkatëse.

Për të sqaruar intuitën pas matjes së këtij indeksi, le të sjellim shembullin e përshkruar nga Hausmann et al. (2014). Nëse krahasojmë Zvicrën me Egjyptin, ato eksportojnë një numër të ngjashëm kategorish produketesh, rreth 180 të tilla. Nga ana tjetër, Zvicra është një vend me popullsi ndjeshëm më të vogël dhe me PBB për frymë ndjeshëm më të lartë. Lloji i produkteve që këto vende eksportojnë, mund të na ndihmojnë për të kuptuar dhe shpjeguar diferencat e ndjeshme në PBB- në për frymë midis këtyre vendeve. Së pari, Egjipti eksporton produkte që janë mesatarisht të eksportuara nga 28 vende të tjera, ndërsa Zvicra produkte që eksportohen nga mesatarisht vetëm 19 vende të tjera. Së dyti, produktet që eksporton Zvicra eksportohen nga vende mjaft të diversifikuara, ndërsa produktet që eksporton Egjipti nga vende pak të diversifikuara. Janë pikërisht këto diferenca të shkallës së parë, së dytë, e më lart, që inkorporohen në procedurën matematikore të përshkruar më sipër dhe shfrytëzohen për të përftuar matësin e kompleksitetit ekonomik.

3.3 INDEKSI I KAPACITETEVE PRODHUESE

Indeksi i Kapaciteteve Prodhuese (PCI), ndryshe nga indekset e sipërpërmendura të cilët si burim kryesor të dhënash kanë tregtinë e jashtme të mallrave, merr në konsideratë një sërë faktorësh për të përcaktuar aftësitë prodhuese të vendeve dhe për pasojë, ai përftohet nga kompozimi i një shumllojshmërie të dhënash. Grupet kryesore të faktorëve që merren në konsideratë për llogaritjen e këtij indeksi të kompozuar janë tetë: kapitali njerëzor, kapitali natyror, energjia, transporti, teknologjia e informacionit dhe komunikimit, institucionet, sektori privat dhe ndryshimet strukturore. Këto grupe përbëjnë edhe tetë nënindekset e PCI që publikohen nga UNCTAD. Duhet theksuar se dy nga elementet që përbëjnë llogaritjen e faktorit të ndryshimeve strukturore janë indeksi HHI dhe një version i UNCTAD për indeksin e kompleksitetit ekonomik.

Burimet e të dhënave që përdoren në llogaritje janë po ashtu të shumëllojshme. Ato përfshijnë të dhëna nga UNCTAD, Banka Botërore, Organizata Botërore e Shëndetësisë, UNESCO etj. Siç tregohet edhe në raportin metodologjik[2] të UNCTAD për PCI, formula e përmbledhur e këtij indeksi mund të shkruhet si:

$$PCI = \sqrt[n]{\prod_{i=1}^{N} X_i^{PCA}} \qquad (10)$$

ku N është numri total i kategorive përbërse të këtij indeksi dhe X_i^{PCA} është rezultati i arritur nga kategoria i, e cila peshohet sipas metodës së analizës së komponentëve kryesorë *(PCA)*. PCI i merr vlerat nga 0 në 100 dhe vlerat më të larta i përkasin vendeve me kapacitete prodhuese me të shumta. Procedurat

[2] *UNCTAD/ALDC/2020/3 (2021)*

për llogaritjen e këtij indeksi të kompozuar përfshijnë ndër të tjera imputime të dhënash të munguara, parashikime, analizë multivariabël dhe përdorimin e procedurave përkatëse statistikore dhe ekonometrike për vlerësime të ndërmjetme.

4. VLERËSIME EMPIRIKE

4.1 METODOLOGJIA DHE TË DHËNAT

Ky seksion synon të hulmtojë performancën e indekseve të përshkruara më sipër në një seri regresionesh të cilët kanë si qëllim shpjegimin e rritjes ekonomike nëpërmjet variablave të lidhur me madhësinë e vendeve, hapjen tregtare, përqëndrimin e eksporteve, kompleksitetin ekonomik dhe kapacitetet prodhuese. Struktura bazë e këtyre vlerësimeve është si ajo e përdorur prej Hausmann et al. (2014), e cila bazohet në një bashkësi *regresionesh me efekte të fiksuara për periudhat kohore*. Ndryshimet midis vlerësimeve tona nga kjo strukturë bazë janë në dy drejtime kryesore. Së pari, fokusimi i analizës në krahasimin e indekseve të përshkruara më lart, duke përfshirë në regresione edhe indeksin Theil dhe PCI, për të nxjerrë përfundime në lidhje me diskutimin "specializim vs. diversifikim". Drejtimi i dytë lidhet me periudhën kohore më të përditësuar të marrë në shqyrtim, si dhe me disa prej variablave shpjegues të përdorur përveç indekseve në fjalë.

Periudha kohore e të dhënave përfshin dy dekada, 1999-2008 dhe 2009-2018 dhe rreth 134 vende, të përzgjedhura kryesisht për shkak të disponueshmërisë të së dhënave. Rritja e vjetorizuar[3] e Produktit të Brendshëm Bruto (PBB) për frymë të vendeve për secilën nga dekadat merret si variabël i varur. Në rastin e indekseve të përqëndrimit, ECI dhe PCI, konsiderohen vlerat e tyre për secilin vend në fillim të dekadave përkatëse, për ta interpretuar shpjegimin e efekteve mbi rritjen ekonomike në raport me gjenden fillestare të diversifikimit, kompleksitetit ekonomik dhe kapaciteteve prodhuese. Vlerat e secilit prej këtyre indekseve në regresionet e mëposhtme janë të normalizuara nga 0 në 1, për t'i bërë rezultatet sa më të krahasueshme. Variabla të tjerë shpjegues përfshijnë vlerat fillestare të PBB-së për frymë dhe popullsisë në periudhat përkatëse, si dhe rritjen e eksporteve dhe rritjen e rentës nga burimet natyrore, të dyja si përqindje ndaj PBB-së përgjatë periudhave në fjalë. Burimet kryesore të së dhënave janë Atlasi i Kompleksitetit Ekonomik (atlas.cid.harvard.edu) për ECI, statistikat e Konferencës së OKB-së për Tregtinë dhe Zhvillimin (unctadstat.unctad.org) për HHI dhe PCI, databaza e FMN-së për indeksin Theil dhe të dhënat e Bankës Botërore për të gjithë variablat e tjerë. Një përshkrim më i hollësishëm i variablave, burimeve përkatëse dhe një listë e 134 vendeve janë dhënë në shtojcën e këtij punimi.

[3] *Me rritje të vjetorizuar në këtë punim nënkuptojmë të ashtuquajturën CAGR (compound annual growth rate), e cila definohet si CAGR =* $\left(\frac{\text{PBB në fund të periudhës}}{\text{PBB në fillim të periudhës}}\right)^{1/t} - 1$*, ku t përfaqëson numrin e viteve.*

4.2 VLERËSIMET

Duke ndjekur modelin empirik të përdorur nga Hausmann et al. (2014), rritja ekonomike vlerësohet sipas regresionit:

$$Y_{it} = \beta_0 + \beta_1 Indeksi + \beta_2 Periudha + \beta_i X_{it} + \epsilon_{it},$$

ku Y_{it} është rritja e vjetorizuar e vendeve përgjatë dekadave 1999-2008 dhe 2009-2018, *Indeksi* përfaqëson njërin nga indekset e përshkruar në seksionin paraardhës, *Periudha* është një variabël binar për dy dekadat në fjalë, i cili merr vlerën 0 për dekadën e parë dhe vlerën 1 për dekadën e dytë, ndërsa X_{it} përfaqëson matricën dhe variablat e tjerë shpjegues të përdorur. Për të analizuar impaktin e indekseve të mësipërm - dhe për pasojë të diversifikimit, kompleksitetit dhe kapaciteteve prodhuese - në shpjegimin e rritjes ekonomike, ne vlerësojmë nga një regresion për secilin prej tyre.

Siç vihet re në rezultatet e Tabelës 1, në regresionin (1) nuk përfshijmë asnjë prej indekseve. Të vetmit variabla shpjegues janë logaritmi i nivelit fillestar të PBB-së për frymë në secilën periudhë, rritja e rentës nga burimet natyrore si pjesë e PBB-së gjatë periudhës dhe një variabël binar për të kapur efektet fikse të periudhave kohore. Shenja negative e koeficientit të PBB-së fillestare dhe rëndësia e lartë statistikore, janë në linjë me teorinë e konvergjencës në literaturën ekonomike: *ceteris-paribus*, vendet e varfra rriten më shpejt sesa vendet e pasura dhe i arrijnë ato. Në rastin e variablit të rritjes së rentës së burimeve natyrore, rëndësia e tij e ulët statistikore është një indikacion për një rëndësi të pakët që ai ka në shpjegimin e rritjes ekonomike. Për sa i përket variablit binar në lidhje me periudhën kohore, shenja negative e tij i përgjigjet faktit që rritja ekonomike për vendet e marra në shqyrtim në periudhën 1999-2008 ka qenë më e lartë sesa në periudhën 2009-2018.

Në regresionet (2)-(5) të Tabelës 1, përfshijmë përkatësisht secilin prej indekseve në regresionin bazë (1). Rëndësia e lartë statistikore e tyre është një indikacion i qartë se diversifikimi, kompleksiteti ekonomik dhe kapacitet prodhuese të marra më vete janë elemente të rëndësishme në shpjegimin e rritjes ekonomike[4]. Përsa i përket krahasimit të rezultateve të këtyre regresioneve, theksi kryesor duhet vënë në diferencat ndërmjet vlerave absolute të koeficitetëve të indekseve dhe në koeficitentin e shpjegueshmërisë R^2, më shumë sesa në vlerat konkrete të koeficientëve[5]. Siç vihet re, vlerat e R^2 në regresionet e ECI (4) dhe PCI (5) janë më të larta sesa në regresionet e HHI (2) dhe Theil (3). Gjithashtu, vlerat absolute të koeficentëve të ECI në regresionin (4) dhe PCI në regresionin (5) janë më të larta sesa të koeficientëve të indekseve të

4 *Shenjat negative në koeficientët e indekseve HHI dhe Theil lidhen me faktin e përmendur në seksionin paraardhës, që këto dy indekse masin përqëndrimin e eksporteve. Sa më e lartë vlera e indeksit, aq më të përqëndruara eksportet. Nga ana tjetër, në rastin e ECI dhe PCI, sa më e lartë vlera e indeksit, aq më i lartë kompleksiteti ekonomik dhe aq më të larta kapacitetet prodhese të vendit.*

5 *Interpretimi formal nga ana statisitikore, për shembull për indeksin ECI, do të ishte: Rritja me një devijim standard e vlerës së normalizuar të indeksit ECI vlerësohet ta përshpejtojë rritjen e vjetorizuar ekonomike me 4.5 përqind. Gjithësesi, kuptimi i* ***devijimit standard të vlerës së normalizuar të indeksit ECI****, është larg të qënit një koncept i konkretizuar në terma ekonomikë.*

diversifikimit në regresionet përkatëse[6]. Këto dy fakte sugjerojnë se marrja në konsideratë e kompleksitetit ekonomik ose kapaciteteve prodhuese është më e vlefshme për shpjegimin e rritjes ekonomike sesa marrja në konsideratë vetëm e diversifikimit të eksporteve.

Tabela 1. Performanca e indekseve në shpjegimin e rritjes

	Variabli i varur:				
	Rritja PBB-së për frymë				
	(1)	(2)	(3)	(4)	(5)
log(PBB fillestare)	–0.004*** (0.001)	–0.006*** (0.001)	–0.007*** (0.001)	–0.009*** (0.001)	–0.015*** (0.002)
Rritja e rentës_BurNat/PBB	0.0001 (0.0002)	0.0004* (0.0002)	0.0004* (0.0002)	0.0004* (0.0002)	0.0004* (0.0002)
Periudha	–0.008*** (0.003)	–0.006** (0.003)	–0.006** (0.003)	–0.005* (0.003)	–0.004 (0.003)
HHI_n		–0.038*** (0.007)			
Theil_n			–0.032*** (0.007)		
ECI_n				0.045*** (0.008)	
PCI_n					0.081*** (0.013)
Konstantja	0.072*** (0.009)	0.093*** (0.010)	0.100*** (0.011)	0.091*** (0.009)	0.128*** (0.013)
Observime	261	259	257	261	260
R^2	0.111	0.197	0.192	0.218	0.221
Adj. R^2	0.101	0.184	0.179	0.206	0.209
F Statistic	10.735***	15.578***	14.972***	17.863***	18.109***

**p<0.1; **p<0.05; ***p<0.01*

Për ta hulumtuar më shumë këtë tezë, na vijnë në ndihmë regresionet e Tabelës 2 dhe Tabelës 3, të cilat ndryshojnë vetëm në indeksin që përfshihet si variabël shpjegues, përkatësisht ECI në Tabelën 2 dhe PCI në Tabelën 3. Këto regresione gjithashtu marrin në konsideratë efektet e fiksuara për periudhat kohore dhe përfshijnë edhe variabla të tjerë shpjegues që lidhen me hapjen tregtare (eksporte ndaj PBB-së), suksesin tregtar përgjatë dekadave në fjalë (rritja e eksporteve si pjesë e PBB-së) dhe madhësinë e vendit sipas popullsisë.

Siç vëmë re nga rezultatet, rritja e eksporteve si pjesë e PBB-së, diversifikimi i tyre sipas indeksit Theil dhe madhësia e vendit sipas popullsisë, janë variabla

6 *Rikujtojmë se të gjithë indekset janë normalizuar për t'i marrë vlerat nga 0 në 1 përgjatë këtyre regresioneve.*

statistikisht jo të rëndësishëm përsa kohë përfshijmë në analizë indekset ECI dhe PCI. Edhe rëndësia statistikore e përqëndrimit sipas indeksit HHI dhe vlera përkatëse e këtij koeficienti janë ulur në krahasim me regresionin (2) të Tabelës 1, ku nuk përfshiheshin në të njëjtin regresion ECI ose PCI. Përsa i përket variablit që përfaqëson madhësinë e hapjes tregtare (eksporte ndaj PBB-së), ai gjithashtu nuk shfaq një nivel të lartë rëndësie statistikore. Të gjitha këto të dhëna statistikore mbështesin hipotezën se *marrja në konsideratë e kompleksitetit ekonomik apo kapaciteteve prodhuese* ***në tërësi****, është më e vlefshme për shpjegimin e rritjes ekonomike sesa marrja në konsideratë e diversifikimit, hapjes dhe suksesit tregtar, apo madhësisë së vëndit,* ***në veçanti****.*

Tabela 2. Ndërveprimi i ECI me treguesit e tjerë

	Variabli i varur:					
	Rritja PBB-së për frymë					
	(1)	(2)	(3)	(4)	(5)	(6)
log(PBB fillestare)	−0.009*** (0.001)	−0.009*** (0.001)	−0.009*** (0.001)	−0.009*** (0.001)	−0.009*** (0.001)	−0.010*** (0.001)
Rritja e rent_BN/ PBB	0.0004* (0.0002)	0.0001 (0.0002)	0.0002 (0.0002)	0.0004** (0.0002)	0.0004** (0.0002)	0.0004* (0.0002)
ECI_n	0.045*** (0.008)	0.040*** (0.008)	0.041*** (0.008)	0.033*** (0.010)	0.036*** (0.011)	0.046*** (0.008)
EXP/PBB		0.0001 (0.0001)				
Rritja EXP/PBB			0.0001* (0.0001)			
HHI_n				−0.018* (0.010)		
Theil_n					−0.011 (0.009)	
log (popullsia)						−0.0005 (0.001)
Observime	261	252	253	259	257	261
R^2	0.181	0.177	0.177	0.193	0.186	0.182
Adj. R^2	0.168	0.160	0.160	0.177	0.170	0.166
F Statistic	18.841***	13.207***	13.286***	15.093***	14.367***	14.146***
FE për Periudhën	Po	Po	Po	Po	Po	Po

**p<0.1; **p<0.05; ***p<0.01*

Tabela 3. Ndërveprimi i PCI me treguesit e tjerë

	Variabli i varur:					
	Rritja PBB-së për frymë					
	(1)	(2)	(3)	(4)	(5)	(6)
log(PBB fillestare)	–0.015*** (0.002)	–0.015*** (0.002)	–0.015*** (0.002)	–0.013*** (0.002)	–0.014*** (0.002)	–0.015*** (0.002)
Rritja e rent_ BN/PBB	0.0004** (0.0002)	0.0002 (0.0002)	0.0003 (0.0002)	0.0005** (0.0002)	0.001** (0.0002)	0.0004** (0.0002)
PCI_n	0.081*** (0.013)	0.074*** (0.014)	0.074*** (0.013)	0.059*** (0.017)	0.067*** (0.017)	0.081*** (0.014)
Rritja EXP/PBB		0.0001 (0.0001)				
EXP/PBB			0.0001* (0.0001)			
HHI_n				–0.018** (0.009)		
Theil_n					–0.012 (0.008)	
log (popullsia)						0.00003 (0.001)
Observime	260	251	252	259	256	260
R^2	0.186	0.186	0.185	0.198	0.197	0.186
Adj. R^2	0.173	0.170	0.169	0.183	0.181	0.170
F Statistic	19.367***	14.023***	13.990***	15.658***	15.369***	14.468***
FE për Periudhën	Po	Po	Po	Po	Po	Po

**p<0.1; **p<0.05; ***p<0.01*

Një vizualizim tjetër i idesë së kësaj hipoteze paraqitet në Figurën 1, e cila projekton korrelacionet midis vlerave fillestare të PBB-së për frymë dhe variablave të sipërpërmendur për vendet e marra në shqyrtim në periudhat përkatëse përgjatë analizës. Siç vihet re, korrelacioni i PBB-së me indekset ECI dhe PCI është ndjeshëm më i lartë sesa korrelacioni me variablat e tjerë. Në rastin e PCI, korrelacioni i lartë me PBB-në është i lidhur ngushtë me mënyrën e ndërtimit të këtij indeksi, pasi një pjesë e ingredientëve të tij janë të lidhur në mënyrë direkte me PBB-në. Sidoqoftë, ky fakt nuk ia ul aspak rëndësinë PCI, pasi *kompozimi në mënyrën optimale* i këtyre të dhënave së bashku me të dhëna dhe tregues të tjerë, është një detyrë jo e lehtë që i ka preokupuar prej kohësh ekonomistët.

Figurë 1. Korrelacioni i treguesve me PBB-në për frymë



Burimi: Shih shtojcën e punimit.

Mjaft interesant është korrelacioni i lartë i ECI me PBB-në. Në thelb, ECI dhe indekset e përqëndrimit HHI dhe Theil përdorin të njëjtën bashkësi të dhënash - shportën eksportuese të mallrave të vendeve. Për të shpjeguar performancën më të mirë të ECI në vlerësimet tona dhe korrelacionin më të lartë që ai ka me PBB-në, duhet t'i rikthehemi ndërtimit të këtij indeksi. Siç treguam në seksionin 3, përveçse për diversitetin e produkteve, ECI përmban informacion edhe për ***kudondodhjen*** e tyre, një tregues që mat sesa i rrallë apo i shpeshtë është një produkt në tregun botëror. Në përgjithësi, rrallësia e një produkti në tregun botëror buron nga dy drejtime kryesore, monopoli natyror i vendit që e zotëron produktin (për shembull, diamantet) dhe "monopoli" i aftësive dhe kapaciteteve që duhen për ta prodhuar atë produkt (për shembull, produktet komplekse teknologjike). Praktikisht, renditja e vendeve sipas ECI tregon qartë se ajo çka vlen më shumë është pikërisht drejtimi i dytë, i cili i përngjan ndjeshëm konceptit të specializimit. Me fjalë të tjera, ndërtimi i ECI dhe performanca relative e tij na shërbejnë për të intuituar se duhet të fokusohemi më shumë në kuptimin e ***ndërveprimit ndërmjet specializimit dhe diversifikimit***, sesa në përcaktimin se cili prej tyre është më i rëndësishëm.

4.3 KUFIZIMET E ANALIZËS

Analiza e mësipërme është e limituar të paktën në tre drejtime kryesore. Së pari, janë çështjet që lidhen me burimin e të dhënave të tregtisë ndërkombëtare që përdoren për të ndërtuar indekset e përqëndrimit dhe ECI. Ekziston një shumëllojshmëri burimesh që i raportojnë këto të dhëna në nivel ndërmjet-vendeve dhe ato jo gjithmonë janë plotësisht të ngjashme me njëra-tjetrën. Diferencat lindin si pasojë e një sërë faktorësh, ku ndër më kryesorët janë metodologjitë dhe udhëzimet e ndryshme të përdorura nga vendet për matjen e tregtisë së mallrave, gabimet në matjet përkatëse, sistemet e ndryshme të taksave, diferencat në normën e kursit të këmbimit të përdorur etj. Një çështje tjetër për t'u rikujtuar në këtë pikë, është se këto tre indekse bazohen mbi të dhëna vetëm për tregtinë ndërkombtare të mallrave, duke lënë mënjanë tregtinë e shërbimeve për shkak të mungesës së detajimit në mënyrë të unifikuar ndërmjet-vendeve të së dhënave të këtyre të fundit.

Kufizimi i dytë lidhet me vlerësimet ekonometrike të kryera. Siç tregohet edhe nga Durlauf et al. (2005), në vlerësimet ndërmjet-vendeve për shpjegimin e rritjes ekonomike janë pothuajse kurdoherë të pranishme problemet dhe diskutimet mbi endogjenitetin, multikolinaritetin dhe heteroskedasticitetin. Për të adresuar dy problemet e para, përveçse kemi ndjekur strukturën e përdorur nga Hausmann et al. (2014), kemi provuar një sërë variablash dhe kombinimesh për të arritur në strukturën e paraqitur më sipër. Gjithashtu, rëndësia e statistikore e koeficientëve në tërësi mbetet e pandryshuar edhe nëse marrim gabime standarde të korrigjuara për heteroskedasticitetin, çka sugjeron se modeli i specifikuar nuk vuan - të paktën në mënyrë të ndjeshme - nga kjo dukuri.

Së treti, analiza të këtij lloji fokusohen në ***këndvështrimin ndërmjet-vendeve*** të lidhjeve përkatëse, çka në një mënyrë apo një tjetër e limiton rëndësinë e përfundimeve kur implikimet e tyre duhen konsideruar për politikën industriale të një vendi specifik. Në raste të tilla, analiza duhet thelluar në veçoritë specifike të vendit, pasi ato mund të kompozohen në mënyra që mund t'i bëjnë përfundimet e këtij punimi jo të përshtatshme. Për pasojë, duke pasur parasysh këto kufizime, duhet të jemi mjaft të kujdesshëm në interpretimin e rezultateve dhe mesazheve që marrim prej tyre.

5. INDEKSET PËR SHQIPËRINË DHE VENDET E RAJONIT

Në këtë seksion do të diskutojmë performancën e Shqipërisë dhe disa vendeve të rajonit në indekset e marra në shqyrtim në këtë analizë[7]. Siç tregohet në Figurën 2, Shqipëria është ndër vendet më pak të diversifikuara në rajon. Për më tepër, vlerat e këtyre indekseve janë rritur përgjatë viteve të fundit, çka nënkupton një përkeqësim të shkallës së diversifikimit të eksporteve. Sipas HHI, vendi me performancën më të mirë në rajon në 2018 është Kroacia, e cila ndiqet nga Serbia dhe Bullgaria. Sipas indeksit Theil, vendet me performancën më të mirë në rajon në 2014 janë Kroacia, Serbia dhe Rumania. Në rastin e HHI, vendet e rajonit janë më të përqëndruara sesa mesatarja EU-28.

Figura 2. HHI (majtas) dhe indeksi Theil (djathtas) për vendet e rajonit



Burimi: UNCTADSTAT dhe të dhënat e FMN.
Shënim: Vlerat më të larta i përkasin vendeve me eksporte më të përqëndruara.

[7] *Siç e përmendëm më sipër, gjatë regresioneve përdorëm vlerat e normalizuara të indekseve për t'i bërë rezultatet sa më të krahasueshme. Në këtë seksion do t'i referohemi vlerave standarde të tyre, të marra nga burimet përkatëse.*

Një panoramë e ngjashme për Shqipërinë paraqitet edhe në rastin e kompleksitetit ekonomik dhe kapaciteteve prodhuese. Në vitin 2018, ajo renditet e fundit në grupin e vendeve të rajonit sipas ECI dhe PCI. Në rastin e ECI vihet re një përkeqësim përgjatë periudhës 2008-2018, ndërsa në të njëjtën periudhë PCI është përmirësuar. Përsa i përket vendeve të rajonit, në 2018 ekonomia më komplekse është Rumania, ndërsa me kapacitete më të mëdha prodhuese është Kroacia. Në rastin e këtyre dy indekseve, për nga mënyra e ndërtimit të tyre, shihet më e arsyeshme për t'u përdorur si pikë referimi një vend konkret, sesa mesatarja e Bashkimit Evropian. Polonia është ndër vendet më afër mesatares aritmetike përkatëse.

Figura 3. ECI (majtas) dhe PCI (djathtas) për vendet e rajonit



Burimi: Atlasi i Kompleksitetit Ekonomik dhe UNCTADSTAT.
Shënim: Vlerat më të larta tregojnë ekonomi më komplekse dhe më shumë kapacitete prodhuese.

Figura 4 paraqet indeksin PCI sipas nënkategorive të tij kryesore. Dy komponentët ku Shqipëria shënon rezultatin më të dobët se të gjitha vendet e rajonit e marra në shqyrtim janë "Teknologjia e informacionit dhe komunikimit" dhe "Ndryshimet strukturore". E para mat aksesimin dhe integrimin e sistemeve të komunikimit në popullsi. "Ndryshimet strukturore" i referohen lëvizjes së punës dhe faktorëve të tjerë të prodhimit nga aktivitetet me produktivitet të ulët në aktivitetet me produktivitet të lartë. Komponenti "Sektori privat" - i cili mat faktorë si lehtësia për tregti ndërkombëtare, mbështetja e biznesit me kreditim të brendshëm, shpejtësia e zbatimit të kontratave dhe koha e kërkuar për hapjen e biznesit - është i vetmi ku Shqipëria performon disi më mirë sesa vendet e tjera të rajonit.

Figura 4. PCI në 2018 sipas komponentëve



Burimi: UNCTADSTAT.

Performanca e këtyre indekseve përçon mesazhin që Shqipëria në dekadën 2008-2018 ka shfaqur rezultate më të ulëta sesa mesatarja e vendeve të rajonit në lidhje me diversifikimin e eksporteve, kompleksitetin e ekonomisë dhe kapaciteteve të saj prodhuese. Kjo performancë përkthehet në një barrierë të rëndësishme për çlirimin e mëtejshëm të potencialeve që lidhen me rritjen ekonomike. Përhapja e teknologjisë së informacionit dhe mungesa e ndryshimeve strukturore janë dy nga fushat më problematike që indeksi i kapaciteteve prodhuese identifikon në këtë drejtim.

6. KONKLUZIONE

Në këtë punim kemi analizuar performancën e indekseve të diversifikimit të eksporteve, kompleksitetit ekonomik dhe kapaciteteve prodhuese në shpjegimin e rritjes ekonomike, duke marrë në kon- sideratë të dhëna për rreth 134 vende, në një periudhë kohore që përfshin dy dekada (1999-2018). Rezultatet e gjetura sugjerojnë se marrja në konsideratë e kompleksitetit ekonomik apo kapaciteteve prodhuese në tërësi, është më e vlefshme për shpjegimin e rritjes ekonomike sesa marrja në konsideratë e diversifikimit, hapjes dhe suksesit tregtar, apo madhësisë së vëndit, në veçanti. Gjithashtu, pavarësisht divergjencave të mundshme në një pjesë të literaturës, rezultatet e këtyre vlerësimeve dhe eksperienca e vendeve të zhvilluara sugjerojnë se sinergjitë më të mëdha vijnë nga ndërveprimi i specializimit dhe diversifikimit, më shumë sesa nga përcaktimi i njërit prej tyre si më i rëndësishëm se tjetri.

Përsa i përket vlerave të indekseve të analizuara, Shqipëria, në dekadën 2008-2018, ka pasur një performancë më të ulët sesa mesatarja e vendeve të rajonit. Ritmet më të ulëta në përhapjen e teknologjisë së informacionit dhe në ndryshimet strukturore janë dy nga faktorët më problematikë të identifikuar. Në përgjithësi, vendet e rajonit vijojnë të mbeten nën mesataren e Bashkimit Evropian për këta tregues.

Së fundi, aspektet që lidhen me burimin e të dhënave që përdoren në analiza të këtij lloji dhe limitet metodologjike që i shoqërojnë ato, janë faktorë të rëndësishëm që duhen mbajtur parasysh në interpretimin e rezultateve dhe konkluzioneve.

REFERENCAT

F. Al-Marhubi. Export diversification and growth: an empirical investigation. Applied Economics Letters, 7(9):559–562, 2000.

A. Andreoni. Productive capabilities indicators for industrial policy design. UNIDO Working Paper Series, (17/11), 2011.

C. N. Brunnschweiler. Cursing the blessings? natural resource abundance, institutions, and economic growth. World Development, 36(3):399–419, 2008.

C. N. Brunnschweiler and E. H. Bulte. Linking natural resources to slow growth and more conflict.
SCIENCE-NEW YORK THEN WASHINGTON-, 320:616, 2008.

O. Cadot, C. Carr`ere, and V. Strauss-Kahn. Export diversification: what's behind the hump?
Review of Economics and Statistics, 93(2):590–605, 2011.

S. N. Durlauf, P. A. Johnson, and J. R. Temple. Growth econometrics. Handbook of Economic Growth, 1:555–677, 2005.

P. Dutt, I. Mihov, and T. Van Zandt. Trade diversification and economic development. Mimeograph, INSEAD, 2008.

A. H. Gelb. Oil windfalls: Blessing or curse? Oxford University Press, 1988.

G. M. Grossman and E. Helpman. Trade, knowledge spillovers, and growth. European Economic Review, 35(2-3):517–526, 1991.

R. Hausmann, C. A. Hidalgo, S. Bustos, M. Coscia, and A. Simoes. The atlas of economic complexity: Mapping paths to prosperity. Mit Press, 2014.

J. Imbs and R. Wacziarg. Stages of diversification. American Economic Review, 93(1):63–86, 2003.

P. R. Krugman. Increasing returns, monopolistic competition, and international trade. Journal of International Economics, 9(4):469–479, 1979.

D. Lederman and W. F. Maloney. Trade structure and growth. The World Bank, 2003.
A. McIntyre, M. Xin Li, K. Wang, and H. Yun. Economic benefits of export diversification in small states. IMF Working Paper, 2018.

M. Michaely. Exports and growth: an empirical investigation. Journal of Development Economics, 4(1):49–53, 1977.

J. P. Neary and S. van Wijnbergen. Natural resources and the macroeconomy: a theoretical frame- work. Working Paper, 1985.

R. Prebisch. The economic development of latin america and its principal problems. Economic Bulletin for Latin America, 1962.

J. D. Sachs and A. M. Warner. Natural resource abundance and economic growth. Technical report, National Bureau of Economic Research, 1995.

H. Singer. Us foreign investment in underdeveloped areas: The distribution of gains between invest- ing and borrowing. American Economic Review, (40), 1950.

M. Syrquin. Patterns of structural change. Handbook of Development Economics, 1:203–273, 1988.

UNCTAD/ALDC/2020/3. UNCTAD Productive Capacities Index: Methodological Approach and Results. UNCTAD Publications, 2021.

SHTOJCË

Vendet e marra në shqyrtim:

Angola, Shqipëria, Emiratet e Bashkuara, Argjentina, Armenia, Australia, Austria, Azerbaixhani, Belgjika, Burkina Faso, Bangladeshi, Bulgaria, Bahrain, Bosnje-Hercegovina, Bjellorusia, Bolivia, Brazili, Botsvana, Kanadaja, Zvicra, Kili, Kina, Bregu i Fildishtë, Kameruni, Republika Demokratike e Kongos, Republika e Kongos, Kolumbia, Kosta Rika, Kuba, Qipro, Republika Çeke, Gjermania, Danimarka, republika Domenikane, Algjeria, Ekuadori, Egjypti, Spanja, Estonia, Etiopia, Finlanda, Franca, Gaboni, Mbretëria e Bashkuar, Gjeorgjia, Gana, Guinea, Greqia, Guatemala, Hondurasi, Kroacia, Hungaria, Indonezia, India, Irlanda, Irani, Izraeli, Italia, Xhamaika, Jordania, Japonia, Kazakistani, Kenia, Kirkistani, Kamboxha, Koreja e Jugut, Kuvaiti, Laosi, Libani, Liberia, Libia, Sri Lanka, Lituania, Letonia, Maroku, Moldavia, Madagaskari, Meksika, Maqedonia e Veriut, Mali, Mianmar, Mongolia, Mozambiku, Mauritania, Mauricius, Malaui, Malajzia, Namibia, Nigeria, Nikaragua, Holanda, Norvegjia, Zelanda e Re, Omani, Pakistani, Panamaja, Peruja, Filipinet, Papua Guinea e Re, Polonia, Portugali, Paraguai, Katari, Romania, Rusia, Arabia Saudite, Senegali, Singapori, Salvadori, Serbia, Sllovakia, Sllovenia, Suedia, Esvatini, Togo, Tajlanda, Taxhikistani, Turkmenistani, Trinidad dhe Tobago, Tunizia, Turqia, Tanzania, Uganda, Ukraina, Uruguai, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Uzbekistani, Venezuela, Vietnami, Jemeni, Afrika e Jugut, Zambia, Zimbabve.

Tabela 4. Variablat dhe burimet e të dhënave

Variabli	Përshkrimi	Burimi
Rritja ekonomike e vjetorizuar	CAGR e PBB-së për frymë të vendeve për periudhat 1999-2008 dhe 2009-2018	Të dhënat e Bankës Botërore https://databank.worldbank.org/
PBB fillestare	Logaritmi i vlerës së PBB-së për frymë të vendeve për vitet 1999 dhe 2009 (vitet fillestare të periudhave të marra në shqyrtim).	
Rritja e rentës së burimeve natyrore	Rritja në pikë përqindje e pjesës në PBB të rentës totale të burimeve natyrore në periudhat 1999-2008 dhe 2009-2018. Renta totale e burimeve natyrore është shuma e rentës nga lëndët djegëse, gazi natyror, qymyri, mineralet dhe pyjet.	
Eksportet fillestare ndaj PBB-së dhe rritja e tyre	Eksportet e mallrave dhe shërbimeve si pjesë e PBB-së për vitet 1999 dhe 2009 (vitet fillestare të periudhave të marra në shqyrtim) dhe rritja në pikë përqindje e pjesës së eksporteve në PBB për periudhat 1999-2008 dhe 2009-2018.	
Popullsia	Logaritmi i popullsisë së vendeve në vitet 1999 dhe 2009 (vitet fillestare të periudhave të marra në shqyrtim).	
HHI	Shih seksionin 3.1 Vlerat e HHI në vitet 1999 dhe 2009 (vitet fillestare të periudhave të marra në shqyrtim).	Statistikat e UNCTAD https://unctadstat.unctad.org/
Indeksi Theil	Shih seksionin 3.1 Vlerat e indeksit Theil në vitet 1999 dhe 2009 (vitet fillestare të periudhave të marra në shqyrtim).	Statistikat e FMN https://www.imf.org/external/datamapper/datasets
ECI	Shih seksionin 3.2 Vlerat e ECI në vitet 1999 dhe 2009 (vitet fillestare të periudhave të marra në shqyrtim).	Atlasi i Kompleksitetit Ekonomik https://atlas.cid.harvard.edu/
PCI	Shih seksionin 3.3 Vlerat e PCI në vitet 1999 dhe 2009 (vitet fillestare të periudhave të marra në shqyrtim).	Statistikat e UNCTAD https://unctadstat.unctad.org/

FINTEK 2020: POLITIKAT RREGULLATORE, MONEDHAT ELEKTRONIKE DHE 'STABLECOINS'

Bledar Hoda, Departamenti i Kërkimeve, Banka e Shqipërisë

Cikli i risive në teknologjinë financiare (më tej FinTek) vazhdon të mbetet një proces ende në zgjerim ndërsa përhapja e produkteve dhe shërbimeve FinTek në industrinë financiare po merr përmasa globale. Në sektorin privat, këto risi po evolojnë në formën e (i) zhvillimeve në përqasjen rregullatore të autoriteteve ndaj FinTek dhe industrisë financiare dhe (ii) zhvillimeve në tregun e kriptomonedhave dhe monedhave të reja 'StableCoins' të kolateralizuara. Në sektorin publik, risitë teknologjike po evoluojnë në formën e (iii) vëmendjes nga një numër në rritje i bankave qendrore ndaj potencialit të Parasë Elektronike të Bankave Qendrore (më tej PEBQ) ose eksperimentimit laboratorik të tyre[1]. Në këtë material synohet një përmbledhje e shkurtër e zhvillimeve në këto tre aspekte të FinTek.

A.PËRQASJA RREGULLATORE NDAJ FINTEK

Zhvillimet në teknologjinë financiare kanë transformuar industrinë financiare me një ritëm të pazakontë. Teksa nga njëra anë autoritetet kombëtare, të inkurajuara nga institucionet ndërkombëtare, janë të prirura të mos pengojnë efektet pozitive të këtyre risive në zhvillimin ekonomik, autoritetet rregullatore dhe monitoruese po përballen me sfida të reja në drejtim të rregullimit të tyre. Në thelb të risive teknologjike në industrinë financiare (FinTek) qëndron sfida ndaj koncepteve ekzistuese të ofrimit të shërbimeve financiare. Rrjedhimisht, duke sfiduar format ekzistuese të ofrimit të shërbimeve financiare, risitë FinTek dalin jashtë sferave të mbulimit të kuadrit rregullator ekzistues. Ndërkohë, hartimi dhe implementimi i kornizave të reja rregullatore dhe mbikëqyrëse mbetet i vështirë për disa arsyes. Së pari, cikli ende në proces i risive teknologjike dhe ritmi tepër i lartë i tyre e bëjnë të vështirë hartimin dhe implementimin në kohë të një kornize përfundimtare. Së dyti, kostot relative të politikave potenciale në drejtim të ngadalësimit që mund t'i shkaktojnë produktivitetit në industrinë financiare përbëjnë një shqetësim frenues ndaj hartimit dhe implementimit të përshpejtuar të një kuadri rregullator (Ehrentraud, Ocampo, Garzoni, & Piccolo, 2020). Në këto kushte, përqasja rregullatore e ndërmarrë ne vende të ndryshme nuk është aspak uniform. Përqasjet dallojnë, në varësi të aktivitetit FinTek që po merr hov në secilën ekonomi dhe në varësi të hapjes që cdo vend ka ndaj këtyre aktiviteteve.

Përqasjet rregullatore nga autoritetet kombëtare ndaj aktiviteteve FinTek variojnë nga përqasjet aktive në formën e hartimit të politikave të reja në ato më të rezervuara nëpërmjet rregullimit të një aktiviteti FinTek me anë të kornizave ekzistuese.

[1] *Paraja Elektronike e Bankave Qendrore (PEBQ) është një përshtatje e termit në gjuhën angleze 'Central Bank Digital Currency (CBDC)'.*

Figura 1. Përqasjet Rregullatore



Burimi: Ehrentraud etal (2020)

Kështu, në raste kur autoritetet rregullatore shohin premisa të reja të zhvillimit të një industrie FinTech ato hartojnë regjime të reja licencuese për sipërmarrjet që synojnë aktivitete FinTek. Një formë alternative është modifikimi i kornizave rregullatore ekzistuese për të mbuluar aktivitete specifike të teknologjisë financiare. Një formë më pak angazhuese është interpretimi dhe shpjegimi i kornizave ekzistuese dhe komunikimi i pritshmërive nga autoritetet rregullatore për zbatimin e tyre nga sipërmarrësit potencialë të aktiviteteve FinTek. Padiskutim që në intervalin e përqasjeve të ndryshme të politikave rregullatore, autoritetet kombëtare mund të zbatojnë një kombinim të këtyre përqasjeve.

• BANKAT DIGJITALE

Një nga aktivitetet FinTek në zgjerim janë bankat digjitale. Sipas një anketimi të Institutit të Stabilitetit Financiar (më tej ISF) të Bankës për Rregullime Ndërkombëtare (më tej BRrN ose BIS) shumica e vendeve zbatojnë rregulloret ekzistuese ndaj këtij aktiviteti. Në këto raste, aplikantët për një licencë bankare me një model biznesi FinTek duhet të kalojë në proceset licencuese ekzistuese dhe detyrime rregullatore të njëjta si bankat me modele biznesi tradicionale. Përtej kësaj praktike standarde, në rregullimin e aplikimeve për aktivitet FinTek janë konstatuar edhe tre përqasje aktive të ndryshme nga korniza ekzistuese.

- Formati më strikt i aplikimit të regjimeve të reja të licencimit është zbatuar vetëm në dy raste, nga Autoriteti Monetar i Singaporit në vitin 2019 dhe nga Autoriteti Monetar i Hong Kong në vitin 2018.

- Një përqasje më afër kuadrit ekzistues rregullator është rasti i Bankës Qendrore Evropiane, e cila zbaton një udhëzues për interpretimin specifik të rregulloreve ekzistuese në rastin e aplikantëve me modele biznesi FinTek.

- Një praktikë fleksibël është ajo e Australisë. Në mungesë të një rregulloreje të re licencimi për bankat digjitale, Australia ka ofruar një praktikë fleksibël licencimi e cila i lejon aplikantët të zhvillojnë aktivitet të kufizuar bankingu pa qenë subjekt i tërësisë së rregulloreve që kërkohen për aktivitetin bankar, për një periudhë të kufizuar kohe. Pas përfundimit

të kësaj periudhë kohore, bankat digjitale duhet të vazhdojnë procedurën standarde të licencimit sipas kuadrit ekzistues rregullator.

- Shërbimi i Pagesave Digjitale & E-Money

Shërbimi i pagesave digjitale ofrohet si nga bankat ashtu edhe nga bizneset jo-banka. Në shumicën e vendeve këto dy aktivitete, shërbimi i pagesave digjitale dhe E-paraja (paraja elektronike), janë subjekt të rregulloreve të reja me fokus aktivitetin FinTek.

- Shërbimet Financiare që lidhen me Kriptoaktivet

Mungesa e një rregulli të standardizuar për kategorizimin e kriptoaktiveve është një sfidë e pazgjidhur për hartimin e një përqasjeje rregullatore. Në qendër të kësaj sfide mbeten transformimi i vazhdueshëm i teknologjive tek të cilat bazohen kriptoaktivet sikurse edhe dalja në treg e formave të reja të kriptoaktiveve. Nga një anketim i BRrN me bankat qendrore anëtare konstatohen tre kritere për kategorizimin e tyre.

a. Emetuesi: kriptoaktivet mund të emetohen nga sipërmarrës jashtë mbulimit të rregulloreve ekzistuese (si shembull Tether), nga institucione të licencuara dhe rregulluara (shembull: JPM Coin) ose nga sektori publik (Monedha elektronike e Bankave Qendrore).

b. Funksioni ekonomik: kriptoaktivet mund të përdoren si mjete pagese ose këmbimi (monedha pagesash), mund të përdoren si mjete investimi (monedha investimi) ose mund të ofrojnë një akses në një shërbim në të ardhmen (monedha elektronike utilitare).

c. Aktivi garantues i kriptoaktivit: kriptoaktivet mund të garantohen nga një formë e parave ekzistuese, nga metale të çmuara ose nga pasuri të paluajtshme etj.

Këto funksione të kriptoaktivit përdoren si kriter për të përcaktuar nëse një kriptoaktiv mund të rregullohet nga kornizat ekzistuese rregullatore ose nëse nuk mbulohet nga kuadri ekzistues rregullator[2]. Ndonëse përfshirja e të gjitha akteve rregullatorë dhe ligjore që lidhen me shërbimet FinTek në vende të ndryshme shkon përtej qëllimeve të këtij materiali, në informacionin e mëposhtëm paraqitet një përmbledhje e shkurtër e dy ligjeve të cilat prekin ose synojnë rregullimin e aktiviteteve që lidhen me teknologjinë financiare në Shqipëri.

• KUADRI LIGJOR NË SHQIPËRI

Në klimën e re të penetrimit të shërbimeve financiare digjitale në tërësi, dhe shërbimeve të bazuara në teknologjinë financiare FinTek, Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar dy ligje për rregullimin e këtyre aktiviteteve dhe shërbimeve. Në

[2] *Një kategorizim i detajuar i praktikave që përdorin bankat qendrore anëtare të BRrN mbi kuadrin rregullativ të kriptomonedhave gjendet tek Ehrentraud etal (2020).*

ligjin "Për shërbimet e pagesave" në Republikën e Shqipërisë ka si objekt të tij "përcaktimin e kushteve dhe rregullave për krijimin, licencimin, organizimin, veprimtarinë dhe mbikëqyrjen e institucioneve të pagesave" dhe rregullon të drejtat dhe detyrimet e përdoruesve dhe ofruesve të shërbimeve të pagesave[3]. Ndonëse ligji mbulon një gamë të gjerë shërbimeve financiare, subjekt i tij janë edhe shërbimet e ofruara nëpërmjet teknologjisë financiare (Ligji nr. 55 dt 30.4.2020 "Për shërbimet e pagesave", 2020).

Gjithashtu, një ligj tjetër që prek industrinë financiare dhe implementimin e teknologjive të reja është ligji "Për tregjet financiare të bazuara në teknologjinë e regjistrave të shpërndarë"[4]. Ky ligj ka si objekt të tij "rregullimin e aktiviteteve të emetimit të tokenëve digjitalë dhe/ ose monedhave virtualë ... " dhe vendos në korniza ligjore aktivitetet që lidhen me shërbime financiare të bazuara në monedha virtuale. Nëpërmjet sanksionimit dhe delegimit të kompetencave licencuese, monitoruese dhe rregulluese tek autoritete specifike, ky ligj sinjalizon sipërmarrësve potencialë potencialin e aktiviteteve të bazuara në teknologjinë financiare. Në tërësi ligji, nuk përjashton nga detyrimi i ofruesve të shërbimeve FinTek as në bazë të (i) ***emetuesve të monedhave virtualë,*** (ii) ***të funksionit ekonomik*** dhe as (iii) ***të llojit të kriptoaktivit*** me të cilat mund të ofrohen shërbimet (Ligji nr.66, dt. 21.5.2020 "Për tregjet financiare të bazuara në teknologjinë e regjistrave të shpërndarë", 2020).

B. ZHVILLIMET NË TREGUN E KRIPTOMONEDHAVE DHE TË 'STABLECOIN'

Në këtë pjesë do të bëjmë një diferencim midis kriptomonedhave si Bitoin, të njohura fillimisht me cilësitë të detajuara në materialin (Ahmetaj & Hoda, 2019), si dhe monedhave të reja të sektorit privat të emërtuara 'StableCoins'. Dallimi kryesor midis këtyre dy monedhave private është se kriptomonedhat si Bitcoin janë të bazuara vetëm në një algoritëm kriptografik dhe të pakolateralizuara nga ndonjë aset financiar tjetër, ndërsa (kripto)monedhat e reja 'StableCoins' kanë një kurs këmbimi të paracaktuar fiks kundrejt një monedhe kombëtare dhe konceptohen pjesërisht ose tërësisht të kolateralizuara nga aktive financiare. Një përmbledhje e shkurtër e zhvillimeve në tregun e Bitcoin si kriptomonedhë e pakolateralizuar me volumin më të madh të transaksioneve ilustron luhatjet e theksuara të çmimit të kriptomonedhës Bitcoin. Ndryshe nga kriptomonedhat e pakolateralizuara, kriptomonedhat 'stablecoin' synojnë një kurs stabël këmbimi kundrejt monedhave kombëtare dhe rrjedhimisht me një potencial më të madh si mjet pagese.

(1)ZHVILLIMET NË TREGUN E KRIPTOMONEDHËS BITCOIN

Zhvillimet në tregun e kriptomonedhave konsistojnë në episode të luhatjeve edhe më të larta të çmimeve të këtyre kriptomonedhave. Kriptomonedha më

[3] *Ligji nr. 55 datë 30.4.2020.*
[4] *Ligji nr 66 datë 21.5.2020.*

e përhapur, Bitcoin, arriti çmimin rekord prej rreth 40 mijë USD/BTC në ditët e para të vitit aktual (Janar 2021), kundrejt intervalit prej 22-26 mijë USD/BTC në 10 ditët e fundit të vitit 2020. Më herët, në muajin tetor 2020 çmimi i Bitcoin luhatej në rreth 11 mijë USD/BTC. Ky episod është rasti i dytë i një rritje të menjëhershëm të çmimit të Bitcoin. Në episodin e parë në muajin dhjetor 2017, çmimi i tij u rrit në 20,000 US/Bitcoin kundrejt rreth 5,000 USD/Bitcoin në muajt shtator-tetor të po atij viti.

Këto zhvendosje të menjëhershme të çmimit të Bitcoin, të pasuara nga luhatje të forta edhe të kriptomonedhave të tjera, nuk bazohen në ecurinë e treguesve makroekonomikë ose në pritshmëri racionale mbi ekonomitë. Edhe vëmendja e konsumatorit për të përfshirë kriptomonedha në portofolin e aktiveve të tij mbetet e vogël. Si rast ilustrimi, (Stix, 2020) konstaton se nga një anketim i realizuar në Austri vetëm 1.6% e konsumatorëve kanë kriptoaktive në zotërim. Një shkak i luhatjes së lartë të çmimit të kriptomonedhës do të ishte pasiguria e lartë në tregjet financiare tradicionale. Ndonëse ekonomitë e zhvilluara, sikurse edhe ekonomia globale, gjenden nën ndikimin e pandemisë pasiguria nuk rezulton të jetë rritur në ato nivele të shkaktojë panik dhe largim drejt formave alternative të ruajtjes së vlerës. Një tregues i ilustrues i pasigurisë është ecuria e çmimi të arit, i cili në gjashtë muajt e fundit është luhatur në intervalin 1,800-2,000 USD/Ounce[5]. Në të njëjtën periudhë që çmimi i Bitcoin ka kërcyer nga rreth 11 mijë USD/BTC (Tetor 2020) në rreth 40 mijë USD/BTC (Janar 2021), çmimi i arit ka pësuar një rënie të lehtë, respektivisht, nga rreth 1,900 USD/Ounce në rreth 1,860 USD/Ounce (Shih Grafik 1 në fund).

Grafik 1. Çmimi i Bitcoin dhe i Floririt në USD.



Burimi: www.blockchain.com; www.gold.org

Në sajë të këtyre luhatjeve të menjëhershme gjatë historisë së ekzistencës si kriptomonedhë, Bitcoin, sikurse edhe kriptomonedhat e tjera mbeten aktive me risk tepër të lartë për të konkuruar në tregun e aktiveve që shërbejnë si ruajtëse të vlerës. Ndërsa, kostoja e lartë e transaksioneve e Bitcoin e bën atë jokonkuruese në tregun e pagesave me vlerë të vogël, sikurse jemi shprehur në materialin (Ahmetaj & Hoda, 2019).

[5] *Ky çmim i arit është ekuivalent i 55,000-65,000 USD/kg.*

(2) KRIPTOMONEDHAT STABLECOINS

Përtej cilësive teknologjike në të cilat bazohen kriptomonedhat, një cilësi dalluese e tyre është luhatja tepër e lartë e çmimit. Luhatshmëria përkthehet në risk dhe risku i lartë bëhet kriter përjashtues në portofolet e aktiveve. Në fakt, stabiliteti i vlerës së parasë është cilësi kritike për të tre funksionet e mundshme të një forme të re paraje, si ruajtëse e vlerës, njësi matjeje dhe mjet pagese.

Qëndrueshmëria e vlerës mbetet një nyjë penguese për adoptimin e shpejtë të kriptomonedhave. Ideja e një kriptomonedhe me çmim të qëndrueshëm duket se do të joshte më tepër konsumatorë drejt adoptimit të saj. Kjo kategori kriptomonedhe është emërtuar 'stablecoin'. Kriptomonedhat 'stablecoin' janë një natyrë kriptomonedhe të cilat synojnë të përfitojnë nga teknologjia e kriptomonedhave dhe të adresojnë problemin e luhatshmërisë së lartë të vlerës. Stablecoin janë kriptomonedha me çmim të njehsuar ose të lidhur me një aktiv të qëndrueshëm financiar, sikurse një monedhë ndërkombëtare ose aktiv financiar tjetër.

Stablecoin emetohen me një kurs të caktuar këmbimi ndaj një monedhe kombëtare. Përgjithësisht, vlera e tyre përcaktohet 1 USD, ndonëse nuk përjashtohet mundësia e emetimit të tyre me vlerë në proporcion me indeksin e çmimeve të konsumit. Paracaktimi i vlerës së 'stablecoin' nuk lidhet me raportin kërkesë-ofertë në rastin e stablecoin, por është i ngjashëm me regjimin fiks të kursit të këmbimit të aplikuar nga ekonomitë e vogla kundrejt monedhave ndërkombëtare si USD dhe Euro.

Në varësi të cilësive të këtyre kriptomonedhave mund të behen ndarje dhe kategorizime të ndryshme. Megjithatë, një nga cilësitë kritike të saj për kategorizimin është lloji i kolateralit mbi të cilën bazohet kriptomonedha 'stablecoin'. 'Stablecoin' mund kategorizohen si monedha (i) të kolateralizuara me një monedhë kombëtare ose një shportë monedhash, (ii) të kolateralizuara me kriptomonedha ose (iii) të pa-kolateralizuara.

(I)STABLECOIN TË KOLATERALIZUARA ME MONEDHA KOMBËTARE.

Kjo kriptomonedhë është e ngjashme me depozitën bankare ose me një çek bankar por e konvertuar në një monedhë elektronike të re. Depozitimi i 1 Euro i jep të drejtën personit të zotërojë kriptomonedhë në vlerën 1 Euro e cila është e likujdueshme me 1 Euro në çdo kohë. Në fakt, kjo formë e thjeshtë e kollateralit prej 100% e bën këtë kriptomonedhë një version elektronik të monedhës Euro të emetuar privatisht. Procesi është i centralizuar tek një emetues dhe garancia e kriptomonedhës është në varësi të besueshmërisë së emetuesit. Çmimi i kriptomonedhës është po aq i sigurtë sa siguria e kolateralit (Euro) dhe e palës emetuese.

Një mekanizëm të tillë pretendon se ka kriptomonedhat Tether (https://tether.to/) dhe TrueUSD, të cilat duke qenë të audituara këto kriptomonedha mund të kthehen lehtësisht në monedha pjesërisht të kolateralizuara (Kade, 2018).

Me të njëjtin mekanizëm mund të emetohen kriptomonedha të kolateralizuara me ar. Parimet e emetimit mbeten të njëjta.

Tabela 1. 'Stablecoin' me garanci në monedhat kombëtare.

Avantazhet	Disavantazhet
Mekanizëm i thjeshtë	Proces i centralizuar – emetuesi pikë kritike e sistemit,
Stabiliteti i vlerës	Konvertimi dhe likuidimi i gjurmueshëm nëpërmjet sistemit aktual të pagesave
Rrezik minimal kriptografik (kolaterali ruhet në sistemin financiar)	Emetuesi teknikisht i audituesheme

(II)'STABLECOIN' TË KOLATERALIZUARA ME KRIPTOMONEDHA TË TJERA.

Kriptomonedhat e kolateralizuara me monedha kombëtare kanë në fokus nevojën e përfshirjes së sistemit aktual të pagesave dhe janë përgjithësisht të centralizuara. Emetimi privat i 'stablecoin' i kolateralizuar me rezerva të kriptomonedhave të tjera ruan dy cilësi kryesorë në kontekstin e risive për të cilat është popullarizuar teknologjia FinTek.Kjo formë kolateralizimi i lejon kriptomonedhës 'stablecoin' të funksionojë si (1) një mjet pagese e decentralizuar dhe (2) ruajtëse e vlerës në sajë të avantazhit të stabilitetit të vlerës. Implementimi i konceptit të garancisë me më tepër se 100% e lejon që kriptomonedha të gëzojë cilësinë e parë dhe shmang disavantazhin e çmimit të luhatshëm. Ky format garancie lejon që tëkryhet me teknologjinë e decentralizuar 'blockchain'.

Sa më e lartë shkalla e garancisë/kolateralit aq më e qëndrueshme është vlera e kriptomonedhës 'stablecoin' dhe aq më të pakta janë mundësitë e destabilizimit të pritshmërive mbi vlerën e 'stablecoin' në të ardhmen. Në rast se vlera e kriptomonedhës që shërben si garanci bie në nivele të tilla që mbulimi me kolateral prek nivelin 100 ose më pak, atëherë kriptomonedha 'stablecoin' të likuidohet dhe personi që zotëron kriptomonedhën origjinale merr vlerën 100% të garancisë në portofolin e tij.

Një problem që mund të lind nga perspektiva teknike është se kolateralizimi i një kriptomonedhe 'stablecoin' kërkon një mekanizëm që të injektojë në vazhdimësi çmimin e kriptomonedhës që shërbën si garanci në terma të një monedhe kombetare. Ky çmim shërben si vlerë referencë për përllogaritjen e mbulimit me kolateral të 'stablecoin' dhe likujdimin e kësaj të fundit. Teknologjia e decentralizuar 'blockchain' nuk është e programuar të kominikojë me faktorët e jashtëm. Mundësitë për të adresuar problemin janë dy të ndryshme. Mundësia e parë është që një dore e jashtme të publikojë vazhdimisht një sekuencë çmimesh brenda 'blockchain'. Kjo e kthen çështjen në pikën zero pasi krijon varësi ndaj një pike të centralizuar dhe mundëson manipulimin. Mundësia e dytë është integrimi i skemave 'Schelling Coin'. Këto të fundit janë skema komplekse koordinimi të informacionit nga burime të ndryshme, por në thelb çmimi referencë caktohet nga një konsensus i burimeve të informacionit.

Kjo është skema e kriptomonedhës 'TruthCoin'. Është një skemë kompleksë por me më pak mundësi manipulimi[6].

Kriptomonedhat 'stablecoin' të kolateralizuara me kriptomonedha të tjera janë një risi që tërheqin vëmendje. Vlera e tyre është shumë më e qëndrushme se kriptomonedhat bazë por më pak të qëndrueshme se kriptomonedhat e garantuara me monedha kombëtare. Sasia në qarkullim e tyre është tepër e luhatshme pasi mund të likujdohen menjëherë, me rënien e vlerës së garancisë/ kolateralit poshtë pikës kritike (100% për shembull). Kur vlera e kolateralit bie nën pikën kritike (100%) 'stablecoin' shkatërrohet nga algoritmi dhe mbajtësi i saj shpërblehet me kriptomonedhën bazë që shërben si kolateral. Portofoli i mbajtësit të kriptomonedhës 'stablecoin', në këtë pikë është i ekspozuar ndaj kriptomonedhës bazë. Rrjedhimisht ekspozimi ndaj riskut të çmimit është i njëjtë si me kriptomonedhën bazë.

Në një përmbledhje sintetike avantazhet dhe disavatazhet janë si më poshtë. Kriptomonedha e parë që 'stablecoin' që ka përdorur këtë skemë kolaterali është 'BitUSD' në vitin 2013.

Tabela 3. 'Stablecoin' me garanci në kriptomonedhat e tjera.

Avantazhet	Disavantazhet
Mekanizëm i decentralizuar	Likuidimi i menjëhershëm, veçanërisht kur çmimi i kriptomonedhës garanci bie fort.
Likuidim i shpejtë në kriptomonedhës bazë që shërben si garanci (nëpërmjet blockchain)	Çmimi më pak i qëndrueshëm se kriptomonedhat e garantuara me rezerva në monedha kombëtare
Transparente në drejtim të mbulimit me kolateral.	Trashëgon fatin e kriptomonedhave që shërbejnë si garanci
Mund të përdoret për krijimin dhe shumëfishimin e sasisë së parasë.	Shkalla e lartë e mbulimit me kolateral, jo-produktive
	Mekanizëm kompleks i kolateralizimit.

(III)'STABLECOIN' TË PA-KOLATERALIZUARA.

Ruajtja e vlerës së kriptomonedhës 'stablecoin' afër çmimit të deklaruar, prej 1 USD për shembull, mund të bazohet edhe në ankorimin e pritshmërive nga emetuesi i saj dhe në kërkesën e vazhdueshme për këtë kriptomonedhë për rolin e saj si mjet pagese apo mjet shkëmbimi.

Një pikënisje e parë për të konceptuar idenë është dalja e monedhave kombëtare nga regjimi Bretton-Woods (më tej BW) dhe sistemit i kolateralit me ar të këtyre monedhave, veçanërisht e USD. Gjatë këtij regjimi, monedhat kombëtare duhet të ishin të kolateralizuara me ar në masën 100 %. Me rënien e sistemit BW, i vetmi kolateral i këtyre monedhave ishte besueshmëria e autoriteteve emetuese dhe e thesarit të vendit që emetn monedhën.

[6] *Edhe në këtë rast kontrolli I më tepër se 50% të pjesëmarrësve në 'blockchain' e 'stablecoin'-it e bën injektimin e çmimit referencë një proces lehtësisht të manipulueshëm.*

Përtej elementëve të besueshmërisë së emetuesit, asnjë aktiv tjetër nuk garanton vlerën e monedhës kombëtare në regjimet me kurs fleksibël të këmbimit që prej 1972 (de jure 1976)[7]. Një mekanizëm i tillë sugjerohet se mund të adoptohet edhe në koordinimin dhe emetimin e një 'stablecoin' të ri i cili është i decentralizuar, sikurse kriptomonedhat e tjera, por pretendon vlerë të njehsuar me një monedhë kombëtare.

Mekanizmi garantues për emetimin e një 'stablecoin' të tillë bazohet në "Aksione të Senjorazhit" të propozuar nga Robert Sams në vitin 2014. Mekanizmi funksionon si një kontratë algoritmike (smart) me objektiv njehsimin e vlerës së monedhës së emetuar kundrejt një monedhe kombëtare dhe me instrument kontrollin mbi sasinë e parasë në qarkullim.

Nëse çmimi i 'stablecoin' është mbi vlerën njësi (për shembull mbi 1 USD) kontrata algoritmike 'printon' monedha të reja dhe i shet ato në treg derisa çmimi i 'stablecoin' të njehsohet në 1 USD. Kjo do të akumulonte të ardhura nga senjorazh në kontratën algoritmike. Këto të ardhura mund të përdoren për blerjen e monedhave dhe uljen e parasë në qarkullim në rastet kur çmimi i kriptomonedhës së re pëson rënie nën 1 USD.

Një pyetje e natyrshme lind se si mund të financohet ky mekanizëm në rast të përfundimit të rezervave nga senjorazh. Në këtë rast emetohen "aksione ndaj Senjorazhit" që janë kontrata që i japin të drejtë mbajtësve të tyre të pretendojnë të ardhurat nga senjorazhi në të ardhmen.

Megjithatë, edhe ky mekanizëm është ndërtuar mbi perspektivën s eventualisht kriptomonedha e re do të mbijetojë dhe të ardhurat nga senjorazh do të realizohen në një pikë në të ardhmen. Presioni i vazhdueshëm ndaj kursit të këmbimit kur çmimi është nën vlerën e synuar mund të çojë në akumulimin e një shume të madhe letrash me vlerë në formë aksionesh ndaj senjorazhit në të ardhmen saqë të humbasë besimin tek monedha e re dhe të çojë vlerën e saj drejt zero.

Një pikë tjetër e dobët e kriptomonedhave 'stablecoin' është besimi tek kriptomonedhat e tjera. Kur ky besim bie, portofolet e aktiveve zhvendosen përgjithësisht drejt formave tradicionale të investimit në monedha kombëtare dhe jo drejt kriptomonedhave 'stablecoin'. Rrjedhimisht, interesimi i ulët ndaj kriptomonedhave të uhatshme mund të tërheqë me vete edhe kriptomonedhat 'stablecoin'.

Për krahasim me 'stablecoin' të kolateralizuara më poshtë renditen avantazhet dhe dobësitë e stablecoin të pakolateralizuar.

[7] *Disa ekonomistë përjashtojnë nga ky përgjithësim ekonomitë në zhvillim të cilat mbajnë rezerva ndërkombëtare.*

Tabela 3. 'Stablecoin' pa garanci/kolateral

Avantazhet	Disavantazhet
Mekanizëm tërësisht i decentralizuar	Bazohet në rritjen e qëndrueshme të kërkesës për para dhe të parasë në qarkullim për të financuar skemën.
Nuk ka nevojitet për kolateral.	Çmimi i ndjeshëm ndaj zhvillimeve në tregun e kriptomonedhave me vlerë të luhatshme
	Pasiguri në lidhje me pikën kritike që garanton mbijetesën e monedhës.

C. ZHVILLIMET NË TREGUN E PARASË ELEKTRONIKE TË BANKAVE QENDRORE (PEBQ)

Ideja e një forme digjitale të parasë kombëtare është duke u zhvilluar dhe eksperimentuar në vazhdimësi nga bankat qendrore. Në anketimet e përvitshme të BRrN me bankat qendrore (më tej BQ) po vërehet jo vetëm një rritje e vëmendjes së BQ për Paranë Elektronike të Bankës Qendrore (PEBQ) por edhe një përparim i disa prej BQ nga etapa e kërkimit konceptual drejt një bindjeje së PEBQ mund të jenë të pranishme në horizontin afatshkurtër ose afatmesëm (Boar, Holden, & Wadsworth, 2020).

Në literaturë diskutohen veçori të ndryshme të parasë. Në një material të mëhershëm (Hoda, 2019) diskutohet shkurtimisht mbi dy cilësi të PEBQ,

(1) privacia/anonimiteti dhe
(2) aksesi në tregun e pagesave me vlerë të vogël kundrejt pagesave me vlerë të madhe.

Megjithatë, në literaturë diskutohen edhe karakteristika të tjera të PEBQ të cilat mund ndërthuren pjesërisht me dy karakteristikat e mësipërme, si

(3) arkitektura /emetuesi i PEBQ: banka qendrore ose ndërmjetësit financiarë,
(4) platforma/infrastruktura: e decentralizuar kundrejt e centralizuar, dhe
(5) teknologjia: monedhe elektronike kundrejt llogarisë elektronike.

Këto karakteristika rezultojnë subjekt jo vetëm i diskutimeve teorike por edhe i eksperimentimeve të ndryshme të ndërmarra nga bankat qendrore.

- Arkitektura/emetuesi. Në rastin e PEBQ të emetuar direkt nga vetë banka qendrore, paraja elektronike mbetet detyrim në bilancin e bankës qendrore.
  Megjithatë, një format tjetër në diskutim është lejimi i ndërmjetësve financiarë të konkurrojnë në emetimin e PEBQ me anë të aplikacioneve individuale[8]. Paraja elektronike në këto raste është emërtuar ***PEBQ sintetike*** (sPEBQ) dhe parashikohettë emetohet si detyrim i ndërmjetësit financiar dhe jo i bankës qendrore (Adrian & Mancini-Griffoli, 2019).

[8] *Terminologjia në gjuhën angleze Application Programming Interface (API).*

Kjo formë e parasë i lejon ndërmjetësve financiarë të emetojnë para (monedha) elektronike duke i garantuar ato me rezerva në bankën qendrore. Në këtë mënyrë, banka qendrore emeton para elektronike **në tregun e pagesave me vlerë të madhe** por jo në tregun e pagesave me vlerë të vogël. Rrjedhimisht, BQ nuk regjistron transaksionet individuale por mban një regjistër të parasë elektronike të emetuar drejt ndërmjetësve financiarë të garantuara me rezerva të ndërmjetësve në bankën qendrore. Një formë hibride e arkitekturës është ajo e emetimit të PEBQ nga banka qendrore dhe përfshirja e ndërmjetësve financiarë në ndërmjetësimin e pagesave me vlerë të vogël. Një arkitekture e tillë e PEBQ kushtëzon që PEBQ të jetë detyrim i bankës qendrore ndërsa transaksionet individuale kryhen nga ndërmjetësit financiarë. Megjithatë edhe banka qendrore, azhurnon databazën e saj të transaksioneve individuale në mënyrë periodike duke sinkronizuar regjistrin e saj me atë të ndërmjetësve financiarë pas një intervali kohor të caktuar.

- Infrastruktura/platforma: e decentralizuar ose e centralizuar. Nisur nga format e alternative të arkitekturës del qartazi se emetimi i PEBQ direkt nga banka qendrore, si një detyrim në bilancin e saj, do të vendoste BQ në dilemën e lejimit ose jo të anonimitetit/privacisë së transaksioneve. Nevoja dhe detyrimi ligjor për të adoptuar masat Kundër Pastrimit të Parasë dhe Kundër Financimit të Terrorizmit (KPP/KFF) e bëjnë të pamundur elementin e anonimitetit të transaksioneve si karakteristikë tipike e platformave të decentralizuara. Rrjedhimisht, nëse, arkitektura e zgjedhur do të jetë ajo e PEBQ direkt si detyrim në bilancin e BQ, atëherë platforma do të ishte e centralizuar.
  Nga ana tjetër, emetimi i *PEBQ sintetike* nga ndërmjetësit financiarë (më tej NF), si detyrim në bilancin e tyre, mund të lejojë një infrastrukturë të centralizuar ose të decentralizuar. Infrastruktura e centralizuar është e ngjashme me infrastrukturën aktuale, pa penguar adoptimin e aplikacioneve më të avancuara dhe më të shpejta për kryerjen e transaksioneve. Infrastruktura e decentralizuar do të lejonte regjistrimin e transaksioneve në një regjistër të cilën e mirëmbajnë dhe azhurnojnë disa ndërmjetës financiarë nëpërmjet mekanizmit të konsensusit. Ndërmjetësit financiarë të përfshirë në këtë infrastrukturë natyrshëm mund të 'licencohen' nga banka qendrore ose një autoritet i ngjashëm, të paktën për arsye të masave të nevojshme KPP/KFF. Platforma regjistruese do të ishte një platformë unike e përbashkët e të gjithë ndërmjetësve financiarë. Megjithatë problemet e shkallës dhe kufizimit në numrin e transaksioneve që një mekanizëm i tillë mundëson, probleme tashmë të njohura (shih Ahmetaj & Hoda, 2019), janë një pengesë ende e pazgjidhur për këtë lloj infrastrukture.

- *Teknologjia: monedhë elektronike ose llogari elektronike.* Mënyra më e thjeshtë në perceptimin tonë është teknologjia e llogarive elektronike të njehsuara me identitetin e individëve. Kjo është një teknologji e përafërt me format aktuale mbi të cilën funksionojnë sistemet financiare. Megjithatë kjo formë mund të jetë më pak e preferuar nga individët, nëse janë para zgjedhjes midis dy alternativave. Ideja e një privacie të pjesshme është joshëse. Monedhat elektronike mundësojnë një shkallë të pëlqyeshme

privacie të pronësisë së monedhës, i ndarë nga privacia e transaksioneve. Në këtë mënyrë, banka qendrore e njeh pronësinë ndaj monedhës vetëm nëse individi demonstron se ka një celës kriptografik të monedhës. Gjatë transaksioneve transferohet çelësi kriptografik dhe pas çdo transaksioni të transformuar një çelës unik i ri riprodhohet për zotëruesin e ri të monedhës. Disavantazhet i kësaj teknologjie janë mundësia e humbjes së çelësit kriptografik, si dhe vështirësitë për implementimin e masave KPP/KFT në kryerjen e transaksioneve. Një skicim të detajuar të kësaj teknologjie bëjnë autorët Auer etal (2020).

- PROJEKTE TË BANKAVE QENDRORE ME PEBQ

Bankat qendrore vazhdojnë kërkimin në formë konceptimi ose eksperimentimi të projekt-ideve për të mësuar më tepër mbi hapësirat për hedhjen në treg të një paraje elektronike të bankës qendrore (PEBQ). Në mungesë të një praktike të testuar, eksperimentet synojnë të mësojnë më shumë mbi alternativat e ndryshme të karakteristikave me të cilat mund të dizajnohet një PEBQ.BRnN ka publikuar një studim dhe një anketim mbi projektet e ndryshme të bankave qendrore (Auer, Cornelli, & Frost, 2020) dhe (Boar, Holden, & Wadsworth, 2020). Në këtë pjesë të materialit synohet një përmbledhje e projekteve të bankave qendrore duke u bazuar në këto dy materiale të BRrN si burim kryesor i informacionit.

Materiali i Boar etal (2020) është një anketim i përsëritur gjatë vitit 2019 me 66 banka qendrore, nga të cilat 21 BQ në ekonomitë e zhvilluara dhe 45 BQ në ekonomi tregu në zhvillim, duke mbuluar rreth 75% të popullsisë dhe 90% të ekonomisë globale. Interesimi në rritje vërehet në dis nga rezultatet e këtij anketimi.

- Rreth 80% e bankave qendrore të anketuara kanë konfirmuar një angazhim në ***formë projekti kërkimi*** me temë PEBQ gjatë vitit 2019. Një vit më herët, ky interesim rezultonte rreth 70% e BQ të anketuara.
- Mes të gjitha bankave të anketuara, rreth 40% konfirmuan se projektet e tyre kanë avancuar në ***projekte eksperimentimi ose të testimit të konceptit.***
- rreth 10% e bankave të anketuara janë angazhuar në projekte pilot përemetimin e PEBQ në periudhën aftshkurtër ose afatmesme.

Pavarësisht interesimit në rritje, nuk ka ende një prirje masive të bankave qendrore për tu angazhuar në projekte të emetimit të PEBQ periudhën afatshkurtër. Nga ky përgjithësim bëjnë përjashtim bankat qendrore të disa ekonomive.

- Bahamas dhe Karaibet Lindore. Shtetasit e këtyre ekonomive jetojnë në ishuj të vegjël. Sigurimi i shërbimeve financiare dhe aksesi sa më i lartë i popullsisë në produkte financiare janë motivet kryesore të autoriteteve në këto dy ekonomi për të avancuar në projekte pilot të emetimit të PEBQ.
- Suedi dhe Uruguai. Bankat qendrore të këtyre ekonomike po zhvillojnë projekte pilot për PEBQ për të plotësuar funksionet e parasë fizike në qarkullim. Projektet e këtyre bankave synojnë një PEBQ që nuk paguan ose fiton interes, jo-anonime dhe me kufizime të sasisë që mund të mbahen dhe shpërndahen nga ndërmjetësit financiarë.

Motivet për projektet kërkuese të bankave qendrore janë të ndryshme. Në ekonomitë e tregut në zhvillim dominon objektivi i reduktimit të parasë fizike në qarkullim. Në ekonomitë e avancuara dominon ofrimi i një forme alternative të kryerjes së pagesave në kushtet e uljes së parasë fizike.

Përtej informacionit të marrë nga anketimet e bankave qendrore Auer etal (2020) analizojnë materialet kërkimore dhe informacionin e publikuar nga bankat qendrore për të hulumtuar mbi motivet, arkitekturën, problematikën dhe përfitimet që mund të shoqërojnë emetimin e PEBQ. Në studim konstatohen 17 projekte ose raportime të bankave qendrore të ndryshme (deri në kohën e publikimit të materialit, muaji shkurt 2020).

Bazuar në këto ekzaminime, autorët konstatojnë i ndajnë këto projekte në bazë të karakteristikave kryesore të specifikuara në pjesën e parë të informacionit mbi PEBQ.

- *Arkitektura.* Konstatohen 5 projekte me arkitekturë të emetimit të PEBQ direkt nga banka qendrore, dhe 2 projekte të PEBQ indirekt, nëpërmjet ndërmjetësve financiarë. Pjesa tjetër prej 10 projektesh po eksperimentojnë disa versione të arkitekturës së parasë elektronike.

- *Infrastruktura.* Mes projekteve pilot të BQ, vetëm 1 prej tyre bazohet në teknologjinë ekzistuese të sistemit financiar, ndërsa 5 prej tyre po eksperimentojnë me teknologjinë e regjistrit të decentralizuar (më tej TRD). Nga raportimet e bankave qendrore, eksperienca me këtë teknologji nuk rezulton inkurajuese.
  - Banka qendrore e Suedisë ngre shqetësimin e ***problemit të shkallës*** së transaksioneve me teknologjinë TRD (Banka Qendrore e Suedisë, 2018).
  - Banka Qendrore e Ukrainës raporton se infrastruktura TRD nuk mundëson ndonjë avantazh në rast se sistemi i emetimit të PEBQ është një sistem i centralizuar (Banka e Ukrainës, 2019).
  - Banka Qendrore e Karaibeve Lindore konstaton se në kushtet e ndërprerjes së rrymës elektrike, transaksionet me TRD nuk garantojnë sigurinë dhe efektivitetin që garantojnë transaksionet me para fizike (BQKL, 2021)

- *Teknologjia: monedhë vs llogari elektronike.* Prej 17 projekteve të listuara gjithsej, 3 prej tyre konsiderojnë akses në PEBQ në formë monedhe digjitale, ndërsa 3 të tjerë parashikojnë akses në formën e llogarive elektronike.

Së fundmi, në këto projekte të PEBQ për transaksione konsumatore nuk parashikohen lidhje ose transaksione ndërkombëtare. Një grup tjetër iniciativash synojnë eksperimentimin me PEBQ për transaksione me vlerë të madhe në tregjet financiare ndërkombëtare të renditura më poshtë.
- Projekti Jasper i Bankës së Kanadasë;
- Projekti Ubin i autoritetit Monetar të Singaporit;
- Projekti Stella i BQE dhe Bankës së Japonisë;
- Projekti Lion Rock-Inthanon i Autoritetit Monetar të Hong Kong dhe Bankës së Tajlandës.

PUNËT E CITUARA

Adrian, T., & Mancini-Griffoli, T. (2019). The rise of digital money. IMF Note, no 19/001, July.

Auer, R., Böhme, R., & Wadsworth, A. (2020). An introduction to public-private key cryptography in digital tokens. BIS Quarterly Review (March), 73.

Auer, R., Cornelli, G., & Frost, J. (2020). Taking stock: ongoing retail CBDC projects. BIS Quarterly Review (01 March 2020).

Banka e Ukrainës. (2019). Analytical Report on the E-hryvnia Pilot Project. Raporti Bankës së Ukrainës (Kiev 2019).

Banka Qendrore e Suedisë. (2018). Riksbank's e-krona project: Report 2. Raport i RiksBank të Suedisë.

Boar, C., Holden, H., & Wadsworth, A. (2020). Impending arrival - a sequel to the survey on central bank digital currency. BIS Papers No. 107 (23 January 2020).

BQKL. (2021). ECCB digital EC currency pilot: what you should know. Gjetur në Banka Qendrore e Karaibeve Lindore: https://www.eccb-centralbank.org/p/what-you-should-know-1

Ehrentraud, J., Ocampo, D. G., Garzoni, L., & Piccolo, M. (2020). Policy Responses to fintech: a cross-countr overview. FSI Insights No. 23 (30 January 2020).

Hoda, B. (2019). Paraja Elektronike dhe Teknologjia Financiare: Një Përditësim. (matrial i papublikuar).

Kade, S. (2018). TrueUSD: A Stablecoin That You Can Redeem 1-for-1 for US Dollars, Jan 24, 2018. Gjetur në https://blog.trusttoken.com/trueusd-a-usd-backed-stablecoin-you-can-trust-9688796cfd0d

Ligji nr. 55 dt 30.4.2020 "Për shërbimet e pagesave". (2020). Fletorja Zyrtare e RSh Nr. 123 (2 Korrik 2020).

Ligji nr.66, dt. 21.5.2020 "Për tregjet financiare të bazuara në teknologjinë e regjistrave të shpërndarë". (2020). Fletorja Zyrtare e RSh Nr. 136 (21 Korrik 2020).

Stix, H. (2020). Which factors drive consumers to adopt crypto-assets? Results from an Austrian survey. Oesterreichische Nationalbank, SUERF Policy Note, Issue No 180.

REMITANCAT DHE NDIKIMI I TYRE NË VARFËRI: RASTI I SHQIPËRISË[1]

Elona Dushku[2], Departamenti i Kërkimeve, Banka e Shqipërisë
Argita Frashëri[3], Departamenti i Statistikave, Banka e Shqipërisë

ABSTRAKT:

Qëllimi i këtij artikulli është të vlerësojë ndikimin e dërgesave të emigrantëve në varfëri, bazuar në të dhënat e nivelit të familjes, të marra nga vala e parë e Anketës së Pasurisë Familjare në Shqipëri, kryer nga Banka e Shqipërisë në bashkëpunim me INSTAT(Instituti i Statistikave), gjatë vitit 2019. Të dhënat e vrojtimit tregojnë që 23% e familjeve shqiptare marrin remitanca, mesatarisht rreth 2,000 euro në vit, që ndryshon sipas grupeve të ndryshme të familjeve dhe rajonit. Të dhënat tregojnë se remitancat janë burimi i dytë më i rëndësishëm i të ardhurave të familjes, pas të ardhurave nga puna. Vlerësimet e bazuara në regresionet probit tregojnë se remitancat kanë një ndikim pozitiv dhe domethënës në uljen e varfërisë së familjeve në Shqipëri.

1. HYRJE

Migrimi është identifikuar si një nga faktorët më të rëndësishëm të shekullit të 21-të që ndikon në marrëdhëniet ekonomike midis vendeve të zhvilluara dhe atyre në zhvillim (Adams dhe Page, 2003). Kombet e Bashkuara, në fillim të këtij shekulli, kanë vlerësuar se 2.8% e popullsisë së botës ose rreth 174 milion njerëz jetojnë dhe punojnë jashtë vendit të tyre të lindjes. Për më tepër, shifrat e fundit tregojnë se migrimi është një fenomen në rritje dhe se bota, në këtë periudhë, po përballet me krizën më të thellë të migrimit që ka parë në të gjithë historinë e saj (Banka Botërore, 2019). Vlerësimet e bëra nga Kombet e Bashkuara për vitin 2017, tregojnë se numri i përgjithshëm i emigrantëve në botë është 274 milionë, i rritur me 98 milionë (ose 56%) në krahasim me shifrat e vitit 2000. Emigrantët në 2019 përbëjnë 3.5% të totalit të popullsisë botërore, ku Evropa dhe Amerika e Veriut përfaqësojnë vendet me stokun më të madh të emigrantëve në botë, përkatësisht me 82.3 milionë dhe 58.6 milionë (Banka Botërore, 2019).

Migrimi është një fenomen shumëdimensional që prek të dyja ekonomitë - si atë të vendit dërgues, ashtu edhe atë të vendit pritës - në shumë mënyra. Përveç ndikimit ekonomik, social dhe kulturor që migrimi ka kryesisht në vendet që eksportojnë emigrantë, të ardhurat që ata dërgojnë në vendin e tyre të origjinës

[1] *Mendimet e shprehura në këtë artikull janë të autorëve dhe nuk reflektojnë këndvështrimin dhe opinionin e Bankës së Shqipërisë.*

[2] *Përgjegjëse Sektori e Kërkimit Mikroekonomik, Departamenti I Kërkimeve, Banka e Shqipërisë, edushku@bankofalbania.org*

[3] *Drejtor, Departamenti i Statistikave Financiare, Banka e Shqipërisë, afrasheri@bankofalbania.org*

janë ndoshta lidhja më e drejtpërdrejtë midis migrimit dhe zhvillimit ekonomik të vendit (Ratha, 2007). Në nivel global, në vitin 2019, remitancat arritën nivelin e 689 miliardë dollarëve (Banka Botërore, 2019) dhe përfaqësojnë burimin më të madh të të ardhurave për shumë vende në zhvillim. Flukset e dërgesave të emigrantëve priren të jenë më të qëndrueshme dhe kundërciklike sesa fluksi i kapitalit, dhe gjatë krizës së fundit financiare flukset e remitancave u shfaqën më të qëndrueshme (Ratha, 2011). Burimi kryesor i të dhënave mbi dërgesat e emigrantëve janë të dhënat e bilancit të pagesave. Megjithatë, vlerësimi i madhësisë së saktë të remitancave është i vështirë sepse shumica e dërgesave të emigrantëve dërgohen përmes kanaleve jozyrtare. Sidoqoftë, literatura empirike e bazuar në analizat ndërmjet vendeve dhe në nivel vendi ka treguar se dërgesat e emigrantëve kanë ndikuar në zvogëlimin e pjesës së varfër të popullsisë (Adams dhe Page 2003, 2005; Gupta, Pattillo, and Wagh 2009) dhe se ato (remitancat) janë një burim i rëndësishëm i të ardhurave të familjes. Remitancat përdoren për të rritur nivelin e konsumit, kursimeve, investimeve, ndërmjetësimin financiar të familjes, duke kontribuuar në zvogëlimin e varfërisë dhe përmirësimin e perspektivës së përgjithshme të rritjes ekonomike (Ratha et al, (2011)).

Shqipëria përfaqëson një rast interesant ku migrimi është një fenomen shumë i përhapur dhe i njohur. Shumë shqiptarë kanë të afërm ose miq që punojnë ose jetojnë jashtë vendit. Në vitin 2017, vlerësohet se 1.21 milion shqiptarë ose 42.7% e popullsisë shqiptare jetojnë jashtë kufijve të Shqipërisë (UN DESA 2017, 2019, Banka Botërore 2017) dhe 98% e emigrantëve shqiptarë janë zhvendosur në pesë shtetet kryesore të destinacionit të emigrantëve në botë (Banka Botërore, 2019). Në nivelin makroekonomik, remitancat në Shqipëri përbëjnë një nga hyrjet më të mëdha valutore që vijnë nga jashtë dhe janë një burim i rëndësishëm i financimit të bilancit të pagesave. Mesatarisht, gjatë periudhës 2008-2018, remitancat vlerësohen në 11.7% të PBB-së (Banka e Shqipërisë, 2019). Të dhënat e përgjithshme të remitancave marrë nga bilanci i pagesave, edhe pse tregojnë rëndësinë e tyre në nivel makro, tregojnë pak për rëndësinë e tyre në nivel familjeje. Shumica e artikujve që kanë diskutuar mbi fenomenin e dërgesave të emigrantëve në Shqipëri janë fokusuara kryesisht në karakteristikat e emigrantëve dhe motivet e tyre për dërgimin e remitancave (Gëdeshi (2000), Frashëri (2007), Zanger-Siegel (2007), (Abazaj (2011), Gëdeshi-Jorgoni (2012)), pa analizuar ndikimin e remitancave në varfëri.

Ky artikull bazuar në të dhënat e nivelit të familjes nga vala e parë e Anketës së Pasurisë së Familjeve Shqiptare (APFSH), zhvilluar nga Banka e Shqipërisë në fillim të vitit 2019, analizon ndikimin që remitancat kanë mbi varfërinë në Shqipëri. Të dhënat e marra nga ky vrojtim tregojnë se 23% e familjeve shqiptare kanë marrë të ardhura nga emigrantët gjatë vitit 2018 dhe vlerësohet se remitancat janë burimi i dytë më i rëndësishëm i të ardhurave të familjeve. Për më tepër, rezultatet empirike të bazuara në modelet probit tregojnë se remitancat ndikojnë në uljen e probabilitetit të familjeve shqiptare për të qenë të varfra.

Artikulli është i organizuar në tri pjesë. Pjesa e dytë bën një përmbledhje të metodologjisë së të dhënave të mbledhura nga Anketa e Pasurisë Familjare Shqiptare dhe vazhdon me prezantimin e modelit empirik, ndërsa në pjesën e tretë dhe të katërt janë diskutuar rezultatet dhe gjetjet kryesore të këtij artikulli.

2. METODOLOGJIA

Në këtë artikull, burimi kryesor i të dhënave janë të dhënat në nivel familjeje të marra nga vala e parë e Anketës së Pasurisë Familjare Shqiptare (Dushku, 2019), kryer nga Banka e Shqipërisë në vitin 2019, në bashkëpunim me INSTAT-in. Ky vrojtim u bazua në metodologjinë dhe pyetësorin e HFCN (Rrjeti i Financave dhe Konsumi i Familjeve), e aplikuar nga të gjitha bankat qendrore në Bashkimin Evropian, dhe është përshtatur bazuar në veçoritë e familjeve shqiptare. Qëllimi kryesor i kësaj ankete është marrja e informacionit të detajuar mbi familjet shqiptare, në lidhje me të ardhurat, shpenzimet, pasuritë reale dhe financiare të tyre, statusin e punësimit dhe nivelin e arsimimit të të gjithë anëtarëve të familjes etj. Anketa e Pasurisë së Familjeve Shqiptare u krye në bashkëpunim me INSTAT-in, i cili mblodhi të dhënat përmes metodave të intervistave ballë për ballë, gjatë periudhës mars-prill 2019, dhe siguroi zgjedhjen e familjeve. Dizenjimi i zgjedhjes u bazua në zgjedhjen probabilitare, në mënyrë që të ketë një përfaqësim të plotë të të gjitha familjeve në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë; madhësia e popullsisë në dymbëdhjetë rajonet e saj u përdor si kriter shtresëzimi. Përkundër të dhënave të ndryshme për bilancin e familjeve shqiptare, ne kemi mbledhur të dhëna nëse familjet kanë marrë remitanca ose jo dhe sa. Kështu, dy pyetjet kryesore nga anketa që janë të lidhura me migrimin dhe dërgesat e parave janë:

- A keni marrë ju ose ndonjë anëtar i familjes tuaj remitanca gjatë vitit 2018?
- Sa remitanca (në terma vjetorë) keni marrë ju ose familja juaj gjatë vitit 2018?

Duhet të theksojmë se kjo anketë nuk është një anketë e fokusuar në migracionin e popullsisë ose në dërgesat e emigrantëve, kështu që kemi mungesë informacioni në lidhje me arsyet pse shqiptarët emigrojnë dhe si i përdorin ato. Megjithatë, duke marrë parasysh avantazhin e të dhënave në nivel familjeje, qëllimi ynë është të analizojmë ndikimin që dërgesat e emigrantëve kanë në varfëri në familjet shqiptare.

Dushku (2019), duke përdorur të dhënat e APFSH-së, ka gjetur se 23% e totalit të familjeve shqiptare kanë marrë remitanca gjatë vitit 2018. Mesatarisht, familjet kanë marrë afërsisht 2,000 euro në vit, të cilat ndryshojnë sipas grupeve të ndryshme të familjeve dhe rajoneve. Të dhënat treguan se familjet pritëse të dërgesave të emigrantëve ishin kryesisht të vendosura në rajonin e Tiranës, Elbasanit dhe Vlorës. Ndërsa bazuar në shumat e remitancave, familjet më përfituese ishin ato të vendosura në rajonin e Elbasanit, Durrësit dhe Tiranës.

Përveç kësaj, ne kemi vlerësuar sa të rëndësishme janë remitancat për të ardhurat e familjeve. Bazuar në informacionin e detajuar për të gjitha burimet e të ardhurave të familjes, kemi gjetur se: dërgesat e emigrantëve janë burimi i dytë më i rëndësishëm i të ardhurave të familjeve, duke zënë 14% deri 23% të të ardhurave totale; mbas të ardhurave nga puna, të cilat zënë 49% deri 64% të të ardhurave totale; ndërsa burimet e tjera të të ardhurave si të ardhurat nga qiraja ose interesi, apo kontributet sociale përbëjnë 20% ose më pak të të ardhurave totale të familjes.

Meqenëse ne përpiqemi të shpjegojmë ndikimin që dërgesat e emigrantëve kanë në varfërinë e familjeve, fillimisht do të përshkruajmë disa karakteristika të familjeve, duke marrë parasysh ndryshimet midis familjeve që marrin dhe atyre që nuk marrin remitanca. Të dhënat në tabelën 1 tregojnë se familjet që marrin remitanca kanë mesatarisht më pak anëtarë, më pak fëmijë nën moshën 5 vjeç dhe një numër më të ulët të meshkujve mbi moshën 15 vjeç në krahasim me familjet që nuk marrin remitanca. Për më tepër, familjet që nuk marrin remitanca karakterizohen mesatarisht me një numër më të lartë të femrave mbi moshën 15 vjeç dhe me kryefamiljar më të vjetër në moshë. Të dhënat e tjera tregojnë për dallime të vogla midis dy grupeve të familjeve përsa i përket numrit të anëtarëve të familjes mbi moshën 15 vjeç me arsim fillor dhe të mesëm, por tregojnë se familjet që marrin remitanca kanë më pak anëtarë të familjes me arsim të lartë. Të dy grupet e familjeve dallojnë në lidhje me shpenzimet mesatare mujore të familjes për frymë (pa përfshirë remitancat), të cilat tregojnë se remitancat janë jetike për grupin e familjeve që i marrin ato.

Tabela 1. Karakteristikat e familjeve që nuk marrin remitanca dhe atyre që marrin remitanca

	Familjet jomarrëse të remitancave	Familjet marrëse të-remitancave
Kapitali human		
Numri mesatar i anëtarëve mbi moshën 15 vjeç me arsim fillor	1.77	1.76
Numri mesatar i anëtarëve mbi moshën 15 vjeç me arsim të mesëm	1.14	1.12
Numri mesatar i anëtarëve mbi moshën 15 vjeç me universitet	0.42	0.38
Karakteristikat e familjeve		
Mosha mesatare e kryefamiljarit (vitet)	55	60
Edukimi mesatar i kryefamiljarit (vitet e arsimit)	10.3	9.7
Madhësia mesatare e familjes	3.8	3.2
Numri mesatar i meshkujve në familje mbi moshën 15 vjeç	1.68	1.58
Numri mesatar i femrave në familje mbi moshën 15 vjeç	1.64	1.69
Numri mesatar i fëmijëve në familje nën moshën 5 vjeç	.16	.13
Pasuria		
Vlera mesatare e shtëpisë (në milion lekë)	5.98	5.73
Shpenzimet mesatare mujore të familjes për frymë (pa përfshirë remitancat) në lekë	10,851.25	3,388.34
Shpenzimet mesatare mujore të familjes për frymë (përfshirë remitancat) në lekë	10,905.08	11,525.51
Zona (1 = Veri, 2 = Qendra, 3 = Jug-Lindje, 4 = Jug)	2.22	2.26
Numri i familjeve	1,569	537

Burimi: Të dhënat e Anketës së Pasurisë së Familjeve Shqiptare (APFSH, 2019).

Nëpërmjet analizës tonë ekonometrike, ne synojmë të modelojmë ndikimin që të ardhurat nga emigrantët kanë në varfërinë e familjeve. Bazuar në punën e Raihan et al. (2009), Wurku dhe Marangu (2015) dhe Abbas et al. (2014), kemi vlerësuar një model regresioni probit si më poshtë:

$$P_H^*_i = x_i` \beta + \mu_i$$

Ku P_H_i është një variabël cilësor, i cila është përdorur për të përcaktuar nëse familja është e varfër apo jo, x_i janë variablave ekzogjenë dhe μ_i një variabël i rastit. Një familje konsiderohet e varfër nëse hendeku midis kufirit të varfërisë ***(Poverty_line*)*** dhe të ardhurave të familjes ***(H_income*$_i$)*** është pozitiv, përndryshe konsiderohet jo e varfër. Vija e pragut të varfërisë, ***(Poverty_line*)*** përcaktohet si minimumi i të ardhurave të nevojshme për të mbuluar nevojat bazë (Banka Botërore, 2019) bazuar në indeksin e Foster-Greer-Thorbecke[4].

$$P_H_i = \begin{cases} 1 \; if \; Poverty_line^* - H_income_i > 0 \\ 0 \; if \; Poverty_line^* - H_income_i \leq 0 \end{cases}$$

Ndërsa probabiliteti që një familje të jetë e varfër përcaktohet si më poshtë:

$$Pr\,(y_i = 1|x_i\,\beta) = Pr\,(Poverty^*_i > 0 \;\; = Pr\,(\,x_i`\,\beta + \mu_i > 0) = 1\text{-}F_u\,(\text{-}x_i`\,\beta)$$

Ku F_u është funksioni i shpërndarjes kumulative të u-së.

Si të dhënat mbi ardhurat dhe ato mbi konsumin e familjeve janë të dhëna të disponueshme nga APFSH-ja, megjithatë treguesi ynë i varfërisë bazohet në të dhënat e konsumit. Një arsye për këtë preferencë është se konsumi i nënshtrohet më pak goditjeve ekonomike afatshkurtra dhe zakonisht të ardhurat e familjeve nënvlerësohen nga vetë ato. Si tregues ekzogjenë kemi përfshirë ata tregues të cilët kanë tendencë të kapin karakteristikat e kryefamiljarit të familjes dhe ato të familjeve. Ne kemi shtuar tregues cilësorë për gjininë, gjendjen martesore dhe profesionin e kryefamiljarit, si dhe vitet e arsimit të tij. Ne kemi përfshirë numrin e anëtarëve të familjes dhe numrin e fëmijëve nën 5 vjeç për të marrë informacion mbi nëse ka ndryshime të sjelljes midis familjeve sipas madhësisë dhe numrit të fëmijëve. Përveç kësaj, kemi përfshirë një tregues cilësor të barabartë me një nëse familjet kanë marrë të ardhura nga emigrantët gjatë vitit 2018 dhe zero në të kundërt, për të testuar ndikimin që ato kanë në varfëri. Gjithashtu, kemi përfshirë shpenzimet familjare për frymë (pa përfshirë remitancat) si tregues për të vlerësuar efektin e të ardhurave në probabilitetin e familjeve për të qenë të varfra.

[4] *Indeksi është llogaritur si më poshtë:* $Poverty_\alpha = \frac{1}{N}\sum_{i=1}^{H}\left(\frac{z-y_i}{z}\right)^\alpha$ *.Ku, H është numri i përgjithshëm i familjeve të varfra, të ardhurat e të cilave janë nën kufirin e varfërisë, y_i janë shpenzimet (ose të ardhurat) e ith të familjes individuale, N është numri i përgjithshëm i familjeve dhe z është kufiri i varfërisë. Ne kemi përdorur si masë të kufirit të varfërisë të ardhurat ditore për frymë të propozuara nga Banka Botërore në vitin 2019 që janë 3 $ në ditë për vendet në zhvillim. α është një indeks parametrash, i cili merr vlerën 0, 1 dhe 2 dhe përdoret për të llogaritur tregues të ndryshëm të varfërisë.*

3. REZULTATET

Meqenëse qëllimi ynë është të hetojmë ndikimin e dërgesave të emigrantëve në varfëri, rezultatet e vlerësuara për 2,106 familje janë paraqitur në tabelën 2. Në kolonën 1 kemi paraqitur ndikimin që remitancat kanë në varfërinë e familjeve, ku si prag të varfërisë kemi përdorur përkufizimin e dhënë nga Banka Botërore (2019), përmendur më lart. Për të vlerësuar qëndrueshmërinë e rezultateve në kolonën 2 dhe 3 kemi paraqitur rezultatet, ku kufiri i varfërisë së familjeve bazohet në përkufizimin e dhënë nga OECD-ja[5].

Tabela 2. Rezultatet e vlerësuara bazuar në regresionet e modelit probit

	I-pragu i varfërisë i Bankës Botërore poverty line	II-60 % i medianës së shpenzimeve të familjeve për frymë	III-60 % i medianës të shpenzimeve uniforme
Kryefamiljari: Mashkull	0.248***	0.352***	0.226***
p-vlera	*(0.009)*	*(0.002)*	*(0.040)*
Kryefamiljari: Mosha	0.016**	-0.031***	0.007
p-vlera	*(0.053)*	*(0.001)*	*(0.458)*
Kryefamiljari:Mosha^2/100	-0.020**	0.013	-0.012
p-vlera	*(0.024)*	*(0.205)*	*(0.228)*
Kryefamiljari: Martuar	0.072	-0.075	-0.239**
p-vlera	*(0.496)*	*(0.554)*	*(0.047)*
Kryefamiljari: Vitet e edukimit	0.059*	0.030	0.042
p-vlera	*(0.085)*	*(0.461)*	*(0.302)*
Kryefamiljari: (Vitet e edukimit)^2/100	-0.774***	-0.685***	-0.709***
p-vlera	*(0.000)*	*(0.003)*	*(0.003)*
Kryefamiljari: I papunës	0.300***	0.316***	0.271***
p-vlera	*(0.003)*	*(0.001)*	*(0.006)*
Numri i anëtarëve të familjes	*0.251****	*0.215****	*-0.031*
p-vlera	*(0.000)*	*(0.000)*	*(0.227)*
Numri i fëmijëve nën 5 vjeç	0.115	0.188*	0.136*
p-vlera	*(0.125)*	*(0.010)*	*(0.075)*
Shpenzimet familjare për frymë (pa përfshirë remitancat)	-0.088***	-0.013***	-0.061***
p-vlera	*(0.000)*	*(0.000)*	*(0.000)*
Marrës të remitancave	-0.701	-0.405	-0.712
p-vlera	*(0.000)****	*(0.000)****	*(0.000)****
Numri i familjeve	2102	2102	2102

*Shënim: ***, **, * tregojnë rëndësinë në nivelin 1%, 5% dhe 10%, respektivisht.*

Rezultatet e vlerësuara tregojnë për një rezultat të rëndësishëm dhe domethënës të remitancave në varfëri, e cila është në përputhje me literaturën që dërgesat e emigrantëve rrisin nivelin e të ardhurave të familjeve që marrin remitanca, si rezultat rrisin nivelin e konsumit dhe kursimeve. Pastaj kjo rritje e të ardhurave zvogëlon vulnerabilitetin e familjes dhe si rezultat redukton varfërinë e saj. Ne kemi gjetur se familjet më të mëdha kanë më shumë gjasa të jenë të varfra, përkundrejt familjeve më të vogla. Gjithashtu, rezultatet tona tregojnë se statusi si i papunë i kryefamiljarit ndikon pozitivisht në probabilitetin që familja të

[5] *Individët nën rrezikun e varfërisë janë ata individë (familje) me të ardhura të disponueshme (neto) uniforme nën pragun e rrezikut të varfërisë, i cili është sa 60% e mesatares kombëtare të të ardhurave të disponueshme. Të ardhurat e disponueshme uniforme janë të ardhurat totale të një familjeje, pas taksave dhe zbritjeve të tjera, që janë në dispozicion për shpenzime ose kursime, të pjesëtuara me numrin e anëtarëve të familjes dhe numrin e anëtarëve të familjeve në katror.*

jetë e varfër. Niveli i arsimimit të kryefamiljarit ka një efekt në formën e u-së në probabilitetin e të qenit të varfër, gjë që konfirmon se niveli më i lartë i arsimimit shoqërohet me probabilitet më të ulët që familja të jetë e varfër. Ne kemi gjetur se shpenzimet familjare për frymë ndikojnë negativisht në probabilitetin që familja të jetë e varfër, ndërsa për ndikimin e moshës së kryefamiljarëve kemi gjetur rezultate të përziera.

4. PËRFUNDIME

Përgjithësisht, familjet karakterizohen nga një nivel i konsiderueshëm heterogjeniteti, jo vetëm për sa i përket financave të tyre, por edhe për sa i përket sjelljes ndaj tyre. Kjo ka çuar në një vëmendje më të madhe ndaj analizës së të dhënave në niveli mikro, në mënyrë që të ilustrojë më mirë heterogjenitetin që ekziston në të dhënat e familjeve. Pas krizës së fundit financiare, të dhënat e familjeve kanë filluar të përdoren për të vlerësuar cenueshmërinë financiare të familjes, bazuar në faktorë të ndryshëm socio-ekonomikë. Për më tepër, këto të dhëna përdoren për të identifikuar ato grupe familjesh që janë më të prekshme ndaj faktorëve të ndryshëm të rrezikut dhe sesi mund të dëmtojnë stabilitetin financiar të vendit në tërësi.

Rezultatet e valës së parë të të dhënave të Anketës së Pasurisë së Familjeve Shqiptare konfirmojnë se remitancat vazhdojnë të jenë një burim i rëndësishëm i të ardhurave të familjeve shqiptare gjatë dekadës së fundit. Në Shqipëri, 23% e familjeve kanë marrë remitanca gjatë vitit 2018, me një fluks mesatar vjetor të remitancave për familje në rreth 2,000 euro. Tirana, Elbasani dhe Vlora ishin rajonet më përfituese për sa i përket sasisë dhe përqindjes së familjeve që kanë marrë remitanca.

Rezultatet empirike konfirmojnë se dërgesat e emigrantëve kanë zvogëluar probabilitetin që familja të jetë e varfër, përfundim ky në përputhje me literaturën që sugjeron se dërgesat e emigrantëve rrisin nivelin e të ardhurave të familjeve që marrin remitanca, si rezultat rrisin nivelin e konsumit dhe kursimeve dhe si rrjedhojë, zvogëlojnë varfërinë. Kur kontrollojmë për treguesit e tjerë, gjejmë një marrëdhënie në formë u-je midis arsimit dhe varfërisë. Si dhe gjejmë se madhësia e familjes dhe statusi i kryefamiljarit si i papunë ndikojnë pozitivisht në probabilitetin që familjet të jenë të varfra.

REFERENCA:

Abazaj, E, (2011), "Ecuria e remitancave në Shqipëri për periudhën 1996-2010 dhe faktorët përcaktues të tyre", Banka e Shqipërisë, Buletini Ekonomik, 6M-2011.

Adams, R.H., & J. Page. (2003), "International Migration, Remittances and Poverty in Developing Countries." World Bank Policy Research Working Paper, No. 3179, World Bank.

Adams, R.H., & J. Page. (2005), "Do International Migration and Remittances Reduce Poverty in Developing Countries?"‖ World Development, Vol. 33, No. 10, pp. 1645-1669.

Adams, R.H., & J. Page. (2005), "Do International Migration and Remittances Reduce Poverty in Developing Countries?"‖ World Development, Vol. 33, No. 10, pp. 1645-1669.

Dushku, E "Households and remittances: Evidence based on Household finance and consumption survey", Remittances and Payments, Bank of Albania, 2019,p 34-43

Frashëri, A (2007), "Informacion mbi rezultatet e vrojtimit pranë familjeve", Banka e Shqipërisë, Buletini Ekonomik, Vëllimi 10, nr. 3.

Gëdeshi, I (2000), "Role of Remittances from Albanian Emigrants and Their Influence in the Country's Economy" Eastern European Economics, vol. 40, no. 5.

Gësheshi, I & Jorgoni, E., (2012), "Social impact of emigration and rural-urban migration in Central and Eastern Europe"; Final country report, European Commision.

Ratha, D., Mohapatra, S., Scheja, E., (2011), "Impact of Migration on Economic and Social Development", World Bank Policy Research Working Paper, WP5558.United Nation (2019)

World Bank, (2019), "Migration and Brain Drain"; Europe and Central Asia Economic Update, Fall, 2019.

Zanker, J. H. and Siegel, M. (2007). "The determinants of remittances: A review of the literature". USA: Maastricht University, Working Paper.

"KANALI I KREDISË DHE TRANSMETIMI MONETAR NË VENDET E EVROPËS QENDRORE, LINDORE E JUGLINDORE"

Meri Papavangjeli[1], Departamenti i Kërkimeve, Banka e Shqipërisë

1. HYRJE

Përcaktimi i natyrës së mekanizmit të transmetimit monetar në një ekonomi tregu është mjaft i vështirë, por kjo detyrë bëhet edhe më e vështirë për ekonomitë në tranzicion (Wróbel dhe Pawlowska, 2002; Golinelli dhe Rovelli, 2005). Gjatë epokës së ekonomisë së planifikuar dhe periudhës së tranzicionit të hershëm, nuk kishte asnjë mekanizëm të transmetimit monetar të tipit të ekonomisë së tregut në këto ekonomi, për shkak të moszhvillimit të institucioneve financiare dhe tregjeve. Për më tepër, ky mekanizëm nuk mund të vlerësohej, pasi nuk kishte asnjë proces të gjenerimit dhe grumbullimit të të dhënave. Nga mesi i viteve '90, institucionet dhe tregjet financiare u zhvilluan mjaftueshëm sa politikëbërësit të fillonin të përdornin mekanizmat tradicionalë të transmetimit monetar, mjetet e politikës monetare, duke rezultuar në një politikë monetare të qëndrueshme. Disponueshmëria e të dhënave vijon të mbetet problem dhe të kufizojë ekspertët në kryerjen e analizave sasiore (Gavin dhe Kemme, 2004).

Analiza e mekanizmit të transmetimit të politikës monetare në ekonomitë në tranzicion është thelbësore për të kuptuarit gjithëpërfshirës të mënyrës se si një ndryshim në instrumentin e bankës qendrore ndikon inflacionin. Ky i fundit është në fokus të regjimit të shënjestrimit të inflacionit, i cili zbatohet nga një numër i madh vendesh në tranzicion si kuadër i politikës monetare. Ky artikull studion funksionimin e kanalit të kredisë bankare të transmetimit të politikës monetare në dhjetë vende të Evropës Qendrore, Lindore dhe Juglindore (EQLJL) gjatë periudhës 2010-2018, duke përdorur të dhëna mikro në nivel bankash, kryesisht nga baza e të dhënave Bankscope, por edhe burime të tjera, dhe duke kontrolluar për heterogjenitet midis vendeve. Artikulli synon të shqyrtojë: (i) nëse kushtet monetare ndikojnë në kredidhënien bankare në vendet e EQLJL-së të marra në analizë; (ii) nëse ka ndonjë lidhje lineare midis karakteristikave të caktuara të bankës (të tilla si madhësia dhe kapitalizimi) dhe normës së rritjes së kredisë; (iii) efektivitetin e kanalit të kredisë bankare, duke parë nëse ka efekte shpërndarëse si pasojë e karakteristikave bankare në ndikimin e politikës monetare në kredidhënien bankare. Shumica e literaturës ekzistuese mbi këtë temë përbëhet nga studime specifike për vende individuale, ndërsa në këtë artikull analiza kryhet për një grup vendesh të zgjedhura të EQLJL-së duke kontrolluar për heterogjenitet midis vendeve.

Studimet mbi mekanizmin e transmetimit monetar në Evropën Qendrore dhe Lindore që përdorin evidenca të bazuara në të dhëna mikro, aplikojnë kryesisht qasjen e përdorur rëndom në literaturë - atë të Kashyap dhe Stein (1995, 2000)

[1] *e-mail: mpapavangjeli@bankofalbania.org. Pikëpamjet e shprehura në këtë material janë të autores dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të Bankës së Shqipërisë.*

- e cila mbështetet në identifikimin e lëvizjeve asimetrike të kredisë, në lidhje me karakteristika të caktuara bankare. De Bondt (1998, 1999) ishte ndër të parët që siguroi evidenca empirike mbi kanalin e kredisë bankare në Evropë, duke përdorur të dhëna të bankave individuale. Sidoqoftë, këto dy studime nuk arrijnë në një përfundim të qartë, pasi rezultatet varen nga treguesi i politikës monetare, si dhe nga metodologjia ekonometrike e përdorur. Favero e të tj. (1999) studiojnë reagimin e kredive bankare ndaj një shtrëngimi monetar në 1992 në Francë, Gjermani, Itali dhe Spanjë. Ata nuk gjetën prova mbi kanalin e kredisë në asnjërin prej vendeve të marra në analizë.

Wróbel dhe Pawlowska (2002) analizojnë kanalin e kredisë për Poloninë për 48 banka tregtare, nga viti 1995 në 2002. Ata konstatojnë se efekti afatgjatë i rritjes së normës së interesit në kredi është më i vogël për një bankë më të madhe; për kapitalizimin, efekti afatgjatë i rritjes së normës së interesit në kredi është më i vogël për bankat më të kapitalizuara. Kanali i kredisë duket se funksionon kryesisht përmes bankave të vogla më pak të kapitalizuara. Një studim më i fundit nga Havrylchyk dhe Jurzyk (2005) është kryer mbi ekzistencën e kanalit të kredisë në Poloni për periudhën 1997-2002 dhe 67 banka (banka tregtare dhe disa banka më të mëdha bashkëpunuese). Kur merren parasysh karakteristikat e zakonshme specifike të bankës (madhësia, likuiditeti dhe kapitalizimi), nuk ka dështmi mbi kanalin e kredisë të transmetimit të politikës monetare. Përfshirja e një ndryshoreje që merr parasysh strukturën e pronësisë i ndryshon rezultatet. Në këtë rast të fundit, bankat e vogla më pak likuide zgjerojnë portofolin e tyre të kredisë më shpejt, ndërsa kapitalizimi bëhet më pak i rëndësishëm (pasi bankat e huaja janë më të mirëkapitalizuara).

Juks (2004) studion kanalin e kredisë bankare në Estoni, duke përdorur të dhëna tremujore nga viti 1996 deri në 2004. Rezultatet empirike dëshmojnë në favor të kanalit të kredisë bankare. Së pari, bankat e mirëkapitalizuara duket se përjetojnë një dalje më të vogël të depozitave pas një tkurrjeje monetare. Për pasojë, një goditje e politikës monetare që çon në një largim të depozitave nga sektori bankar ka efekt më të lartë në depozitat e bankave më pak të kapitalizuara dhe më të rrezikuara. Së dyti, gjendja e likuiditetit të bankave duket të jetë një përcaktues i rëndësishëm i ofertës së kredisë, duke sugjeruar që më shumë banka likuide janë në gjendje të mbajnë portofolet e tyre të kredisë; megjithatë, bankat më pak likuide duhet të zvogëlojnë ofertën e tyre të kredisë pas një tkurrjeje të politikës monetare.

Duke përdorur të dhëna tremujore për periudhën 1996-2001, Pruteanu (2004) analizon efektin e përgjithshëm të ndryshimeve të politikës monetare në normën e rritjes së kredive dhe karakteristikat e ofertës së kredisë në Republikën Çeke. Ndryshimet e politikës monetare ndikojnë normën e rritjes së kredive në një masë më të madhe në periudhën 1999-2001 sesa gjatë viteve 1996-1998. Për periudhën 1996-1998, diferencat midis bankave në reagimin e kredisë ndaj goditjeve të politikës monetare vijnë për shkak të shkallës së kapitalizimit dhe likuiditetit. Për periudhën pasuese 1999-2001, efektet shpërndarëse të politikës monetare varen nga madhësia e bankës, si dhe përpjesa e kredive të klasifikuara të bankës.

Ekzistenca e kanalit të kredisë bankare në Hungari është shqyrtuar nga Horváth, Krekó dhe Naszódi (2006) duke përdorur të dhëna tremujore nga viti 1995 në 2004. Përveç treguesve të zakonshëm specifikë të bankës (madhësia, likuiditeti dhe kapitalizimi), autorët marrin parasysh edhe pronësinë e huaj. Risia e këtij studimi është se ai teston nëse kërkesa për kredi mund të konsiderohet homogjene midis bankave lidhur me disa karakteristika të bankës. Rezultatet empirike tregojnë se kërkesa për kredi mund të konsiderohet në mënyrë të arsyeshme homogjene midis bankave në lidhje me peshën e pronësisë së huaj dhe madhësinë e bankave. Gjetjet kryesore sa i përket kanalit të kredisë bankare tregojnë se një rritje në normën e politikës shkakton një rritje më të madhe të kostos mesatare të financimit për bankat më të vogla, më pak të kapitalizuara, dhe për bankat me një peshë më të lartë të pronësisë vendase. Seksioni i mëposhtëm përshkruan modelin e aplikuar, si dhe të dhënat e përdorura për analizën empirike të këtij studimi.

2. METODOLOGJIA

2.1 MODELI EMPIRIK

Kashyap dhe Stein (1995) zhvillojnë një model teorik dhe përdorin të dhëna të dizagreguara nga bilancet e bankave për të vlerësuar nëse ekziston ndonjë kanal kredie në SHBA. Ata argumentojnë se portofolet e huave të bankave të madhësive të ndryshme pritet të përgjigjen ndryshe ndaj një tkurrjeje të politikës monetare. Në përputhje me modelin e tyre dhe studime të tjera më të fundit empirike (shih, p.sh., Gambacorta, 2005; Gambacorta dhe Mistrulli, 2004; Bertay et al., 2012), ky artikull përdor një model autoregresiv, në të cilin ekzistenca e kanalit të kredisë është testuar duke marrë parasysh dy karakteristika bankare: madhësinë e bankës (logaritmi i aktiveve totale) dhe kapitalizimin (raporti i kapitalit ndaj aktiveve). Kashyap dhe Stein (1995a, 1995b, 2000) dhe Kishan dhe Opiela (2000) pohojnë se bankat e vogla janë më të prirura ndaj problemit të asimetrisë së informacionit në raport me bankat e mëdha, gjë që duhet të reflektohet në ndjeshmërinë më të lartë të bankave të vogla ndaj goditjeve të politikës monetare, ndryshe nga bankat e mëdha që mund të lëshojnë instrumente të tregut të tilla si certifikatat e depozitave. Dëshmitë e siguruara nga Kishan dhe Opiela (2000, 2006) tregojnë se bankat jo të mirëkapitalizuara e zvogëlojnë ofertën e tyre të kredisë më shumë se bankat e mirëkapitalizuara pas një tkurrjeje monetare, për shkak të aftësisë së tyre të kufizuar për të shfrytëzuar burimet e pasiguruara të fondeve.

Në këtë artikull, shqyrtohet se si ndryshimet në normën afatshkurtër të interesit ndikojnë në kredinë totale të ofruar nga bankat dhe nëse bankat me karakteristika të ndryshme reagojnë ndryshe ndaj goditjeve të politikës monetare, duke përdorur specifikimin e modelit të mëposhtëm, siç propozohet nga Kashyap dhe Stein (1995):

$$\Delta lnK_{i,t} = \sum_{j=1}^{p} \alpha_j \Delta lnK_{i,t-1} + \sum_{j=0}^{p} \beta_j \, \Delta PM_{t-j} + \gamma z_{i,t-i} + \sum_{j=o}^{p} \delta_j \, \Delta PM_{t-j} z_{i,t-1} + \sum_{j=0}^{p} \varphi_j \pi_{t-j} + \sum_{j=0}^{p} \eta_j \, \Delta lny_{t-j} + \mu_i + \varepsilon_{it} \quad (1)$$

Bankat individuale janë shënuar me *i (i =1, ..., N), dhe t (t=1, ..., T)* tregon kohën për secilën ndryshore; T është numri gjithsej i periudhave kohore për secilën bankë i, dhe p është numri i vonesave kohore. K është ndryshorja e varur, përkatësisht (logaritmi natyror i) vëllimit të kredive të dhëna nga banka i në vitin t; parametri PM është treguesi i gjendjes së politikës monetare për secilin nga vendet, matur nga norma e interesit afatshkurtër dhe e llogaritur si mesatarja vjetore e vlerave mujore të normës së interesit. Sipas teorisë së kanalit të kredisë, koeficienti β duhet të jetë negativ: me rritjen e normës së interesit, bankat ulin sasinë e kredive që ofrojnë.

Meqenëse objektivi kryesor i këtij artikulli është të hetojë nëse autoritetet monetare mund të ndikojnë në ofertën e kredive, bëhet e nevojshme të merren parasysh edhe lëvizjet e kërkesës për kredi, të cilat kapen nga rritja reale e PBB-së dhe e inflacioni, shënuar përkatësisht me Δlny dhe π. Ndryshore të tilla si PBB-ja reale ose norma e inflacionit janë përdorur tradicionalisht në model. Futja e këtyre dy treguesve na lejon të kapim lëvizjet ciklike dhe shërben për të izoluar përbërësin e politikës monetare të ndryshimeve të normës së interesit (Gambacorta, 2005). Për të kontrolluar ekzistencën e efekteve shpërndarëse të politikës monetare midis bankave, janë përdorur treguesit e mëposhtëm për karakteristikat e bankave, të cilat përfshihen në variablin (z): madhësia dhe kapitalizimi i bankës, në përputhje me studimet empirike të përmendura më herët në këtë artikull. Madhësia llogaritet si logaritmi natyror i totalit të aktiveve dhe kapitalizimi si pjesa e kapitalit neto ndaj totalit të aktiveve.

Karakteristikat individuale të bankave janë normalizuar në lidhje me mesataren e tyre përgjatë gjithë bankave të mostrës, në mënyrë që mesatarja e një karakteristike bankare përgjatë të gjitha vrojtimeve të shkojë në zero. Kjo do të thotë se për regresionin (1), mesatarja e termave të ndërveprimit $\Delta PM_{t-j} z_{i,t-1}$ është gjithashtu zero, dhe parametrat β_j janë të interpretueshëm drejtpërdrejt si efekt mesatar i politikës monetare në nivelin e kredisë.

Kategorizimi i një banke të madhe mund të ndryshojë sipas kushteve të tregut:

$$Madhësia_{it} = logA_{it} - \frac{\sum_{i=1}^{N} logA_{it}}{N_t} \quad (2)$$

$$Kapitalizimi_{it} = \frac{E_{it}}{A_{it}} - \frac{\sum_{t=1}^{T} \left(\frac{\sum_{i=1}^{N} \left(E_{it}/A_{it} \right)}{N_t} \right)}{T}$$

bankat që konsiderohen të vogla në një treg me një sektor financiar më të thelluar, mund të konsiderohen si të mesme apo të mëdha në një treg më të vogël. Prandaj, madhësia është një variabël që kap asimetritë e mundshme specifike të bankës si devijime nga mesatarja e secilës periudhë. Kjo heq

trendin rritës që mund të vërehet në aktivet e bankave. Ndryshe nga madhësia, kapitalizimi është një tregues më pak relativ. Në rastin e kapitalizimit, nga secili vrojtim hiqet mesatarja e përgjithshme e mostrës (ajo sipas bankave dhe sipas kohës), në mënyrë që të mundësohet interpretueshmëria e parametrave β_j, pa hequr trendin nga një treg financiar ndoshta i ndryshueshëm (Ehrmann et al., 2003).

Modeli lejon edhe marrjen parasysh të efekteve specifike të bankave (μ_i). Parametrat me interes janë ata përpara treguesit të politikës monetare (β_j), të cilët kapin ndikimin e përgjithshëm të drejtpërdrejtë të ndryshimeve të politikës monetare në rritjen e kredisë bankare, dhe koeficientët përpara termave të ndërveprimit të rendit të parë (δ_j). Këto të fundit kapin efektet shpërndarëse të gjendjes së politikës monetare, të cilat pritet të jenë më të dobëta midis bankave më të mëdha ose më të kapitalizuara. Këtu supozimi bazë është që madhësia e bankës është një përfaqësues i problemeve të lidhura me informacionin (të tilla si përzgjedhja e pafavorshme, rreziku moral, në mënyrë të atillë që bankat më të vogla, duke pasur një imazh më "të errët", kanë vështirësi më të mëdha në ristrukturimin e portofolit të tyre të huave dhe aktiveve të tjera. Bankat e mëdha nga ana tjetër, mund ta kenë të lehtë të mbledhin fonde për të kompensuar efektet e një politike monetare tkurrëse. Ato mund t'i përdorin këto fonde për të dhënë hua, por, me rritjen e normave, mund të humbasin kreditë për të zëvendësuar burimin e financimit. Efekti i kapitalit në përgjigjen e huave ndaj ndryshimeve të politikës monetare pritet të jetë pozitiv. Ndërsa bankat kapitalizohen më mirë, shuma e kredive që japin bëhet më pak e ndjeshme ndaj politikës monetare. Një parametër pozitiv dhe domethënës (δ_j) nënkupton që bankat më të vogla dhe më pak të kapitalizuara reagojnë më fort ndaj ndryshimeve të politikës monetare. Për më tepër, nëse koeficientët përpara këtyre termave të ndërveprimit janë pozitivë dhe statistikisht të rëndësishëm, ndërsa koeficienti i lidhur me ΔPM është negativ, atëherë kanali i kredisë funksionon. Anasjelltas, nëse koeficientët para termave të ndërveprimit nuk ndryshojnë ndjeshëm nga zero, atëherë politika monetare nuk ka efekt në ofertën e kredisë, të paktën bazuar në këtë metodologji. Koeficienti para karakteristikave të bankës (γ) ka një rol ilustrues; ai përshkruan nëse ekziston një lidhje lineare midis normës së rritjes së kredive dhe karakteristikave bankare. Me fjalë të tjera, situata kur koeficienti β_j është statistikisht i rëndësishëm dhe negativ, dhe kur koeficienti δ_j është statistikisht pozitiv përfaqëson ekzistencën e kanalit të kredisë bankare në këto vende.

Konkretisht, në këtë artikull do të përqendrohemi në hipotezat e mëposhtme:

$$\text{Hipoteza 1: } \frac{\delta^2 K_{i,t}}{\delta madhësia_{i,t} \delta PM_t} > 0$$

$$\text{Hipoteza 2: } \frac{\delta^2 K_{i,t}}{\delta kap_{i,t} \delta PM_t} > 0 \qquad (3)$$

ku $K_{i,t}$, $madhësia_{i,t}$, dhe $kap_{i,t}$, përfaqësojnë përkatësisht kreditë e bankës i, madhësinë dhe kapitalizimin në vitin t, ndërsa PM nënkupton normën përkatëse

të interesit që mat gjendjen e politikës monetare, ku vlerat më të larta të PM korrespondojnë me politikë monetare më të shtrënguar. Arsyeja pse merren parasysh termat e parë të ndërveprimit, është se efekti i politikës monetare në kreditë bankare duhet të varet në një masë të madhe nga madhësia e bilancit të bankës. Vlen të theksohet se ndryshoret e karakteristikave bankare, qoftë në formën e tyre lineare, qoftë në termat e ndërveprimit të rendit të parë, janë përfshirë në model si vonesa kohore, sikurse mund të kuptohet nga specifikimi i ekuacionit (1). Arsyetimi pas këtij specifikimi mbështetet në faktin se karakteristikat e bankës duke qenë zëra të bilancit të bankave, mund të jenë të korreluara me ndryshoren e huasë $K_{i,t}$.

Struktura dinamike e dhënë në specifikimin (1) të modelit çon në vlerësime më efikase dhe konsistente përmes Metodës së Përgjithësuar të Momenteve (GMM) me një diferencë, siç propozohet nga Arellano-Bond (1991). Kjo teknikë adreson çështjen e mundshme të endogjenitetit të pranishëm në model dhe siguron vlerësime të qëndrueshme të parametrave, duke zgjedhur instrumente për variablin e varur, në mënyrë që korrelacionet midis instrumenteve dhe termave të gabimit të modelit të jenë sa më afër zeros (shih Hamilton, 1994). Ky vlerësues instrumenton një regresor endogjen shprehur në diferencë të parë në ekuacionin (1) me vonesat e tij kohore. Ideja kryesore pas këtij vlerësuesi është se ndryshimet aktuale (Δx_{it}) përgjithësisht parashikohen nga vonesat kohore. Më tej, vonesat kohore të rendit të dytë apo të një rendi më të lartë të një regresori endogjen ($x_{i,t-p}$ for $p \geq 2$) mund të përdoren si instrumente për regresorin e tij endogjen shprehur në diferencë të parë (Δx_{it}) sepse, ndryshe nga transformimet me devijime nga mesatarja në vlerësimet standarde me efekte fikse, vonesat e rendit të dytë apo të rendeve më të larta të regresorit endogjen ($x_{i,t-p}$ for $p \geq 2$) mbeten ortogonale ndaj termit të gabimit ($\Delta v_{it} = v_{it} - v_{it-1}$) (Roodman, 2009).

Konsistenca e vlerësuesit GMM varet nga vlefshmëria e instrumenteve, e cila vërtetohet nga dy teste të sugjeruara nga Arellano dhe Bond (1991), Arellano dhe Bover (1995), si dhe Blundell dhe Bond (1998). I pari është testi Sargan (1988) (ose Hansen) i kufizimeve të mbiidentifikimit, i cili shqyrton vlefshmërinë e përgjithshme të instrumenteve. Nën hipotezën zero të vlefshmërisë së instrumenteve, statistika e lidhur me këtë test ka një shpërndarje chi-katror me (J-K) shkallë lirie, ku J është numri i instrumenteve dhe K numri i ndryshoreve të pavarura në regresion. Testi i dytë, i ashtuquajturi testi Arellano-Bond, zbatohet për të kontrolluar praninë e autokorrelacionit në mbetjet e diferencave të para dhe për të përcaktuar numrin e vonesave që mund të përdoren për instrumentet. Nën hipotezën zero të mungesës së korrelacionit të rendit të dytë, statistika e lidhur me këtë test ka një shpërndarje normale standarde. Dështimi për të refuzuar hipotezat zero të të dy testeve konfirmon vlefshmërinë e specifikimeve tona.

2.2 PËRSHKRIMI I TË DHËNAVE

Ky artikull përdor të dhëna të dizagreguara bazuar në pasqyrat financiare të nxjerra kryesisht nga Bankscope, të siguruara nga Bureau van Dijk (BvD), por gjithashtu të plotësuara me të dhënat dhe informacione nga raportet vjetore të bankave, nga bankat qendrore përkatëse të vendeve dhe nga Fondi Monetar Ndërkombëtar, Statistikat Financiare Ndërkombëtare. Baza e të dhënave (në nivel të pakonsoliduar) përbëhet nga vrojtime vjetore nga 10 vende të EQLJL-së, gjatë periudhës 2010-2018, që mbulojnë 266 banka individuale, të karakterizuara nga forma të ndryshme të pronësisë: banka tregtare, banka kursimi, banka kooperative dhe banka investimi; por është një panel i pabalancuar, meqenëse ka disa vlera që mungojnë disa periudha kohore për disa nga vendet. Ashcraft (2006) dhe Gambacorta (2005) ofrojnë një diskutim dhe dëshmi që tregojnë se të dhënat vjetore janë të përshtatshme për ekuacionet e kredisë, duke afirmuar kështu përdorimin e kësaj baze të dhënash për studimin tonë. Për më tepër, të dhënat e dizagreguara bankare mund të kapin efektivisht efektet shpërndarëse të politikës monetare përmes një kanali kredidhënie (Bernanke dhe Blinder, 1992).

Dy shqetësime në lidhje me cilësinë e të dhënave lindin nga ndryshimi i madh në praktikat që përdoren për fshirjen e kredive me probleme dhe nga mungesa e informacionit të qëndrueshëm mbi sasinë e kredive me probleme sipas bankave. Së pari, nisur nga ky arsyetim, shkalla në të cilën "shtrembërohet" rritja e vlerësuar e kredisë, varet nga mënyra se si raportimi i gabuar i totalit neto të huave (pas fshirjes së kredive me probleme) ndryshon me kalimin e kohës për secilën bankë. Së dyti, çdo nënprovigjionim ndaj kredive me probleme rezulton në një mbivlerësim të kapitalit bankar dhe të aktiveve totale. Këto probleme të mundshme të të dhënave duhet të merren parasysh kur interpretohen rezultatet e regresionit (Fries, Taci, 2002).

Për shkak të shtrirjes së shkurtër kohore dhe heterogjenitetit të mostrës, bankat janë grupuar në grupe sipas progresit në reformën bankare, kapur nga treguesit e tranzicionit të BERZH (Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim) (2020), publikuar në Raportet e Tranzicionit dhe bazën e të dhënave të vlerësimit ATC. Një mesatare e thjeshtë e këtij treguesi është llogaritur për periudhën 1989-2016, në mënyrë që të merren parasysh si kushtet fillestare, ashtu edhe e gjithë ecuria e reformës bankare për secilin prej vendeve të marra në analizë. Vendet ndahen në tri grupe: grupi i parë përfshin ato më pak të avancuara, si: Shqipëria, Bosnje-Hercegovina dhe Serbia (ekonomitë ku indeksi mesatar i reformës bankare merr vlera midis 2.14 dhe 2.67); grupi i dytë përbëhet nga Bullgaria, Rumania dhe Maqedonia e Veriut (një indeks mesatar i reformës bankare midis 2.74 dhe 2.86); dhe grupi i tretë përfshin Kroacinë, Poloninë, Hungarinë dhe Republikën Çeke (me një indeks mesatar të reformës bankare midis 3.14 dhe 3.55).

3 REZULTATET EMPIRIKE

3.1. EVIDENCA NË NIVEL TË PËRGJITHSHËM PËR SECILIN GRUP-VENDESH

Së pari, një "model standard" është vlerësuar për të gjitha grupet e vendeve, i cili nuk përfshin karakteristikat bankare (z) dhe ndërveprimin midis karakteristikave bankare dhe treguesit të politikës monetare. Kjo do të na japë një pamje paraprake nëse rritja e kredisë i përgjigjet ndryshimeve të politikës monetare dhe kushteve makroekonomike. Modeli i plotë dhënë nga ekuacioni (1) do të quhet "model i zgjeruar". Vlerësimet bëhen veçmas për secilin grup vendesh.

Tabelat më poshtë përmbledhin rezultatet e vlerësimit të modeleve "standarde" dhe atyre "të zgjeruara" për rritjen totale të kredisë, së pari për të gjithë mostrën, dhe më pas veçmas, për secilin grup vendesh. Shifrat e raportuara përfaqësojnë elasticitetet afatgjata të modeleve.

Koeficienti afatgjatë i një ndryshoreje llogaritet si shuma e koeficientëve të saj (të vonesave kohore dhe vlerave aktuale të saj, sipas rastit) pjesëtuar me një minus shumën e koeficientëve të vonesave të ndryshores së varur. Për shembull, elasticiteti afatgjatë i ndryshores së varur në lidhje me politikën monetare për një bankë mesatare jepet nga $\sum \beta_j / (1 - \sum \alpha_i)$.

Tabelë 1. "Modeli standard" (ekuacioni (1)) (koeficientët afatgjatë)

Ndryshorja e varur	Norma e rritjes së kredisë gjithsej		
Ndryshoret e kontrollit	Grupi 1	Grupi 2	Grupi 3
Politika monetare	-0.048*** (0.002)	-0.069* (0.069)	-0.028* (0.064)
Rritja e PBB-së	0.067*** (0.000)	0.004 (0.661)	0.024** (0.037)
Inflacioni	0.097*** (0.000)	0.073*** (0.000)	0.023* (0.809)
Vlera e p-së Hansen	0.293	0.247	0.166
Vlera e p-së AR1/AR2	0.0035/0.248	0.006/0.534	0.144/0.603
Nr. vrojt./ Nr. bankave	261/56	244/51	470/124

Shënim: Vlerat e p-së në kllapa.
, **, * tregojnë përkatësisht rëndësinë në nivelet 10%, 5% dhe 1%.*

Në vazhdim, janë kryer disa teste diagnostikuese për të verifikuar nëse modelet individuale plotësojnë të gjitha supozimet e nevojshme. Në të gjitha tabelat janë raportuar rezultatet e testit Arellano-Bond (1991) për autokorrelacionin e rendit të parë dhe të dytë të mbetjeve, të cilat vazhdimisht tregojnë se hipoteza zero e mungesës së autokorrelacioni të rendit të dytë nuk mund të hidhet poshtë. Meqenëse vlerësuesi është në diferencat e para, autokorrelacioni i rendit të parë nuk çon në vlerësime jokonsistente. Disa vlerësues robustë janë përdorur për të korrigjuar heteroscedasticitetin. Testi Hansen nuk hedh poshtë kushtet e mbiidentifikimit të modelit. Nëse hipoteza zero nuk mund të refuzohet, modeli mbështetet, (Roodman, 2009) dhe ky është rasti përgjatë gjithë punimit (shiko vlerat p në fund të tabelave).
Lidhur me efektet e politikës monetare në normën e rritjes së totalit të kredive, ndryshimet në normën e interesit të nxitura nga politika kanë një ndikim negativ

dhe domethënës në tre grupet e vendeve. Kështu, teoria e kanalit të kredisë bankare vlen për të gjitha grupet e vendeve bazuar në këtë version të modelit: kreditë tkurren pas një shtrëngimi të politikës monetare. Për sa i përket ndikimit të kushteve makroekonomike, ndikimi i rritjes së PBB-së është pozitiv për të gjitha grupet, por statistikisht i rëndësishëm vetëm për grupin e parë dhe të tretë, ndërsa inflacioni ndikon pozitivisht dhe në mënyrë të rëndësishme në rritjen e kredisë në të gjitha grup-vendet.

Në variantin e zgjeruar të modelit, janë shtuar, në mënyrë të njëpasnjëshme, karakteristikat bankare dhe ndërveprimi i tyre me normën e politikës monetare. Vëmendja përqendrohet në rëndësinë statistikore të marrëdhënies lineare midis normës së rritjes së kredisë totale dhe karakteristikave të bankave - koeficienti γ në ekuacion (1) - dhe të efekteve shpërndarëse të politikës monetare në normën e rritjes së kredive, për shkak të këtyre karakteristikave të bankave, pra koeficientët e ndërveprimit δ, në të njëjtin ekuacion. Ashtu si në rastin e modelit standard, varianti i zgjeruar i modelit është vlerësuar për të tre grupet e vendeve. Rezultatet e përftuara janë paraqitur në Tabelën 2.

Tabelë 2. "Modeli i zgjeruar" (ekuacioni (1)) (koeficientët afatgjatë)

Ndryshorja e varur	Norma e rritjes së totalit të kredisë					
Specifikimi		Grupi 1		Grupi 2		Grupi 3
PM	-0.055* (0.052)	-0.033* (0.069)	-0.086** (0.016)	-0.079** (0.042)	-0.045 (0.380)	-0.048** (0.0362)
Madhësia	-0.372*** (0.000)		-0.0159 (0.478)		0.229*** (0.000)	
Madhësia *PM	0.025*** (0.003)		0.001 (0.923)		0.006 (0.612)	
Kapitalizimi		0.025** (0.016)		0.036*** (0.000)		0.020*** (0.000)
Kapitalizimi *PM		0.001 (0.648)		0.004 (0.591)		0.002 (0.235)
Rritja e PBB-së	0.049 (0.191)	0.042*** (0.001)	0.034*** (0.009)	0.011 (0.329)	0.034*** (0.004)	0.011** (0.030))
Inflacioni	0.015** (0.041)	0.014 (0.251)	0.091*** (0.000)	0.05*** (0.001)	0.043*** (0.0003)	0.032*** (0.000)
Vlera e p-së Hansen	0.346	0.279	0.141	0.295	0.403	0.209
Vlera e p-së AR1/AR2	0.0269/0.1833	0.0361/0.164	0.037/0.521	0.013/0.38	0.05/0.747	0.217/0.554
Nr. vrojtimeve/ Nr. i bankave	261/56	249/56	194/39	243/51	359/106	467/123

Shënim: Vlerat e p-së në kllapa.
, **, * tregojnë përkatësisht rëndësinë në nivelet 10%, 5% dhe 1%.*

Edhe në këtë rast, teoria e kanalit të kredisë bankare vërtetohet për të gjitha grupet, por madhësia e efekteve të politikës monetare në kredidhënien e bankave ndryshon sipas specifikimeve të ndryshme. Rezultatet zbulojnë një lidhje negative lineare midis madhësisë së bankës dhe shkallës së rritjes së kredisë për vendet me sistem financiar më pak të zhvilluar dhe ato me një nivel të moderuar të zhvillimit financiar (përkatësisht grupi i parë dhe i dytë), megjithëse për këtë të fundit efekti është statistikisht i parëndësishëm. Kjo tregon se për këto vende, bankat e vogla gëzojnë mesatarisht norma më të larta të rritjes së kredisë; ndërsa e kundërta vlen për vendet më të përparuara, ku koeficienti përpara madhësisë së bankës është pozitiv dhe statistikisht i

rëndësishëm. Termi i ndërveprimit midis politikës monetare dhe madhësisë së bankës paraqet një koeficient pozitiv të rëndësishëm vetëm për grupin e parë të vendeve, duke mbështetur gjetjet e mëparshme se bankat e vogla janë më të ndjeshme ndaj tkurrjeve monetare në krahasim me ato më të mëdha; ndërsa për dy grupet e tjera të vendeve, madhësia e bankës nuk ndikon në rritjen e kredisë pas një shtrëngimi të politikës monetare për asnjërën prej bankave.

Kapitalizimi duket të jetë një tregues i rëndësishëm në shpjegimin e sjelljes së ofertës së kredisë bankare për të gjitha grupet: bankat më të mirëkapitalizuara kanë më pak gjasa të ulin kreditimin e tyre (kur çdo gjë tjetër mbahet e pandryshuar). Kjo do të thotë që bankat e mirëkapitalizuara gëzojnë norma më të larta të rritjes së kredisë. Analiza e përgjithshme demonstron një koeficient pozitiv për termin e ndërveprimit midis kapitalizimit dhe politikës monetare për të gjitha grupet, por asnjë nga këta koeficientë nuk rezulton të jetë statistikisht i rëndësishëm, duke nënkuptuar që kapitalizimi nuk ndikon në normën e rritjes së totalit të kredisë për klientët pas një ndryshimi të politikës monetare, bazuar në këtë specifikim të modelit dhe në analizën sipas grup-vendeve.

Efektet e treguesve makroekonomikë që pasqyrojnë lëvizjet e anës së kërkesës janë robuste përgjatë modeleve të ndryshme. Elasticiteti afatgjatë i kredisë ndaj PBB-së është gjithmonë pozitiv dhe i rëndësishëm, në shumicën e rasteve. Përgjigjja e kredisë ndaj çmimeve është gjithmonë e rëndësishme statistikisht dhe pozitive. Vlen të përmendet se koeficienti para inflacionit përmban si efektin pozitiv të inflacionit në rritjen nominale të kredisë, ashtu edhe efektet e mundshme negative të inflacionit më të lartë, përmes normave më të larta nominale të interesit. Duket se në rastin tonë, efekti i parë ka dominuar kundrejt të dytit, për të gjitha grupet.

Analiza në nivel të përgjithshëm për secilin grup vendesh nuk tregon rezultate të rëndësishme në aspektin e karakteristikave të bankave për të gjitha rastet, gjë që mund të vijë nga heterogjeniteti ekzistues midis bankave, brenda secilit grup. Rrjedhimisht, do të ishte më e përshtatshme të shqyrtohej ndikimi i karakteristikave të bankave në normën e rritjes së kredive përmes një analize për vendet individuale, në një regresion të përbashkët për secilin grup.

3.2 EVIDENCA SIPAS VENDEVE INDIVIDUALE

Në këtë pjesë të artikullit, modeli është zgjeruar me disa variabla binarë, në mënyrë që të marren parasysh ndryshimet midis vendeve brenda secilit grup, duke lejuar parametrat e interesit, domethënë ato të treguesit të politikës monetare dhe ndërveprimin midis karakteristikave të bankave dhe treguesit monetar të variojnë sipas vendeve të ndryshme. Elasticitetet e kërkesës për jene në mund të

$$\Delta ln\, K_{i,t} = \sum_{j=1}^{p} \alpha_1 \Delta ln\, K_{i,t-1} + \sum_{j=0}^{p} \beta_j\, \Delta PM_{t-j} * d_vend + \gamma z_{i,t-i} + \sum_{j=o}^{p} \delta_j\, \Delta PM_{t-j} z_{i,t-1} * d_vend + \sum_{j=0}^{p} \varphi_j \pi_{t-j} + \sum_{j=0}^{p} \eta_j\, \Delta lny_{t-j} + \mu_i + \varepsilon_{it}$$

Tabela 3 përmbledh rezultatet e vlerësimit, të cilat paraqesin ndryshimet midis tri grupeve të vendeve, si në aspektin e madhësisë, ashtu edhe të rëndësisë statistikore. (4)

Tabelë 3. "Modeli i zgjeruar" për madhësinë bankare (ekuacioni (2)) (koeficientët afatgjatë)

Ndryshorja e varur	Norma e rritjes së kredisë totale					
	Grupi 1		Grupi 2		Grupi 3	
Ndryshoret e kontrollit						
PM	Shqipëria	-0.14* (0.09)	Bullgaria	-0.082** (0.038)	Kroacia	-0.02** (0.04)
	Bosnje-Hercegovina	-0.01* (0.084)	Rumania	-0.031** (0.019)	Polonia	-0.02** (0.028)
	Serbia	-0.01* (0.08)	Maqedonia e Veriut	-0.09** (0.016)	Hungaria	-0.036** (0.028)
					Republika Çeke	-0.057* (0.092)
Madhësia		-0.71*** (0.000)		-0.001 (0.971)		0.060*** (0.003)
PM* madhësia						
	Shqipëria	0.206*** (0.000)	Bullgaria	0.007 (0.680)	Kroacia	0.016** (0.049)
	Bosnje-Hercegovina	0.171*** (0.002)	Rumania	0.005 (0.652)	Polonia	0.024*** (0.001)
	Serbia	0.005 (0.354)	Maqedonia e Veriut	0.035* (0.06)	Hungaria	-0.006 (0.269)
					Republika Çeke	0.005 (0.934)
Rritja e PBB-së		0.018* (0.05)		0.029** (0.011)		0.022** (0.028)
Inflacioni		0.01 (0.627)		0.046*** (0.000)		0.024** (0.043)
Vlera e p-së Hansen		0.626		0.251		0.508
Vlera e p-së AR1/AR2		0.015/0.280		0.029/0.678		0.01/0.692
Nr. vrojtimeve/ Nr. i bankave		261/56		194/39		359/106

Shënim: Vlerat e p-së në kllapa.
, **, * tregojnë përkatësisht rëndësinë në nivelet 10%, 5% dhe 1%.*

Për sa i përket efekteve të politikës monetare në normën e rritjes së totalit të kredisë, ndryshimet në normën e interesit të nxitur nga politika kanë një ndikim negativ dhe domethënës në të gjitha vendet e shqyrtuara, i cili përputhet me rezultatet e analizës së kryer më parë në këtë artikull. Kjo rikonfirmon teorinë e kanalit të kredisë bankare: kreditë bien pas një shtrëngimi të politikës monetare. Këto rezultate përfaqësojnë ndikimin mesatar të politikës monetare në të gjitha bankat, të cilat konsiderohen të kenë të njëjtën peshë, pavarësisht nga pjesa e tyre në treg apo karakteristika të tjera.

Më tej, përqendrohemi në rëndësinë e marrëdhënies lineare midis normës së rritjes së totalit të kredisë dhe karakteristikave bankare dhe efektet shpërndarëse të politikës monetare në normën e rritjes së kredive për shkak të këtyre karakteristikave bankare, për të tri grupet e vendeve. Testimi për ekzistencën e kanalit të kredisë bankare konsiston në kontrollimin nëse koeficientët e termave të ndërveprimit janë statistikisht të rëndësishëm apo jo. Nëse koeficientët në këto terma ndërveprimi janë pozitivë dhe statistikisht të rëndësishëm, ndërsa koeficienti i lidhur me ΔPM është negativ, atëherë kanali

i kredisë funksionon. Anasjelltas, nëse koeficientët në termat e ndërveprimit nuk ndryshojnë ndjeshëm nga zero, atëherë nuk ka efekte të ofertës së kredisë nxitur nga politika monetare, të paktën bazuar në këtë metodologji.

Rezultatet e vlerësuara zbulojnë një lidhje të rëndësishme lineare negative midis madhësisë së bankës dhe shkallës së rritjes së kredisë në rastin e grupit të parë të bankave, duke nënkuptuar që bankat e vogla pjesë e këtij grupi gëzojnë norma më të larta të rritjes së kredisë; ndërsa për grupin e dytë të vendeve ky koeficient është i parëndësishëm. Vendet më të përparuara karakterizohen nga një koeficient i madhësisë bankare pozitiv e statistikisht i rëndësishëm, që tregon se bankat e mëdha në këto vende janë ato që përfitojnë nga normat më të larta të rritjes së kredisë. Termi i ndërveprimit midis politikës monetare dhe madhësisë së bankës që përfaqëson efektin shpërndarës të ndryshimeve të politikës monetare për shkak të madhësisë së bankës, rezulton statistikisht i rëndësishëm për disa nga vendet si: Shqipëria, Maqedonia e Veriut, Kroacia dhe Polonia; që do të thotë se madhësia si karakteristikë bankare ndikon në rritjen e kredisë pas ndryshimit të politikës monetare për bankat e këtyre vendeve, por jo për pjesën tjetër të vendeve.

Tabelë 4. "Modeli i zgjeruar" për kapitalizimin e bankave (ekuacioni (2)) (koeficientët afatgjatë)

Ndryshorja e varur	Norma e rritjes së kredisë totale					
	Grupi 1		Grupi 2		Grupi 3	
Ndryshoret e kontrollit						
PM	Shqipëria	-0.16* (0.08)	Bullgaria	-0.103*** (0.000)	Kroacia	-0.033*** (0.002)
	Bosnje-Hercegovina	-0.011* (0.087)	Rumania	-0.038*** (0.001)	Polonia	-0.025** (0.001)
	Serbia	-0.08** (0.010)	Maqedonia e Veriut	-0.05* (0.054)	Hungaria	-0.009** (0.000)
					Republika Çeke	-0.051* (0.020)
Kapitalizimi		0.033*** (0.000)		0.038*** (0.000)		-0.005 (0.226)
PM*kapitalizimi						
	Shqipëria	0.008 (0.645)	Bullgaria	0.009*** (0.003)	Kroacia	0.004*** (0.000)
	Bosnje-Hercegovina	0.007 (0.865)	Rumania	0.008** (0.048)	Polonia	0.005*** (0.000)
	Serbia	0.002 (0.787)	Maqedonia e Veriut	0.002 (0.831)	Hungaria	0.001 (0.142)
					Republika Çeke	0.003 (0.182)
Rritja e PBB-së		0.055*** (0.000)		0.012* (0.066)		0.013*** (0.000)
Inflacioni		0.007 (0.627)		0.041*** (0.000)		0.027*** (0.000)
Vlera e p-së Hansen		0.389		0.263		0.172
Vlera e p-së AR1/AR2		0.002/0.691		0.01/0.174		0.22/0.586
Nr. vrojtimeve/ Nr. i bankave		249/56		243/51		467/123

Shënim: Vlerat e p-së në kllapa.
, **, * tregojnë përkatësisht rëndësinë në nivelet 10%, 5% dhe 1%.*

Bazuar në rezultatet tona, kapitalizimi paraqet një efekt të përgjithshëm linear të rëndësishëm statistikisht dhe pozitiv në normën e rritjes së totalit të kredisë për dy grupet e para të vendeve, por negativ dhe të parëndësishëm për grupin e tretë. Për efektet shpërndarëse të politikës monetare, analiza e përgjithshme zbulon një koeficient pozitiv për termin e ndërveprimit midis kapitalizimit dhe politikës monetare, në rastin e bankave më pak të përparuara (grupi i parë)

në të gjitha vendet e këtij grupi, por koeficienti i ndërveprimit është statistikisht i rëndësishëm vetëm për Bullgarinë, Rumaninë, Kroacinë dhe Poloninë, duke konfirmuar teorinë: bankat më pak të kapitalizuara janë më të prekura nga kushtet e politikës monetare në këto vende. Për grupin e bankave më pak të përparuara (grupi i parë), koeficienti i termit të ndërveprimit nuk është i rëndësishëm, gjë që do të thotë se kapitalizimi si karakteristikë bankare nuk ndikon në normën e rritjes së totalit të kredive pas ndryshimit të politikës monetare.

Sa i përket ndikimit të kushteve makroekonomike, ndikimi i rritjes së PBB-së është pozitiv dhe i rëndësishëm për të gjitha vendet përbërëse të grupit; inflacioni, i cili gjithashtu synon të marrë parasysh faktorët e kërkesës, ndikon pozitivisht në rritjen e kredisë në të gjitha grupet, por jo në të gjitha rastet ndikon në mënyrë të rëndësishme. Këto rezultate janë të qëndrueshme në specifikime të ndryshme të modelit, duke përfshirë edhe ato të vlerësimeve të mëparshme sipas grup-vendeve.

Studime të tjera empirike kanë gjetur rezultate të ngjashme për kanalin e kredisë bankare dhe transmetimin monetar në këto vende të EQLJL-së [shih për shembull Skufi (2020); Vika, Suljoti (2015); Vika (2007) për Shqipërinë; Kovacevic, D. (2015) për Bosnje-Hercegovinën; Kujundžić dhe Otašević (2012) për Serbinë; Eliskovski (2018) për Maqedoninë e Veriut; Nenova et al. (2019) për Bullgarinë; Wróbel dhe Pawlowska (2002) për Poloninë; Pruteanu (2004) për Republikën Çeke; Horváth, Kréko dhe Naszódi (2006) për Hungarinë; Vizek (2006) për Kroacinë, Jimborean (2007) për Rumaninë dhe vende të tjera të zgjedhura të EQL-së etj.].

4. KONKLUZIONE DHE IMPLIKIME POLITIKE

Ky artikull studion funksionimin e kanalit të kredisë bankare në 10 vende të EQLJL-së gjatë periudhës 2010-2018, duke i klasifikuar bankat tregtare të këtyre vendeve në tri grupe sipas nivelit të zhvillimit të sektorit të tyre bankar, kapur nga kriteret e reformës bankare të BERZH-it. Duke përdorur të dhëna të dizagreguara, kryesisht nga baza e të dhënave Bankscope, por edhe burime të tjera shtesë, ky artikull analizon: (i) nëse kushtet monetare ndikojnë në kredidhënien bankare; (ii) nëse ka marrëdhënie lineare midis disa karakteristikave të veçanta të bankës (si madhësia dhe kapitalizimi) dhe shkallës së rritjes së kredisë; dhe (iii) efektivitetin e kanalit të kredisë bankare, duke parë nëse ka efekte shpërndarëse për shkak të karakteristikave bankare në ndikimin e politikës monetare në kreditimin e bankave.

Rezultatet tregojnë se kredia bankare tkurret në mënyrë të konsiderueshme pas një shtrëngimi monetar si në nivel grupi, ashtu edhe në nivel vendi. Vlerësimet empirike gjejnë disa efekte lineare të rëndësishme të madhësisë së bankës në normën e rritjes së kredive për vendet me sistem financiar më pak të zhvilluar dhe ato më të avancuara (përkatësisht grupi i parë dhe i tretë i vendeve), por me shenja të kundërta (pozitive në rastin e parë dhe negative në të dytin),

duke treguar se për vendet më pak të zhvilluara, bankat e vogla gëzojnë mesatarisht norma më të larta të rritjes së kredisë, ndërsa e kundërta vlen për vendet më të përparuara. Kapitalizimi paraqet një efekt të përgjithshëm të rëndësishëm linear dhe pozitiv në normën e rritjes së totalit të kredisë për të gjitha grupet e vendeve, që do të thotë se bankat më të mirëkapitalizuara kanë më pak gjasa të ulin kredidhënien e tyre (kur të gjitha kushtet e tjera mbeten të pandryshuara).

Lidhur me efektet shpërndarëse të politikës monetare në normën e rritjes së kredisë për shkak të karakteristikave bankare, gjetjet e këtij artikulli sugjerojnë se ndryshimet në koston e financimit të krijuara nga ndryshimet e politikës monetare ushtrojnë ndikimin e tyre më të madh në bankat e vogla në vendet: Shqipëri, Maqedoni e Veriut, Kroaci dhe Poloni; dhe në bankat më pak të kapitalizuara në: Bullgari, Rumani, Kroaci dhe Poloni, duke konfirmuar teorinë se bankat e vogla dhe më pak të kapitalizuara janë më të prekura nga kushtet e politikës monetare në këto vende. Për më tepër, këto banka kontribuojnë më së shumti në rifinancimin e ekonomisë reale, në veçanti firmat e vogla dhe të mesme, të cilat janë gjeneruesi më i madh i punësimit në ekonomi. Bankat tregtare më të mëdha dhe më të kapitalizuara, nga ana tjetër, duket se janë më të afta për të izoluar aktivitetet e tyre të kreditimit nga ndryshimet në kushtet e politikës monetare.

REFERENCAT

Driscoll, J.C. (2004): "Does Bank Lending affect Output? Evidence from the U.S. States", Journal of Monetary Economics, 51(3), pp. 451-471.

EBRD (2020), Transition Reports, URL: https://www.ebrd.com/home.

Ehrmann, Michael, Gambacorta, Leonardo, Martínez-Pagés, Jorge, Sevestre, Patrick, Worms, Andreas, (2003), "Financial systems and the role of banks in monetary policy transmission in the Euro Area". In: Angeloni, Ignazio, Kashyap, Anil, Mojon, Benoit K. (Eds.), Monetary Policy in the Euro Area. Cambridge University Press, pp. 235–269.

Eliskovski, M. (2018), "Investigating credit transmission mechanism in the Republic of Macedonia: Evidence from Vector Error Correction Model", National Bank of the Republic of North Macedonia Working Paper, No. 2/2018.

Fries, S. and A. Taci (2002), "Banking reform and development in transition economies", EBRD Working paper No. 71.

Gavin, W. T. and Kemme, D. M. (2004): "Using Extraneous Information to Analyze Monetary Policy in Transition Economies", Federal Reserve Bank of St. Louis, Working Papers, 034B, http://research/stlouisfed.org/wp/2004/2004-034.pdf.

Golinelli, R. and Rovelli, R. (2005), "Monetary Policy Transmission, Interest Rate Rules and Inflation Targeting in Three Transition Countries", Journal of Banking & Finance, 29(1), 183-201.

Hamilton, Jennifer D., (1994), Time Series Analysis. Princeton University Press, Princeton, NJ.
Hainz, C. (2004): "Are Transition Countries Overbanked? The Effect of Institutions on Bank Market Entry", German Economic Review, 5(2), 237-256.

International Monetary Fund: "International Financial Statistics",
URL: http://www.imfstatistics.org/imf.

Jimborean, R. (2007), "Monetary Policy Transmission in Transition Economies: The Bank Lending Channel".

Kashyap, A. and J. Stein (1995). The Impact of Monetary Policy on Bank Balance Sheets, Carnegie Rochester Conference Series on Public Policy, Vol. 42, pp. 151-195.

Kashyap, A. and J. Stein (1997). The Role of Banks in Monetary Policy: A Survey With Implications for the European Monetary Union, Federal Reserve Bank of Chicago Economic Perspectives, pp. 2-8.

Kashyap, A. and J. Stein (2000). What do a Million Observations on Banks Say about the Transmission of Monetary Policy, American Economic Review 90, pp. 407-428.

Kovacevic, D. (2015), "Empirical evidence for the bank lending channel in Bosnia and Herzegovina: Does lending differ between large and small banks?", Graduate Institute of International and Development Studies Working Paper, No. 10/2015, Graduate Institute of International and Development Studies, Geneva.

Kujundžić, Srđan and Dragiša Otašević, (2012), "The bank lending channel in an euroised economy: the case of Serbia". National Bank of Serbia Working Paper Series.

Nenova, Mariella, Evgeni Ivanov, Neli Ivanova, Daniel Kasabov, Boyan Zahariev, Gergana Markova, Kristina Karagyozova-Markova (2019), "Transmission of ECB's Monetary Policy in Bulgaria: Insights from a Large Macro-econometric Model", Bulgarian National Bank Discussion Papers DP/115/2019.

Roodman, D. (2009), "A Note on the Theme of Too Many Instruments." Oxford Bulletin of Economics and Statistics, 71(1): 135-158.

Skufi, L. (2020), "Financial sector and macroeconomics links in MEAM", Bank of Albania Working Paper Series.

Vika, I. and E. Suljoti (2015), "On the existence of Banking Lending Channel in the Transmission Mechanism in Albania", Bank of Albania Economic Review H2-2015.
Vika, I. (2007), "Role of Banks in the Monetary Policy Transmission in Albania", Bank of Albania Working Paper Series.

Vizek, Maruška (2006), "Econometric Analysis of Monetary Transmission Channels in Croatia", Privredna kretanja i ekonomska politika (Economic Trends and Economic Policy), No. 109, 2006, pp. 28-61.

Wróbel, E. and Pawlowska, M. (2002): "Monetary Transmission in Poland: Some Evidence on Interest Rate and Credit Channels", National Bank of Poland, Materialy i Studia, 24.

NDIKIMI NË PAPUNËSI I NJË GODITJEJE TË ARDHUR NGA KRIZA EKONOMIKE

Orion Garo, Departamenti i Kërkimeve, Banka e Shqipërisë

ABSTRAKT:

Pandemia COVID-19 krijoi një tkurrje të paprecedentë të ecurisë së shumicës së treguesve ekonomikë, në të gjithë botën. Si rezultat i kësaj krize socio-ekonomike, prodhimi i brendshëm bruto i Shqipërisë pësoi një goditje të thellë negative. Kjo analizë kërkimore adreson lidhjen midis shkallës së papunësisë dhe rritjes ekonomike, në kushtet kur kjo e fundit pëson rënie drastike të menjëhershme, si në rastin e asaj të shkaktuar nga pandemia COVID-19. Modeli ekonometrik i përdorur për shkallën e papunësisë në Shqipëri përdor flukset neto të tregut të punës, të vlerësuara nga të dhënat e ofruara zyrtarisht mbi tregun e punës. Ky model është një specifikim VAR i përdorur për të përshkruar përgjigjet e shkallës së papunësisë ndaj çdo goditjeje të simuluar ndaj secilës prej flukseve neto të tregut të punës, si dhe serisë së rritjes ekonomike. Gjetjet e analizës mbështeten në funksionet impulse-response të VAR, dhe rezultati më i rëndësishëm i dalë nga vlerësimi është që për një rënie të rritjes ekonomike prej 10 p.p. brenda një tremujori të vetëm, ndryshimi vjetor i shkallës së papunësisë rritet me rreth 1.84 p.p. përgjatë 4 tremujorëve pasues.

Fjalë kyçe:

Ligji i Okunit, COVID-19, flukset neto, shkalla e papunësisë, tregu i punës.

HYRJE:

Që prej krizës financiare të '07-'08, bota hyri në një terren të pasigurt të progresit ekonomik, ndaj metodat tradicionale të vlerësimit të aktiviteteve ekonomike filluan të bëhen gjithnjë e më arkaike. Që atëherë, procedurat standarde të analizave kërkimore dhe qasjet e metodave të parashikimit ekonomik po azhurnohen vazhdimisht për të trajtuar më saktë dhe ndjekur më shpejt tendencat e luhatjes së treguesve ekonomikë. Në vitin 2020, politikat dhe vendimmarrjet shoqërore dhe politike të mbarë botës të lidhura me shëndetësinë si reagim ndaj pandemisë COVID-19 e zhytën ekonominë botërore në një thellësi, në dukje të zgjatur, depresioni dhe pasigurie. Zhvillime të tilla drastike në sferën e ekonomisë reale kërkojnë metoda specifike në disiplinën shumë të nevojshme të analizës kërkimore dhe parashikimit ekonomik. Një nga mjetet më të efektshme në arsenalin e burimeve të analizës kërkimore është kategoria e analizave autoregresive, veçanërisht modelet vektoriale autoregresive.

Ky artikull kërkimor përqendrohet në rastin e një ekonomie të vogël e në zhvillim, si ajo e Shqipërisë, dhe përpiqet të shqyrtojë ndikimin negativ të pandemisë COVID-19 në papunësi. Për të arritur këtë, duhet të vërehet lidhja

statistikore midis shkallës së papunësisë dhe rritjes ekonomike. Rritja ekonomike e një ekonomie të vogël të tregut të lirë është sigurisht shumë e ndjeshme ndaj goditjeve të ardhura nga jashtë saj, veçanërisht krizave të përmasave të tilla si COVID-19. Në teori, kjo lidhet ngushtësisht me artikullin themelor të Okun (1962) të njohur si Ligji i Okunit; rrjedhimisht themeli teorik për lidhjen midis shkallës së papunësisë dhe rritjes ekonomike sigurohet nga ky ligj.

Pyetja e kërkimit është: Sa do të rritej ndryshimi vjetor i shkallës së papunësisë, në rast të një rënieje të papritur të rritjes ekonomike, të shkaktuar nga një shok negativ i jashtëm? (Shoku negativ i jashtëm në këtë rast është ai i shkaktuar nga një krizë shëndetësore, e tillë si pandemia.) Qëllimi i studimit është t'i japë një përgjigje sasiore kësaj pyetjeje.

RISHIKIMI I LITERATURËS:

Orvatjet për të siguruar modele kërkimore të tregut të punës lindin nga nevoja për të zhvilluar skenarë realistë ekonomikë mbi të cilët mund të përshtaten politika fiskale dhe monetare. Disa banka qendrore, të tilla si US Federal Reserve dhe Reserve Bank of Australia, përdorin mjetet e tyre të politikës monetare për të siguruar maksimumin e punësimit të qëndrueshëm (Federal Reserve Bank of Chicago, 2019; Lowe, 2019) në tregjet e tyre përkatëse të punës. Bankat e tjera, përfshirë Bankën e Shqipërisë, e konsiderojnë stabilitetin e çmimeve si objektivin e tyre të vetëm të politikës. Sidoqoftë, ato duhet të monitorojnë nga afër klimën e tregut të punës dhe treguesit e tij, që të administrojnë në mënyrë adekuate mjedisin monetar të ekonomive të tyre përkatëse.

Teoria e tregut të punës parashtron se rritja ekonomike është ndër statistikat më qendrore për të vlerësuar dinamikën e shkallës së papunësisë. Përpjekjet për të lidhur ndryshimet në shkallën e papunësisë me rritjen ekonomike reale gjurmohen qysh nga vitet '60, tek artikulli themelor i Arthur Okun (1962), i njohur më mirë si Ligji i Okunit. Ligji ngrihet nga supozimi se sigurimi i sasive shtesë të mallrave dhe shërbimeve (prodhimi) në një ekonomi kërkon fuqi punëtore shtesë. Kjo e fundit mund të supozohet (midis dukurive të tjera ekonomike) të shfaqet në formën e rritjes së punësimit, duke ulur kështu papunësinë. Prandaj, në teori, rritja ekonomike pritet të jetë e lidhur negativisht me papunësinë. Identiteti i njohur si "Ekuacioni i ndryshimeve të Okunit" është si në formën më poshtë:

(i)

$$\Delta_i ur_t = \alpha + \beta \frac{\Delta_i RGDP_t}{RGDP_{t-i}} + \xi_t$$

ku ur është shkalla e papunësisë, $RGDP$ është prodhimi i brendshëm bruto real (PBBR) i përshtatur për inflacionin, t është periudha (tremujore) aktuale, i është një numër konstant periudhash, α është rritja në pikë përqindje (p.p.) e shkallës së papunësisë në kushtet e një rritjeje ekonomikë reale zero për një periudhë të dhënë, dhe β është i ashtuquajturi koeficienti i Okunit, i cili në thelb tregon shkallën e reagimit të papunësisë ndaj ndryshimeve në rritjen ekonomike reale.

Një aspekt kyç me të cilin Okun nuk u angazhua kur kreu kërkimin e tij udhëçelës, është prania e mundshme e efektit prirje-vonesë midis aktivitetit ekonomik dhe zhvillimeve të tregut të punës në një ekonomi, efekt që mund gjithashtu të shfaqet në lidhjen negative midis rritjes ekonomike dhe shkallës së papunësisë. Disa autorë, përfshirë Sayfried (2005) dhe Brault & Khan (2019), e kanë vërejtur dhe hulumtuar këtë fenomen. Duke përdorur të dhëna tremujore, Reserve Bank of Australia (2014) ka dokumentuar efektin vonesë në marrëdhënien midis rritjes ekonomike dhe treguesve të tregut të punës, duke arritur në përfundimin se piku i lidhjes midis dy grupeve të variablave vërehet kur treguesit e tregut të punës ndjekin pas rritjen ekonomike me 1 deri në 4 periudha.

Ndër studiuesit që kërkuan të zhvillojnë teorinë mbi themelet e hedhura nga Okun, ishin Dixon dhe Thomson (2000), Ball, et al. (2012), Lim, et al. (2018; 2019), e të tjerë. Dixon dhe Thomson (2000) ishin ndër të parët që u përpoqën të konceptonin nivelin e papunësisë në terma të treguesve të tjerë të aktivitetit të tregut të punës, veçmas rritjes ekonomike. E bënë këtë duke përfshirë të tjerë variabla të niveleve dhe flukseve, të tillë si: shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore, popullsia në moshë pune, fuqia punëtore dhe papunësia:

(ii)
$$\Delta_i ur_t = \left(\frac{\Delta_i L_t}{L_{t-i}} + \frac{\Delta_i POP_t}{POP_{t-i}}\right) - \left(\frac{\Delta_i RGDP_t}{RGDP_{t-i}} - \frac{\Delta_i APL_t}{APL_{t-i}}\right) + \xi_t$$

ku POP është popullsia në moshë pune, L është fuqia punëtore dhe – me kushtin që të dhënat mbi nivelet e papunësisë [U], fuqisë punëtore [L] dhe rritjes ekonomike reale [$RGDP$] janë të disponibël – APL (produkti mesatar i punës) mund të llogaritet si:

(iii)
$$APL_t = \frac{RGDP_t}{L_t - U_t}$$

Duke përdorur të dhëna për rritjen ekonomike dhe për një numër të kufizuar të treguesve të tregut të punës, (ii) ofron një vlerësim të saktë e të arsyeshëm të ndryshimit periodik të shkallës së papunësisë, i cili mund të përdoret si një rutinë kyçe në specifikime të tjera ekonometrike më të përpunuara.

Flukset e tregut të punës (Figura 1), përbëjnë një grup të ri regresorësh makroekonomikë që mund të përdoren për të gjurmuar dhe kryer analiza mbi ecurinë historike të normave të tregut të punës. Këto janë raportime me frekuencë të rregullt mbi numrin aktual të qytetarëve që kalojnë nga një stok i tregut të punës tek një tjetër, brenda një periudhe të caktuar; janë gjashtë gjithsej dhe gjurmojnë zhvendosjet nga dhe drejt: [i] punësimit dhe papunësisë, [ii] papunësisë dhe pasivitetit ekonomik, dhe [iii] pasivitetit ekonomik dhe punësimit. Ndonëse josubstanciale për sa i përket numrave, këto flukse janë tepër informuese për të zbuluar tendencat e normave më të rëndësishme të tregut të punës. Pak qeveri - përgjithësisht ato të ekonomive të zhvilluara - mbajnë dhe ofrojnë statistika zyrtare mbi flukset e tregut të punës.

Dixon, et al. (2015) përdorën një qasje vektoriale autoregresive të flukseve të tregut të punës për të analizuar treguesit kryesorë të ecurisë periodike të tregut të punës, përkatësisht punësimin, papunësinë dhe pasivitetin ekonomik. Dixon, et al., (2015) shfrytëzuan 34 vjet të dhëna mujore të tregut australian të punës, nga viti 1979 në atë 2013. Ata nuk e përfshijnë shkallën e papunësisë në analizën e tyre vektoriale autoregresive, vetëm variablat e flukseve të tregut të punës. Sidoqoftë, çfarë vlen të theksohet nga të dhënat e tyre është se, në rastet e zhvendosjeve të kursit ekonomik (siç janë recesionet dhe rimëkëmbjet), niveli i papunësisë shfaqi korrelacion pozitiv me normën e fluksit neto nga punësimi drejt pasivitetit ekonomik.

Figura 1. Paraqitje skematike e flukseve bruto dhe neto midis stoqeve të tregut të punës



Lim, et al. (2018; 2019) analizuan gjithashtu flukset e tregut të punës, por për më tepër ata u bazuan në parimet teorike të Ligjit të Okunit, duke përfshirë dhe rritjen ekonomike në analizën e tyre të kërkimit. Ata shfrytëzuan 27 vjet (1990-2017) të dhëna tremujore të tregut amerikan të punës për të zbatuar një analizë autoregresive bazuar në një sistem SUR (Seemingly Unrelated Regressions), në të cilin ndryshimi në shkallën e papunësisë (chur) me një vonesë dhe rritja ekonomike u mbajtën në anën e termave të pavarur dhe u përdorën për të shpjeguar ndryshueshmëritë e flukseve neto të tregut të punës: (***eu***, ***nu*** dhe ***en***). Ata i bazuan specifikimet dhe rezultatet e tyre në argumentin e supozuar se "normat e tregut të punës përcaktohen njëkohësisht, si pasojë e ndryshimeve në flukset neto të tij" (Lim, et al., 2019). Rezultatet e kërkimit të tyre treguan se chur me një vonesë rezultoi regresor statistikisht i rëndësishëm vetëm për ekuacionet ***eu*** dhe ***en*** të sistemit SUR. Në rastin e ekuacionit ***eu***, lidhja me chur rezultoi pozitive[1]: një rritje prej 1 p.p. në normën e ***eu*** u shoqërua me një rritje prej 0.31 p.p. në *chur*. Në rastin e ekuacionit ***en***, marrëdhënia me chur rezultoi pozitive gjithashtu: një rritje prej 1 p.p. në normën e ***en*** u shoqërua me një rritje prej 0.19 p.p. në *chur*. Për më tepër, rezultatet e tyre treguan se rritja ekonomike kishte një efekt të kufizuar në flukset e tregut të punës. Vetëm në njërin nga ekuacionet e sistemit SUR - ekuacioni i ***eu*** - rritja ekonomike rezultoi regresor statistikisht i rëndësishëm. Në këtë rast, marrëdhënia e ***eu*** me rritjen ekonomike ishte negative: rritja prej 1 p.p. në normën e eu u shoqërua me një rënie të rritjes ekonomike prej 0.25 p.p.

[1] *Është e rëndësishme të theksohet se në studimin e Lim, et al. (2018), veçanërisht ky fluks neto rezulton në kahun e punësimit (d.m.th. fluks më i lartë i njerëzve nga papunësia në punësim, sesa anasjelltas), prandaj, në ndryshim nga studimi i Lim, et al. (2018), në studimin tonë (në të cilin të dhënat raportojnë për një fluks më të lartë të njerëzve nga punësimi në papunësi sesa anasjelltas) marrëdhënia midis ue dhe chur pritet të jetë negative.*

METODOLOGJIA DHE TË DHËNAT:

Metodologjia e këtij studimi bazohet në konsideratat teorike të paraqitura në Dixon dhe Thomson (2000), Dixon, et al. (2015), dhe Lim, et al. (2018). Këta autorë përdorin të dhënat e tregjeve përkatëse të punës për të identifikuar karakteristikat dhe efektet strukturore në shkallën e papunësisë. Dixon dhe Thomson (2000) shfrytëzojnë të dhënat e niveleve, ndërsa Dixon, et al. (2015), dhe Lim, et al. (2018) shfrytëzojnë të dhënat e flukseve. Vetë modeli vektorial autoregresiv përdor të dhënat disponibël mbi tregun shqiptar të punës dhe treguesin e $\Delta PBBR$, të gjitha statistika zyrtare të botuara nga Instituti i Statistikave të Shqipërisë. Ajo mbështetet në bazat teorike të paraqitura në Dixon, et al. (2015) dhe Lim, et al. (2018; 2019). Përveç rritjes ekonomike dhe ndryshimit në shkallën e papunësisë, vlerësimet e normave të flukseve neto si regresorë do të përdoren për të siguruar qëndrueshmëri dhe stabilitet të modelit.

Specifikimi vektorial autoregresiv i studimit konsiderohet të jetë i formës:

$$B_t = \alpha + \beta_1 B_{t-1} + \ldots + \beta_h B_{t-h} + S08 + S12 + R + \xi_t$$

ku:

- Bt është një matricë prej pesë vektorësh 5×1, të parenditur sipas një sekuence të përcaktuar dhe me një rend vonesash të shtrirë deri në h, që përfaqëson serinë e rritjes ekonomike, ndryshimin në shkallën e papunësisë, dhe 3 vlerësimet e normave të flukseve neto;
- α është një vektor 5×1 i termave konstante;
- β_h është një numër h matricash 5×5 për koeficientet e variablave endogjenë të VAR;
- S09 është një vektor 5×1 i koeficienteve të variablit dummy për devijimin strukturor që ndodhi në vitin 2009, si rezultat i ndikimit që kriza financiare globale 2007-08 pati në tregun vendas të punës;
- S14 është një vektor 5×1 i koeficienteve të variablit dummy për devijimin strukturor që ndodhi në vitin 2012, si rezultat i ndikimit që kriza e borxhit publik grek e vitit 2009 pati në tregun vendas të punës;
- R është një vektor 5×1 i koeficienteve të variablit dummy për iniciativën qeveritare mbi zbatimin e reformave ekonomike në punësim dhe masat për formalizimin e ekonomisë nga viti 2014 e më tej;

Variablat dummy janë të koduar 1 për periudhën e supozuar kohore gjatë së cilës ndodh një shok i identifikuar ekonomik, dhe 0 në të kundërt;

- ξ_t është një vektor 5×1 i gabimeve, të cilat ndjekin procese i.i.d. të zhurmës së bardhë, dhe ndodhin në kohën t.

Të dhënat e serive kohore të përdorura në këtë punë kërkimore merren ekskluzivisht nga baza e të dhënave e Institutit të Statistikave të Shqipërisë: "Anketa e Forcave të Punës". Frekuenca e të dhënave është tremujore, mbulon periudhën nga tremujori i parë 2001 deri në tremujorin e katërt 2019, dhe treguesit kryesorë të përdorur janë punësimi (E), papunësia (U), pasiviteti ekonomik (N) dhe popullsia në moshë pune (POP). Flukset e tregut të punës

dhe normat e tyre janë llogaritur nga treguesit e sipërpërmendur, dhe metoda e llogaritjes është Iterative Proportional Fitting[2] (IPF).

Pasi aplikojmë metodën Iterative Proportional Fitting tek seritë nivel të tregut të punës dhe sigurojmë fillimisht flukset, i normëzojmë këto flukse duke përdorur popullsinë në moshë pune në emërues, dhe i vjetorizojmë (marrim ndryshimin nga viti në vit), duke ruajtur njëkohësisht frekuencën tremujore të tyre. Tri vlerësimet e flukseve neto dhe seria e rritjes ekonomike, secila e krahasuar me serinë e ndryshimit vjetor të shkallës së papunësisë, tregohen në serinë e grafikëve më poshtë. Këto do të përdoren si tregues endogjenë në modelin e këtij studimi:

Figura 2. Flukset neto krahasuar me ndryshimin e shkallës së papunësisë (të dhëna tremujore të vjetorizuara)



[2] *IPF është një procedurë algoritmike që përdoret për të vlerësuar (përshtatur) qelizat e një tabele për të cilat informacioni mungon, dhënë një seri të caktuar kufizimesh. Me anë të IPF, studiuesi mund të përftojë seri kohore të vlerave për qelizat e tabelës që janë vlerësime me gjasat dhe entropinë maksimale (Založnik, 2011) të të qenit të njëjta me seritë kohore reale (por të pavrojtuara). Kjo arrihet duke ushqyer algoritmin me totalet e marzheve për rreshtat dhe kolonat e tabelës, me qëllim përftimin e vlerave të mundshme të ndërtabuluara të tabelës.*

Figura 3. Rritja ekonomike dhe ndryshimi i shkallës së papunësisë (të dhëna tremujore të vjetorizuara)



Testet Wald të shkakësisë Granger/ ekzogjenitetit në bllok zbulojnë se rendi i ekzogjenitetit në model fillon me rritjen ekonomike si variabli me ekzogjen, vazhdon me ndryshimin në shkallën e papunësisë, pastaj me nu, ue, dhe në fund en si variabli më endogjen. Pra, rendi: ΔPBBR, chur, nu, ue, en, konsiderohet – në rezultatet paraprake – rendi Cholesky me të cilin variablat hyjnë në VAR-in rekursiv, për të prodhuar grafikët IRF dhe rezultatet FEVD.

REZULTATET:

Pas marrjes së vlerësimeve për modelin paraprak VAR, përftojmë grafikët e mëposhtëm IRF (impulse response function), ku fokusi është në reagimin e ndryshimit në shkallën e papunësisë.

Figura 4. Grafikët impuls-reagim për ndryshimin në shkallën e papunësisë



Siç mund të shohim (grafiku i sipërm majtas në figurën 4) një shok pozitiv prej 1 devijimi standard në rritjen ekonomike do të shoqërohej me një reagim të akumuluar të ndryshimit në shkallën e papunësisë prej 0.45 p.p. rënie, përgjatë 4 tremujorëve të njëpasnjëshëm. Ky rezultat me të dhënat e tregut shqiptar të punës, është në të njëjtën linjë me propozimet teorike të Ligjit të Okunit. Gjithashtu, mund të shfrytëzohet më tej për të llogaritur reagimin e ndryshimit në shkallën e papunësisë për një rënie të paracaktuar (të themi, prej 10 p.p.) në rritjen ekonomike.

Hapi tjetër është të vijojmë me analizën e zbërthimit të variancës. Duke qenë se theksi i studimit është shkalla e papunësisë, unë përqendrohem vetëm në variancën e gabimit të parashikimit për chur. Rezultati në Figurën 5 tregon se pjesa kryesore (rreth 48%) e variancës së gabimit të parashikimit të chur shpjegohet nga vetë chur. Variabli i dytë më me ndikim është ue, i cili shpjegon rreth 35% të variancës së gabimit të chur. Variabli i tretë në radhë vjen rritja ekonomike, e cila shpjegon afërsisht 14% të variancës së gabimit të chur. Së fundi, ndikimet e nu dhe en në variancën e gabimit të chur janë relativisht minimale.

Figura 5. Zbërthimi variancës së gabimit të parashikimt, duke përdorur faktorët Cholesky (shkallët e lirisë të azhustuara)



Një rillogaritje e rezultateve të modelit për një skenar të rënies së papritur të rritjes ekonomike me 10 p.p. brenda një tremujori, tregon se e tillë rënie do të shoqërohej me një rritje në ndryshimin e shkallës së papunësisë prej 1.84 p.p. përgjatë 4 tremujorëve të njëpasnjëshëm. Më konkretisht, nëse rënia me 10 p.p. e rritjes ekonomike është vërejtur ne tremujorin 1, ndryshimi në normën e papunësisë pritet të rritet me: 0.35 p.p. në atë tremujor; me 0,5 p.p. në tremujorin e dytë; me 0.6 p.p. në tremujorin e tretë; dhe me 0.38 p.p. në tremujorin e katërt. Nga tremujori i katërt e tutje nuk pritet rritje e mëtejshme e shkallës së papunësisë, dhe tremujori i pestë parashikon rënien që çon në ekuilibrin afatgjatë midis këtyre dy variablave. Rritja kumulative prej 1.84 p.p.

në një vit e shkallës së papunësisë përkthehet në 23 056 pjesëmarrës të fuqisë punëtore që kthehen në të papunë gjatë atij viti.

VËREJTJE PËRMBYLLËSE:

Ky projekt hyn tek kërkimet në fushën e të dhënave mbi flukset e tregut të punës, të cilat përbëjnë zhvillime bashkëkohore në lëmin e kërkimeve mbi tregun e punës. Ai i përmbahet propozimeve teorike të Ligjit të Okunit, sipas të cilave ekziston një marrëdhënie afatgjatë midis rritjes ekonomike, nga njëra anë, dhe shkallës së papunësisë (si dhe një sërë treguesve të tjerë të tregut të punës) nga ana tjetër. Nga ky kërkim rezulton se rritja ekonomike dhe normat e flukseve të tregut të punës janë tregues tremujorë të përshtatshëm për të vlerësuar shkallën e papunësisë në Shqipëri. Kontributi i saj kryesor në literaturën ekzistuese në këtë fushë është paraqitja e një specifikimi vektorial autoregresiv që mund të përcaktojë sasinë e ndikimit negativ që një krizë e papritur, siç rezultoi pandemia COVID-19, mund të ketë në shkallën e papunësisë në Shqipëri.

Siç pritej, rezultatet e analizës VAR për të dhënat shqiptare tregojnë se ndryshimi në shkallën e papunësisë shfaq një lidhje negative, të njehsueshme dhe statistikisht të rëndësishme, me rritjen ekonomike. Nga të gjithë variablat e përfshirë në model, rritja ekonomike duket të jetë e dyta në radhë më përcaktuesja - menjëherë pas ue (norma e fluksit neto nga papunësia në punësim) - në përcaktimin e dinamikës së shkallës së papunësisë. Analiza e zbërthimit të variancës tregon se ndikimi i rritjes ekonomike në shkallën e papunësisë duket të jetë i qëndrueshëm dhe i paluhatshëm për një segment kohor prej 12 periudhash, duke u dhënë vërtetësi parimeve të Ligjit të Okunit për të dhënat shqiptare.

Për adresimin e pyetjes kryesore të kërkimit, rillogaritja e rezultateve të modelit për një skenar të rënies së papritur të rritjes ekonomike me 10 p.p. brenda një tremujori (praktikisht e njëjta rënie që njohu rritja ekonomike në Shqipëri në tremujorin e dytë të 2020) parashikon një rritje në ndryshimin e shkallës së papunësisë prej 1.84 p.p. përgjatë 4 tremujorëve të njëpasnjëshëm vijues. Eventualiteti në tregun e punës do të ishte një total prej rreth 23 000 të punësuarish që do të rezultonin të papunë gjatë një viti, që nga tremujori i parë i precipitimit së rritjes ekonomike.

Duhet theksuar se këto vlerësime anojnë në krahun konservator. Kjo pasi llogaritjet e modelit bazohen vetëm në supozimin e një shoku të shkaktuar nga një krizë e ardhur nga jashtë ekonomisë vendase. Sidoqoftë, natyra e krizave nuk mund të kategorizohet dhe as të integrohet në model, ndaj asnjë faktor i rëndësishëm shoqëror dhe ekonomik në lidhje me jetën e jetuar - për një periudhë të zgjatur - në kushtet e një pandemie të tillë si ajo e shkaktuar nga COVID-19, nuk mund të njehsohet në aspektin sasior. Faktorë të tillë socialë dhe ekonomikë mund të përfshijnë kufizimet e lëvizshmërisë, nivelet e infektimit të fuqisë punëtore nga virusi, vështirësi financiare si rezultat i bizneseve të mbyllura dhe aktiviteteve të reduktuara ekonomike etj. Faktorë të tillë zakonisht

i tkurrin veprimtaritë e tregut të punës dhe e ngrenë papunësinë në nivele edhe më të larta.

Në përfundim, dëshiroj të theksoj rëndësinë e analizimit të dinamikës të komponentëve të tjerë të tregut shqiptar të punës, siç janë shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës, raporti punësim-popullatë, dhe shkalla e pasivitetit ekonomik. Këta komponentë janë po aq thelbësorë sa shkalla e papunësisë në vlerësimin e gjendjes ekzistuese dhe zhvillimeve të ardhshme të tregut të punës së një vendi.

REFERENCAT:

Ball, L., Furceri, D., Leigh, D., ., ., & Loungani, P. (2012). Okun's Law: Fit at 50? Journal of Money, Credit and Banking, 49 (7).

Bank of Albania. (2014). First Quarter Monetary Policy Report. 21.

Brault, J., & Khan, H. (2019). The Shifts in Lead-Lag Properties of the US Business Cycle. Department of Economics. Ottawa: Carleton University.

Council of Ministers of the Republic of Albania. (2015). National Strategy for Development and Integration, 2015 - 2020.

Dixon, R., & Thomson, J. (2000). Okun's Law and Movements over Time in the Unemployment Rate in Australia. The University of Malbourne, Melbourne, Victoria, Australia.

Dixon, R., Lim, G. C., & van Ours, J. (2015). The effect of shocks to labour market flows on unemployment and participation rates. Applied Economics, fv. 1-17. doi:10 .1080/00036846.2015.1008771

Federal Reserve Bank of Chicago. (2019). The Federal Reserve's Dual Mandate. Chicago, Illinois, United States of America. Gjetur në https://www.chicagofed.org/research/dual-mandate/dual-mandate

Instituti i Statistikave. (a.d.). Të dhëna administrative të tregut të punës - Metodologji. Tiranë, Shqipëri. Gjetur në http://www.instat.gov.al/al/temat/tregu-i-punës-dhe-arsimi/të-dhëna-administrative-të-tregut-të-punës/#tab4

Knotek, E. S. (2007). How Useful is Okun's Law? Economic Review - Fourth Quarter, fv. 73-103.

Lim, G. C., Dixon, R., ., ., ., & van Ours, J. (2018). Beyond Okun's Law: Output Growth and Labor Market Flows. 1-26. Amsterdam, The Netherlands: Tinbergen Institute.

Lim, G. C., Dixon, R., ., ., ., & van Ours, J. (2019). Beyond Okun's Law; Introducing Labour Market Flows. VOX, CEPR Policy Portal. Gjetur në https://voxeu.org/article/beyond-okun-s-law-introducing-labour-market-flows

Lomax, N., & Norman, P. (2016). Estimating Population Attribute Values in a Table: "Get Me Started in" Iterative Proportional Fitting. The Professional Geographer, 68(3), 451-461. doi:10.1080/00330124.2015.1099449

Lowe, P. (Interpretuesi). (2019). The Labour Market and Spare Capacity. Adelaide, Australia. Gjetur në https://www.rba.gov.au/speeches/2019/pdf/sp-gov-2019-06-20.pdf

Okun, A. M. (1962). Potential GNP: Its Measurement and Significance. Cowles Foundation (Paper 190), fv. 98–104. Yale University, New Haven, CT, USA.

Reserve Bank of Australia. (2014, May). Statement on Monetary Policy. Sydney, Australia.

Sayfried, W. (2005). Examining the Relationship between Employment and Economic Growth in the Ten Largest States. Southwestern Economic Review, 13-24.

Založnik, M. (2011, November). Iterative Proportional Fitting: Theoretical Synthesis and Practical Limitations. Oxford, United Kingdom: University of Oxford. doi:10.13140/2.1.2480.9923